

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

**FRIKA DHE SHPRESA**

Imam Gazali

*Ihjau Ulumid-din*  
Ringjallja e diturive fetare  
Imam Gazali

**Titulli i origjinalit:**  
*Kitabu'l- havf ve'r- rexha*  
Libri 33

**Përgatiti dhe përktheu**  
Is'hak Shala dhe Abdullah Ferizi

**Lektor**  
Shenaj Zeneli

Prishtinë, 2024

## ***Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit***

### PARATHËNIE

*Hamd (falënderimi) i takon vetëm Allahut Teala; në mëshirën dhe shpërblimin e Tij shpresojmë, e dënimit të Tij i frikësohemi. Ai Allah, që me gëzimin e shpresës i shëroi zemrat e miqve të Tij, dhe me rahmetin e Tij i largoi ata nga malli i largësisë - vend i armiqve të tyre, e i vendosi në afërsinë e Tij. Ai Allah, që me kamxhikun e frikësimit; me ndalim të rreptë e me paralajmërim të ashpër, fytyrat e atyre që e larguan nga Madhëria e Tij i ktheu kah xhenneti, vend i sevapeve dhe mrekullisë, dhe i mbrojti nga qortimi e zemërimi i Tij. Ai i tërheq ata në xhennet; herë me detyrim, e herë me mëshirë e butësi.*

*Salat dhe selam Muhammedit, s.a.v.s., peygamberit të rahmetit – zotëri i të gjithë peygamberëve, ehli bejtit të tij të pastër në të jashtmen e të brendshmen, dhe as'habëve të tij, e edhe atyre që pasojnë ahlakun dhe sunnetin e tij.*

E tani dije se:

Frika dhe shpresa janë si dy krahë me të cilat *mukarrebunët* (të afërt Allahut) fluturojnë në secilën gradë të lartë e të lavdëruar; me këta dy krahë kapërcejnë pengesat dhe vështirësitë në rrugë për ahiret. Vetëm forca e shpresës do t'i dërgojë në afërsinë e Rahmanit dhe në xhennet, e xhenneti paraqet ngarkesë të rëndë, dhe është i rrethuar me të pakëndshme e vështirësi të mëdha. Dhe vetëm kamxhiku i frikësimit dhe efekti i qortimit të ashpër i shpëtojnë nga mundimi i dhimbshëm dhe zjarri i xhehenemit - rrethuar me kënaqësi të shumta e me atë çfarë tërheq epshet.

Prandaj duhet të shpjegohet hakikati dhe fazileti - edhe i frikës edhe i shpresës, si edhe mënyrat e bashkimit të tyre, edhe pse të kundërta mes vete. Këto do t'i shpjegojmë në këtë libër, të përbërë nga dy pjesë:

## Kapitulli i parë

### PËR SHPRESËN

#### HAKIKATI I SHPRESËS

Dije se, shpresa (*rexha*) është gradë (*makam*) e udhëtarit shpirtëror (*salik*) dhe një nga gjendjet (*hall*) të atij që kërkon rrugën e drejtë (*talib*). Shpresa është një cilësi që, kur bëhet e qëndrueshme, quhet **gradë**, e kur vjen-e-shkon shpejt, quhet **gjendje**. Kështu janë, për shembull, edhe cilësitë e ngjyrës së verdhë: te ari ajo është e qëndrueshme, kur shkaktohet nga frika është e përkohshme, ndërsa kur vjen prej sëmundjes është mes këtyre dyjave. Kësisoj ndahen edhe cilësitë e zemrës, dhe cilado cilësi që nuk është e qëndrueshme në zemër quhet **gjendje**, sepse zgjatë pak dhe kjo vlen për secilën cilësi të zemrës.

Ne këtu duam ta shpjegojmë hakikatin e shpresës. Edhe shpresa, si cilësitë tjera, shfaqet me tri: (1) *dituria* (2) *gjendja* dhe (3) *veprimi*, ku dituria lind gjendjen, e gjendja veprimin. *Shpresë* është emërtim për të tria bashkë.

Gjithashtu, të pëlqeu ty apo jo, gjithçka në çka ti hasë, ndahet në tri: në të shkuarën, të tashmen ose të ardhmen e saj. Kur kujton diçka që ka ndodhur në të kaluarën, kjo quhet *përmendje (dhikr)* dhe kujtesë (*tedhekur*). Nëse atë çfarë ka mbetur në kujtesë e ndjen në zemër në këtë moment, kjo quhet *dashuri* dhe *kënaqësi*, dhe është një gjendje që njeriu e gjen në vete. Nëse të vjen në mendje diçka që do të ndodh në të ardhmen dhe të vendoset në zemër, kjo quhet *pritje*. Nëse ajo që pritet është e pakëndshme dhe në zemër lajmërohet dhimbje, quhet *frikë*, e nëse pritet diçka që është e këndshme dhe që zemra ta dëshiron, quhet *shpresë*.

Domethënë, shpresa është kënaqja e zemrës që vjen nga pritja. Por kjo kënaqësi e pritur duhet të ketë një sebeb; dhe nëse pret atë për të cilën janë përgatitë shumica e sebepeve të duhura, atëherë është e drejtë kjo të quhet shpresë. Por nëse sebePET nuk janë përgatitur dhe janë të ndërlikuara, atëherë më e rrugës është që kjo të quhet *mashttrim* dhe *padituri* se sa *shpresë*.

Nëse shkaktarët e asaj çfarë po pritet nuk janë të njohur ose nuk dihet a ekzistojnë fare, atëherë më e drejtë është që kjo të quhet *kërkesë* dhe *dëshirë*, sepse është pritje pa sebeb. Sido që të jetë, termet *shpresë (rexha)* dhe *frikë (havf)* përdoren vetëm aty ku ka dyshim, sepse gjërat që dihen saktë nuk quhen as *shpresë*, as *frikë*.

Për shembull, nuk thuhet “*Shpresoj se Dielli do të lindë në mëngjes*”, ose “*Kam frikë se Dielli nuk perëndon në mbrëmje*”, sepse kjo dihet me siguri, por mund të themi, për shembull: “*Shpresoj se do të bjerë shi*” ose “*Kam frikë se shiu mund të ndalet*”.

Ata që kanë largpamësi (*basiret*) e dinë se dynjaja është arë ku mbjellët për ahiretin, dhe e dinë se edhe zemra është si një arë, se imani është si fara në atë arë dhe se ibadetet janë si lëvrimi i arës dhe si hapja e kanaleve për ujitjen e saj. Ata e dinë se zemra e prirë kah dynjaja nuk jep fruta, njëjtë si toka djerrë. E dinë se Dita e Gjykimit është dita e korrjes dhe të gjithë atë ditë do të korrin atë që kanë mbjellë. E dinë gjithashtu se një person që nuk mbjell farën e besimit në zemrën e vet, në atë zemër nuk do të ketë korrje, dhe e dinë se për shkak të verbërisë së zemrës dhe ahlakut të keq, dobia e besimit do t’i jetë e vogël.

Pra, shpresa e robit për falje nga Allahu duhet të jetë si shpresa e bujkut për fruta. Kështu, secili që kërkon arë të mirë e pjellore, në të hedh farën e mirë e të shëndoshë, e më pas i jep gjithçka që i duhet për zhvillim, e ujitë kur ka nevojë, ia pastron dheun nga barishtet dhe nga gjithçka që pengon zhvillimin e farës, pastaj lutet, duke pritur mirësinë e Allahut Teala që nga të korrat të largojë motin e keq dhe sëmundje tjera, dhe ashtu deri sa të arrijë korrja – një këso pritje mund të quhet *shpresë (rexha)*.

Por nëse e mbjell farën në tokë djerrë e pa ujë e as nuk kujdeset për kushtet tjera për zhvillim të farës, e më pas pret të korrat - këso pritje quhet *padituri* dhe *budallallëk*, e jo *shpresë*. Kur e zgjedh tokën pjellore, por nuk e siguron ujin dhe shpreson në shi, kjo mund të quhet *dëshirë*. Pra, *shpresë* mund të quhet vetëm diçka e bukur që pritet të ndodhë, dhe ekzistojnë parakushtet për realizimin e saj, parakushte këto brenda mundësive dhe zgjedhjes së njeriut. Ajo që nuk është në mundësinë e njeriut, e as nuk është zgjedhje e tij, kjo mbetet në suaza të mirësisë së Allahut Teala, ashtu që Ai i largon pengesat. Shpresa e vërtetë është kur njeriu mbjell farën e besimit në zemrën e tij, e ujitë me ujin e ibadetit dhe e pastron nga veset e këqija, pastaj i kërkon Allahut që ajo farë t'i mbetet në zemër derisa ky të vdesë dhe të kalojë në ahiret me iman. Kjo është dëshirë e bukur dhe një shpresë e tillë nxitë dhe motivon njeriun të përgatisë sebetet e imanit dhe faljes, deri në vdekje. Por, nëse robi e privon farën e mbjellë të imanit nga ujitja me ibadete, e lë zemrën të mbushur me vese të këqija dhe dalldiset në kënaqësitë e kësaj bote e më pas pret falje - kjo është budallallëk dhe mashtrim. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

***“Budalla është ai që ndjek dëshirat e nefsit dhe e harxhon jetën pas dëshirave epshore, e më pas shpreson xhennetin nga Allahu”<sup>1</sup>***

---

<sup>1</sup> Hadithi është përmendur disa herë.



Për njerëzit e tillë, Allahu Teala thotë:

**“Pas tyre erdhën brezni, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshet e veta.”** 19-Merjem: 59

Allahu Teala gjithashtu thotë:

**“Pas tyre, erdhi një brezni e cila e trashëgoi Librin, por duke marrë gjërat e pavlefshme të kësaj bote dhe duke thënë: *Do të na falet çdo gjë!*”** 7-Araf: 169

Allahu Teala e qortoi pronarin e bahçes që hyri në bahçen e vet, dhe tha:

***“Unë nuk mendoj se kjo shkatërrohet ndonjëherë dhe nuk mendoj se do të arrijë ndonjëherë Ora (e Kiametit). Por, edhe nëse do të më kthejnë te Rabbi im, pa dyshim që do të gjej një vend më të mirë se ky.”***

18-Kehf: 35-36

Kjo do të thotë se personi i cili përpiqet të zbatojë urdhrat e Allahut, të bëjë ibadet dhe të largohet nga gjynahet, ka të drejtë të kërkojë dhe të shpresojë në mëshirën e Allahut Teala, dhe të shpresojë se Allahu do ta plotësojë nimetin e Tij; e plotësimi i nimetit të Tij nuk është asgjë tjetër veç se hyrja në xhennet.

Sa i përket gjynaheve, nëse personi pendohet dhe i kryen obligimet e veta nga e kaluara, ai ka të drejtë të shpresojë se i pranohet pendimi.

Edhe ai që pa dashje i përshtatet nefsit, zemërohet për të keqen e vet e gëzohet për mirësinë e vet, qorton veten për gabimet e veta dhe singerisht e dëshiron pendimin, ka të drejtë të shpresojë se i pranohet pendimi. Përbuzja ndaj gjynahut dhe dëshira e fortë për pendim janë arsye që çojnë në pendim. Prandaj Allahu Teala thotë:

**“Ata që besuan, dhe ata që mërguan e luftuan në rrugë të Allahut, pikërisht ata shpresojnë në mëshirën e Allahut.”** 2-Bekare: 218

Pra, këta kanë të drejtë të shpresojnë në mëshirën e Allahut. Me këtë ajet Allahu Teala nuk e limitoi shpresën vetëm te këta të përmendurit, sepse ka edhe të tjerë që mund të shpresojnë, mirëpo i përcaktoi kushtet me të cilat meritohet shpresa. Sa për ata që janë dalldisë në gjërat që nuk i pëlqejnë Allahut dhe nuk e qortojnë veten për këtë e as nuk janë të vendosur të pendohen, shpresa e tyre është budallallëk, është si shpresa e dikujt që mbjell farën në tokë djerrë dhe nuk e ujit, nuk e pastron nga barishtet dhe nga gjithçka që pengon zhvillimin e farës, e pret fruta prej saj. Jahja ibn Muadh thotë: *“Mendoj se mashtrimi më i madh është të vazhdohet me gjynahe, e të kërkohet falje nga Allahu pa pendim; të shpresohet afërsia e Allahut pa ibadet; duke mbjellë farat e zjarrit, të shpresohet në frutat e xhennetit; të kërkohet grada e të devotshmit duke bërë gjynahe; të kërkohet shpërblim pa bërë vepra të mira dhe të kërkohet mëshirë nga Allahu pa përmirësuar veten.”*

E poeti ka thënë:

*“Vet nuk hyn në rrugën e shpëtimit,  
e shpreson se do të shpëtojë!*

*A nuk e di ky person se –*

*anija në tokë nuk mund të lundrojë!”*

Nëse sipas kësaj që e shpjeguar ti e kuptove hakikatin e shpresës, atëherë e ke kuptuar se shpresa është një gjendje që varet nga shumë sebepe, dhe është fryt i diturisë.

Kjo gjendje lind angazhim me të cilin plotësohen edhe kushtet tjera, sipas mundësive, sepse ai që mbjellë farë të shëndoshë, lëvron arën dhe sjell ujë të mjaftueshëm, shpresa e tij është e sigurtë, dhe e arsyeshme, e ai sinqeritet vazhdimisht e shtyn në kujdes shtesë për arën, në pastrim nga bari i keq e pengesat tjera, deri sa të arrijnë frutat.

Kjo është shpresa, ndërsa e kundërta e shpresës është dëshpërimi, e dëshpërimi do ta ndalonte nga puna në arë dhe kujdesi për të. Ai që e di se një copë tokë është djerrë dhe jopjellore, as nuk ka ujë, e di që fara nuk do të mbijë e zhvillohet, i tilli sigurisht që do ta braktisë atë djerrinë e nuk do të mundohet me të. Shpresa është e lavdëruar sepse motivon, ndërsa e kundërta e shpresës - dëshpërimi është i qortuar, sepse largon nga veprimi.

Frika nuk është e kundërta e shpresës, përkundrazi, është mik i saj, siç do ta shpjegojmë më vonë; sepse edhe frika edhe shpresa për njeriun janë mjet nxitës.

Prandaj, gjendja e shpresës është një luftë e gjatë, që kërkon ibadet të vazhdueshëm. Një nga veprat e shpresës është kënaqësia që ndjen nga afrimi i vazhdueshëm Allahut Teala, kënaqësi duke kërkuar prej Tij. Këto gjendje shfaqen edhe tek ata që shpresojnë për diçka nga sulltanët apo njerëzit tjerë, e si të mos shfaqen te ata që shpresojnë prej Allahut?

Nëse këto gjendje nuk shfaqen te një person, atëherë kjo është dëshmi se ai person është privuar nga grada e shpresës dhe ka rënë në gradën më të ultë të mashtrimit me pritje të kotë.

Ky ishte shpjegimi për gjendjen e shpresës, që lind nga dituria për shpresën, si edhe për veprimin, që është fryt i asaj diturie.

Dëshmi për këtë gjejmë në një hadith të përcjellë nga Zejd el-Hajl, i cili i tha Resulallahut, s.a.v.s.:

- *Erdha të të pyes për shenjat që Allahu Teala i tregon te ata që i do, dhe shenjat e atyre që nuk i do.* Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti:

- ***Si u zgjove në mëngjes?***, e ai u përgjigj:

- U zgjova me dashuri për të mirën dhe për ata që bëjnë të mira; nëse më ofrohet mundësia të bëj të mira, e bëj menjëherë dhe besoj në shpërblimin e Allahut Teala, nuk do të hamendem dhe do të jem i bindur në shpërblimin e Allahut Teala, e nëse nuk arrij ta bëj, do të mërzitem.

Në këtë Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

**- Kjo është shenjë e Allahut te ata që Ai i do, e po të donte Allahu ty për diçka tjetër, për atë edhe do të përgatiste, e atëherë nuk merakoset se në cilën luginë do të shkatërroheshe.<sup>2</sup>**

Resulallahu, s.a.v.s. përmendi shenjat e atyre që ju dëshirohet e mira, prandaj kush mendon se është prej tyre e në vete nuk i ka këto shenja, atëherë ai është mendjemadh e kryengritës.

---

<sup>2</sup>Taberani në “*el-Kebir*”, nga Ibn Mesud,

## FAZILETI I SHPRESËS DHE NXITJA NË TË

Dije se veprimi me shpresë është më i pranueshëm se sa veprimi me frikë. Sepse robët më së afërti Allahut janë ata që më së shumti e duan Allahun. Ndërsa dashuria shton shpresën, e jo frikën.

Këtë mund ta krahasosh me dy sundimtarë, ku njërit prej tyre ti i shërben sepse i frikësohesh dhe tjetrit sepse e do. Grada jote te sundimtari të cilit i shërben nga dashuria është më e lartë se grada jote te sundimtari të cilit i shërben nga frika. Prandaj kanë inkurajuar në shpresë dhe mendime të mira. Sidomos në kohën e vdekjes - goftë gjynahqar apo jo - njeriu duhet të ketë shpresë. Në fakt dëshpërimin e kemi të ndaluar me urdhër:

**“Mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut!”**

39-Zumer: 53.

Tregohet se Allahu Teala i tha Jakubit, a.s:

**“A e di pse të ndava nga Jusufi? Sepse ti the:**

**- *Frikësohem mos e ha ujku nëse ju nuk kujdeseni për të!* Pse iu frikësove ujkut, e nuk mu frikësove Mua?! Si munde të mendosh se a do ta mbrojnë vëllezërit, e nuk mendove në mbrojtjen Time?”**

Edhe Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

***“Kur të vdesësh, vdis duke menduar mirë për Allahun Teala.”***<sup>3</sup>

Në një hadith kudsî, Resulallahu, s.a.v.s., tregon se Allahu Teala ka thënë:

***“Unë jam ashtu si robi Im mendon për Mua, e robi le të mendojë për Mua çfarë të dojë.”***<sup>4</sup>

Resulallahu, s.a.v.s., vizitoi një person që ishte në prag të vdekjes, dhe e pyeti:

- ***Si po ndihesh?*** Personi tha:

- *Po frikësohem për gjynahet e mia, por edhe po shpresoj në rahmetin e Rabbit tim.*

Atëherë Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Kur këto dyja bashkohen në zemrën e robit, dhe në këso situatë, Allahu Teala sigurisht që do t'i japë atë që robi shpreson, dhe e mbron nga ajo që robi i frikësohet.***<sup>5</sup>

---

<sup>3</sup> Muslimi, nga Xhabiri

<sup>4</sup> Ibn Hibban, nga Vasile ibn el-Eska, ndodhet në Sahihë të Buharit dhe Muslimit, nga Ebu Hurejre, pa pjesën ***“le të mendojë për Mua çfarë të dojë”***.

<sup>5</sup> Tirmidhi, që e quan *garib*, Nesai në *“el-Kubra”* dhe Ibn Maxhe, nga Enesi, r.a.. Nevevi thotë se hadithi ka zinxhir të besueshëm

Një personi, i cili nga frika e gjynaheve të tij të shumta e humbi shpresën, Alia, r.a., i tha: *“O njeri! Humbja e shpresës tënde në rahmetin e Allahut është më e rrezikshme se të gjitha gjynahet që i ke bërë!”*

Sufjani se Servi ka thënë: *“Kushdo që bën një gjynah dhe e di se Allahu është në gjendje ta falë atë gjynah dhe nëse shpreson ta falë, Allahu do ta falë, sepse Allahu Teala duke qortuar një popull, thotë:*

**- Mendimi juaj i gabuar, të cilin e patët ndaj Rabbit tuaj, është ai që ju shkatërroi dhe tani jeni më të dëshpëruarit.** (41:23), dhe thotë:

**- Ju ushqyet mendime shumë të këqija dhe kështu u bëtë popull i pavlefshëm i nisur drejt shkatërrimit.** (48:12).”

Resulallahu, s.a.v.s., thotë: **“Allahu Teala do ta pyesë robin e Vet në ditën e Gjykimit:**

**- Çfarë të pengoi të parandalosh të keqen edhe pse e shihje?; dhe nëse Allahu Teala ia frymëzon arsyetimin robit të Tij, robi thotë:**

**- O Rabbi im, shpresoja në faljen Tënde, u frikësohesha nga njerëzit, prandaj nuk e bëra detyrën time”. Atëherë Allahu Teala do të thotë:**

**- Të kam falur!”<sup>6</sup>**

---

<sup>6</sup> Ibn Maxhe, nga Ebu Seid Hudri



Në një hadith *sahih* shkruan:

**“Një person u jepte para hua njerëzve, ishte i butë dhe tolerant ndaj atyre që kishin, ndërsa të varfërve edhe ju falte borxhin. Personi vdiq, pa asnjë vepër tjetër të mirë, e Allahu Teala i tha:**

**- *Kush ka në atë më shumë të drejtë se Ne?!*”<sup>7</sup>,**  
dhe e fali, për shkak të butësisë dhe faljes së tij, ani që nuk kishte vepra tjera të mira.

Allahu Teala thotë:

**“Ata që lexojnë librin e Allahut, e falin namazin dhe nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi, ata e shpresojnë një fitim që kurrë nuk humbet.”**

35-Fatir: 29

Kur Resulallahu, s.a.v.s., tha:

**“Sikur ta dinit atë që e di unë, pak do të qeshnit e shumë do të qanit; do të dilnit rrugëve dhe me duar do të godisnit gjokset e juaja; dhe të penduar do ta luteshit Rabbin tuaj”<sup>8</sup>,**

zbriti Xhebraili, a.s., dhe i tha:

**- *Rabbi yt të thotë: “Përse i dëshpëron robët e Mi?***

---

<sup>7</sup> Muslim, nga Ebu Mesud. Buhari e Muslim nga Huzejfe dhe Ebu Hurejre, të ngjashëm.

<sup>8</sup> Ibn Hibban në *Sahih* të tij, nga Ebu Hurejre, e është përmendur më herët.

Pas kësaj, Resulallahu s.a.v.s., doli para njerëzve e ju foli për shpresën, dhe i inkurajoi ata të shpresojnë në rahmetin e Allahut.

Thuhet se Allahu Teala i tha Davudit, a.s.:

**- O Davud, më duaj Mua, duaji ata që më duan Mua dhe bëji robët e Mi të më duan Mua.**

Davudi a.s., tha:

- *O Rabbi im! Si ta bëj këtë?*, e Allahu Teala i tha:

**- Më përmend për të mirë, fol për nimetet dhe mirëbërjen Time; përkujtoi se ata prej Meje kanë vetëm të mira.”**

Eban ibn Ebu Ajjash, vazhdimisht fliste për shpresën dhe ua hapte njerëzve dyert e shpresës, e kur vdiq, njëri pa në ëndërr si Eban tha:

*“Allahu Teala më mori para Vetes e më pyeti pse flisja vazhdimisht për shpresën.*

*Unë thashë:*

*-- Doja që njerëzit të duan Ty;*

*e Allahu Teala më tha:*

**- Të kam falur!”**

Kur vdiq Jahja ibn Eksem, njëri e pa në ëndërr dhe e pyeti:

- *Çfarë bëri Allahu Teala me ty?*,

e Jahja tha:

- *Më mori para Vetes e më tha:*

***“O plak i keq, çfarë ke bërë!”***

*Më kaploi frikë e madhe, e thashë:*

- *O Rabbi im! Kështu kam folur për ty!*

*Më pyeti:*

- ***E çfarë ke folur për Mua? Thashë:***

- *Më ka thënë Abdulrezzak, duke përcjellë nga Ma’mer, ai nga Zuhri, ky nga Enesi, e ai nga Resulallahu, s.a.v.s., e Resulallahu nga Xhebraili, a.s., se Ti ke thënë:*

***“Unë jam ashtu si robi Im mendon për Mua, e robi le të mendojë për Mua çfarë të dojë”***, e unë mendova se nuk do të më dënosh. Allahu Teala tha:

- ***Të vërtetën e ka thënë Xhebraili, të vërtetën e ka thënë edhe i Dërguari Im, të vërtetën e kanë thënë të tjerët e edhe ti e the të vërtetën.***

Tregohet se një jahudi vazhdimisht i bënte njerëzit të dëshpëroheshin dhe ju vështirësonte. Në ditën e Gjykimit, Allahu Teala do t'i thotë atij:

- ***Ti i privoje robët e mi nga mëshira lme, prandaj edhe Unë sot do të privoj ty nga kjo mëshirë.***<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup> Bejheki në *“esh-Shuab”* nga Zejd ibn Eslem

Resulallahu, s.a.v.s., ka treguar:

**“Një person dërgohet në xhehenem dhe atje qëndron një mijë vjet, duke lavdëruar vazhdimisht:**

- *O Rahman! O Ti që shumë dhuron!,*

**e Allahu Teala i thotë Xhebrailit, a.s.:**

- *Shko e ma sjell robin Tim!*

**Xhebraili a.s., e sjell para Allahut, e Allahu Teala e pyet:**

- *Si të duket vendi yt?, e personi thotë:*

- *Vendi më i tmerrshëm!*

**Allahu Teala thotë:**

- *Kthejeni në vendin e tij! Derisa largohet, personi shikon prapa, e Allahu Teala e pyet:*

- *Pse po shikon prapa?, e personi thotë:*

- *Mbajta shpresë se nuk do të më kthesh në atë vend pasi që më nxore nga aty; e Allahu Teala thotë:*

- *Çojeni në xhennet!*<sup>10</sup>

E shohim se si shpresa e tij u bë sebeb i shpëtimit të tij.

---

<sup>10</sup> Ibu Ebu Dun’ja, nga Enesi.

## ILAÇI PËR SHPRESËN

Dije se, për sa i përket shpresës, dy lloj njerëzish kanë nevojë për shërim; njëri është personi të cilin e ka zaptuar dëshpërimi dhe ka braktisur ibadetin, e tjetri është personi të cilin e ka kapluar frika dhe e tepron në ibadet duke dëmtuar veten e familjen. Këta dy lloj njerëzish janë larguar nga maturaia, dhe kanë rrëshqitur në teprim. Kjo është arsyeja pse ata kanë nevojë për shërim, që shërimi t'i kthejë në maturi.

Sa për gjynahqarin e mashtruar, që mban shpresë në rahmetin e Allahut ndërsa braktisë ibadetet e lëshohet në gjynahe, ilaçi i shpresës mund të bëhet helm për personin e tillë. Ai mund të shërohet vetëm me frikë dhe me sebepe të cilat, kur i kujtohen, ia ngjallin frikën. Prandaj vaizi duhet t'i njohë mirë sebetet e sëmundjeve dhe secilën sëmundje ta shërojë me të kundërtën e saj, e të mos përdor atë që do ta forconte sëmundjen.

Sepse ajo që kërkohet në të gjitha cilësitë dhe në ahlak është e mesmja (maturia). Veprimi më i mirë është e mesmja. Secili largim nga maturaia shërohet me atë që personin do ta kthejë në maturi (në rrugë) e jo me atë që edhe më shumë do ta largojë.

Koha në të cilën jetojmë është kohë kur nuk duhet t'i hapim shumë dyert e shpresës. Por nuk duhet as të frikësojmë tepër. Sepse teprimi me cilën do prej tyre mund të mos e afrojnë personin në maturi. Ashtu si frikësimi i tepërt që mund ta çojë personin në dëshpërim edhe shpresa e tepërt mund ta shkatërrojë plotësisht. Mirëpo për shkak që fjalët për shpresën janë më të lehta për zemrat dhe të këndshme për nefsin, vaizi, për të tërhequr zemrat dhe për të fituar famë mes njerëzve, preferon të japë shumë shpresë, pa marrë parasysh që kjo veç sa e shton dëmin. Gjynahqari vazhdon në gjynahe me shpresën e nxitur nga vaizi. Prandaj Alia r.a., ka thënë: *“Dituri e vërtetë është ajo që te njerëzit ngjallë shpresën në rahmetin e Allahut, por nuk i bën të ndihen të sigurt nga dënimi i Allahut.”*

Ne këtu do të flasim për atë që ngjallë shpresën që kjo të përdoret te ata që janë të pikëlluar ose te ata që i ka mbizotëruar frika, e duke ndjekur librin e Allahut dhe sunnetin e të Dërguarit të Tij, s.a.v.s., sepse këto dyja përmbajnë edhe frikën edhe shpresën, si edhe mënyrat e shërimit të të sëmurëve të ndryshëm, e krejt kjo me qëllim që të përdoret nga dijetarët, trashëgimtarë të pejgamberëve të Allahut Teala, kur ju duhet dhe ashtu si mjeku i mirë që përdorë ilaçin, e jo ashtu si bëjnë të paafitit, që mendojnë se çfarëdo ilaçi është i mirë për cilën do sëmundje.

Gjendja e shpresës mund të zbutet në dy mënyra: duke nxjerrë mësim, dhe duke lexuar ajetet, hadithet e transmetimet.

*Nxjerrje e mësimit* është të mendojë për të gjitha ato nimete që i përshkruam në *Librin për durim dhe falënderimin*, e të kujtojë nimetet e panumërta të Allahut, që Ai ua dhuroi robëve të Tij në këtë botë, dhe urtësinë e Tij në krijimin e natyrës së njeriut, se si njeriut i përgatiti gjithçka që i duhet në jetë; ushqim, gishta, thonj, zbukurim me vetulla si hark, ngjyrat e syve, buzët e kuqe, e me radhë, që mungesa e ndonjërës do t'ia cenonte formën e bukur. Kur personi i di këto, ai mund të mendojë se si mundet të jetë Allahu i Plotfuqishëm i kënaqur që ta dërgojë në shkatërrim të përhershëm njeriun, kur i dha krejt çka i nevojitet, si edhe zbukurime?

Sikur njeriu pak të shikojë e mendojë, ai e kupton se Allahu Teala shumicës së krijesave ju dhuroi mjete të lumturisë edhe në këtë botë, prandaj njeriu, edhe po ta dijë se nuk dënohet në ahiret, prapë nuk do ta dojë vdekjen; jo vetëm pse nuk i pëlqen zhdukja e vetes, por edhe për shkak të bollëkut të nimeteve që mbesin në këtë botë pasi ai të vdes. Ata që e dëshirojnë vdekjen janë pak, e edhe këta vdekjen e dëshirojnë në raste të rralla, kur janë në gjendje të vështira a të çuditshme.

Shumica në këtë botë jetojnë në mirëqenie dhe paqe. Duke qenë se nuk ka ndryshim në ligjin e Allahut Teala (*sunnetullah*), ka shumë mundësi që edhe jeta në ahiret të jetë kështu. Sepse Ai, i Cili e krijoi dynjanë dhe ahiretin është Një, e Ai falë dhe është i Gjithëmëshirshëm dhe Mirëbërës ndaj robëve të Tij. Nëse njeriu mendon sinqerisht për të gjitha këto, do të ketë më shumë arsye për shpresë.

Për të nxjerr mësim, mendo edhe për urtësinë e caktimit të ligjeve dhe rregullave që kanë për qëllim t'ia mundësojnë njeriut qëllimet e kësaj bote, shih çfarë mirësie kanë robët nga kjo! Bile, njëri prej arifëve e konsideronte ajetin 282 të sures Bekare, që flet për borxhin, si një nga sebeptet më të forta për shpresë. Dikush e pyeti:

- *Çfarë është sebepi i shpresës në këtë ajet?*; e arifi tha:  
- *Gjithë kjo dynja është kaq e vogël, e padyshim se në këtë dynja të vogël edhe risku i njeriut është pak. Ndërsa borxhi është vetëm një pjesë e vogël e atij risku. E shih si Allahu Teala zbriti ajetin më të gjatë për borxhin, dhe e udhëzoi robin e Tij në rrugën e kujdesit për ta ruajtur fenë e vet. E si të mos e ruajë fenë e vet robi i Tij, kur ajo fe nuk ka barasvlerë, as në këtë botë e as në ahiret?!*



Sa për ajetet dhe hadithet; ka shumë prej tyre që flasin për shpresën:

***“Thuaj: “O robët e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti”.*** (39-Zumer: 53), e kur Resulallahu, s.a.v.s., lexoi këtë ajet, tha: ***“Ai di çdo gjë, të fshehtat tona dhe veprimet e hapura. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti.”***

***“Melaiket vazhdimisht madhërojnë (bëjnë tesbih) duke e falënderuar Rabbin e tyre dhe kërkojnë falje për ata që janë në tokë.”*** 42-Shura: 5

Allahu Teala tregon se zjarrin e bëri gati për armiqtë e Tij, dhe me të vetëm i frikëson robët e Tij të singertë:

***“Ata do të kenë shtresa të zjarrit edhe sipër edhe përfundi. Me këtë Allahu i frikëson robët e Vet.”***

39-Zumer: 16

***“Dhe ruajuni zjarrit, i cili është përgatitur për jobesimtarët!”*** 3-Ali Imran: 131

***“U kam tërhequr vërejtjen për zjarrin e nderur fort. Që aty nuk hyn tjetër, pos atij që është më i prishuri. I cili përgënjeshton dhe kthen shpinën.”***

92-Lejl: 14-16

**“Rabbi yt i falë njerëzit, përkundër mizorive të tyre.”**

13-Rad:6.

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., vazhdimisht kërkonte falje nga Allahu Teala për ummetin e vet, e i ishte thënë:

***“A nuk je i kënaqur pas zbritjes së këtij ajeti?”***

Duke komentuar ajetin: **“Sigurisht që Rabbi yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur”** (93:5), Resulallahu, s.a.v.s., tha:

***“Muhammedi nuk do të jetë i kënaqur deri sa të jetë qoftë edhe një prej ummetit të tij në xhehenem.”***

Ebu Xhafer Muhammed ibn Ali ka thënë: *“Ju o Irakianë thoni se më së shumti shpresë ju jep ajeti:*

***“Thuaj: “O robët e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti”*** (39-Zumer: 53), *e ne, ehli-bejti i Resulallahut, s.a.v.s., themi se më së shumti shpresë jep ajeti:*

***“Sigurisht që Rabbi yt do të të japë ty, sa të jesh i kënaqur”*** (93-Duha: 5).

Ebu Musa tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Ummetit tim i është dhuruar rahmet dhe nuk do të ketë dënim për ummetin tim në ahiret. Allahu Teala do ta ndëshkojë ummetin tim me tërmete dhe grindje në këtë botë, e në ditën e Gjykimit secilit individ prej ummetit tim do t'i dorëzohet një person nga ehli-kitab dhe do t'i thuhet: “Ky është shpagesa jote prej zjarrit!”<sup>11</sup>, e në transmetim tjetër thuhet:***

***“Secili nga ky ummet shkon në xhehenem me një çifut ose një të krishterë dhe thotë: “Ky është shpagesa ime nga xhehenemi” dhe ai (i krishteri ose çifuti) hidhet në xhehenem.”<sup>12</sup>***

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Ethet janë nga nxehtësia e xhehenemit; është hise e besimtarit nga xhehenemi.”<sup>13</sup>***

Në lidhje me komentimin e ajetit:

***“Ditën kur Allahu nuk e turpëron Pejgamberin, as ata që besuan bashkë me të” (66:8), transmetohet se Allahu Teala i shpalli Resulallahut, s.a.v.s.:***

***- Llogarinë e ummetit tënd do ta dorëzoj ty.***

---

<sup>11</sup> Ebu Davudi, pa pjesën e dytë, e me këtë përmbajtje shënon Ibn Maxhe nga Enesi, me zinxhir të dobët.

<sup>12</sup> Muslimi, nga Ebu Musa, e Muslimi sjell edhe versione tjera të kësaj.

<sup>13</sup> Ahmedi, nga Ebu Salih el Esh'ari.

Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Jo, o Rabbi im! Ti ndaj tyre je më i mëshirshëm se unë!***, e Allahu Teala tha:

- ***Pra, nuk do të turpërojmë me ta.***

Enesi r.a. transmeton se Resulallahu, s.a.v.s., kërkoi falje nga Allahu Teala për gjynahet e ummetit të tij, e tha:

- ***Rabbi im! Ma dorëzo llogarinë e ummetit tim, që askush pos meje mos t'i shohë gjynahet e tyre;*** e Allahu Teala i shpalli:

- ***Ata janë ummeti yt, por janë edhe robë të Mi, e Unë jam më i mëshirshëm se ti. Askujt nuk do t'ia dorëzoj llogarinë e tyre, që as ti e askush tjetër të mos i shohë gjynahet e tyre.***

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

***“Edhe jeta ime edhe vdekja ime janë të dobishme për ju. Jeta ime është e dobishme për ju, sepse ju sjell sheriatin dhe sunnetin. Vdekja ime është e dobishme, sepse më tregohen veprat e juaja; kur shoh veprat e juaja të mira, falënderoj Allahun, kur shoh të metat e juaja, kërktoj falje nga Allahu për ju.”***<sup>14</sup>

---

<sup>14</sup> Bezzar, nga Abdullah ibn Mesud, si edhe Haris ibn Ebu Usame në veprën *Musned*, nga Enesi r.a..

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., një ditë tha:

**“O Ti që falë me fisnikëri!”**, e Xhebraili a.s., e pyeti:

- **A e di ti se çfarë do të thonë fjalët “O Ti që falë me fisnikëri”?** Kjo do të thotë se Allahu Teala me rahmetin e Tij i falë gjynahet, e me Fisnikërinë e Tij i kthen ato në sevape.

Resulallahu, s.a.v.s., dëgjoi një person duke thënë:

- **O Allahu im! Dua nimetin Tënd të plotë!** Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti:

- **A e di ti se çfarë do të thotë “nimet i plotë”?**

- **Nuk e di**, tha ai, e Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- **Kjo do të thotë të hysh në xhennet.**

Dijetarët kanë thënë: “Allahu Teala e plotësoi nimetin e Tij ndaj nesh duke na zgjedhur fenë islame”, sepse:

**“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë (nimet) Time ndaj jush dhe zgjedha Islamin të jetë feja juaj.”** 5-Maida: 3

Në një hadith thuhet: **“Kur robi bën një gjynah, e pastaj bën teube, Allahu Teala ju thotë melaikeve të Tij:**

- **Shihni robin Tim! Ai bëri një gjynah, dhe e di se ka një Rabb që i falë gjynahet, por edhe dënon, dhe bëri teube. Prandaj, bëhuni dëshmitarë që e fala!”**<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre

Gjithashtu:

**“Nëse robi Im bën gjynahe që arrijnë edhe lartësitë e reve në qiell, Unë do ta fal atë përderisa ai nuk e humb shpresën tek Unë dhe kërkon falje.”<sup>16</sup>**

**“Nëse robi Im më takon Mua me gjynahe sa mund të bartë Toka, Unë do ta takoj robin Tim me po aq shumë falje.”<sup>17</sup>**

**“Kur robi bën një gjynah, meleku nuk ia shkruan për gjashtë orë, e nëse robi pendohet dhe kërkon faljen, meleku nuk ia shënon gjynahun fare në librin e tij. Nëse nuk pendohet, atëherë ia shkruan një gjynah.”**

E në transmetim tjetër vazhdohet:

**“Kur i shkruhet vepra e keqe në librin e tij, e robi pastaj bën një vepër të mirë, meleku në të djathtën, që është kryesori, i thotë melekut në të majtë:**

**- *Fshije atë vepër të keqe që unë ta fshij një vepër të mirë nga dhjetë vepra të mira të tij dhe t'i shkruaj nëntë të mirat e tij.*”<sup>18</sup>**

---

<sup>16</sup> Tirmidhi, nga Enesi r.a..

<sup>17</sup> Muslimi, nga Ebu Dherr

<sup>18</sup> Bejheki nga Ebu Umame.

Enesi ka treguar se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Kur robi bën një gjynah, kjo shkruhet në librin e tij.”**

Një beduin pyeti:

- *Çfarë ndodh nëse bën teube?*, e Resulallahu, s.a.v.s.,

tha:

- **Atëherë gjynahi i fshihet.** Beduini prapë pyeti:

- *Çka nëse bën përsëri gjynah?*

Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Përsëri i shkruhet.** Beduini pyeti:

- *Nëse prapë bën teube?* Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Prapë gjynahi i fshihet.** Beduini prapë pyeti:

- *E deri kur vazhdon fshirja nga libri?*, e Resulallahu,

s.a.v.s., tha:

- **Vazhdon deri sa robi të bëjë teube (të pendohet) e të kërkojë faljen prej Allahut Teala, sepse Allahu Teala nuk lodhet prej faljes përderisa robi nuk lodhet nga kërkim-falja. Kur robi synon të bëjë një vepër të mirë, meleku në të djathtën ia shkruan një vepër të mirë në librin e tij para se ky ta bëjë, e kur bën veprën e mirë që e ka pasur synim, i shkruhet sikur t'i ketë bërë dhjetë, e më pas Allahu këtë e shton, deri edhe në shtatëqind herë. E nëse robi synon të bëjë vepër të keqe, asgjë nuk shkruhet para se ta bëjë atë, e kur e bën veprën e keqe që e ka pasur synim, i shkruhet një vepër e keqe në librin e tij. Pas kësaj edhe në të ardhmen ka falje nga Allahu Teala.**<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> Bejheki në veprën ‘*Shuabu’l- Iman’*

Një person erdhi te Resulallahu, s.a.v.s., e i tha:

- *O i dërguar i Allahut! Unë agjëroj vetëm muajin e Ramazanit e asgjë më shumë; i fali vetëm pesë vakte namaz dhe asgjë më shumë; nuk kam pasuri që do të më obligonte me zeqat, e as nuk kam për ta kryer haxhin apo donjë vepër tjetër të mirë. Ku e kam unë vendin kur të vdes?* Resulallahu, s.a.v.s., u buzëqesh, dhe tha:

- ***Po, ti do të jesh me mua, nëse e ruan zemrën nga dy gjëra: urrejtja e fshehtë dhe haseti; gjuhën nga dy: përgojimi dhe gënjeshtat; sytë nga dy: shikimin në atë që Allahu Teala e ka ndaluar dhe të mos nënçmojë me shikim muslimanin. Nëse i përmbush këto, do të jesh me mua.***<sup>20</sup>

Në një hadith më të gjatë të transmetuar nga Enesi, një beduin pyeti:

- *O i dërguar i Allahut! Kush do t'i kërkojë llogari të gjithë këtyre njerëzve në ditën e Gjykimit?*, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Allahu Teala!*** Beduini prapë pyeti:

- *Ai, vetë?!*, e Resulallahu, s.a.v.s., pohoi. Atëherë beduini buzëqeshi, e Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti:

- ***Pse po buzëqesh?*** Beduini tha:

- *Sepse Ai, Fisniku, që është në gjendje të falë, kur kërkon llogari – tregon mirëkuptim.* Atëherë Resulallahu, s.a.v.s., tha:

---

<sup>20</sup> Është përmendur më parë.



- **Të vërtetën e tha beduini! Vërtetë që askush nuk është më fisnik se Allahu Teala, Ai është më Fisniku mes të gjithë fisnikërisë!** , e më pas tha:

**“E kuptoi beduini. Allahu Teala e nderoi dhe e lartësoi Qabenë; po ta rrëronte robi Qabenë, gur pas guri, e më pas ta djegë, kjo nuk do ta arrinte masën e gjynahut të atij që nënçmon e poshtëron një mik (evlia) të Allahut.”**

Beduini pyeti:

- **Kush është mik i Allahut?**, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Të gjithë besimtarët janë miq të Allahut Teala. A nuk i dëgjove fjalët e Tij:**

**“Allahu është Mbrojtësi i atyre që besojnë. Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë.”** (2:257).

Në hadithe është thënë:

**“Besimtari është më me vlerë se Qabeja”<sup>21</sup>,**

**“Besimtari është i pastër dhe i virtytshëm.”<sup>22</sup>,**

**“Besimtari është tek Allahu më i vlefshëm se meleku.”<sup>23</sup>**

Gjithashtu:

**“Allahu Teala e krijoi xhehenemin nga mirësia e rahmetit të Tij, si kamxhik me të cilin i dërgon robët e Vet në xhennet.”<sup>24</sup>**

---

<sup>21</sup> Ibn Maxhe nga Ibn Omer.

<sup>22</sup> Buhari dhe Muslim nga Huzejfe.

<sup>23</sup> Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

Në një hadith tjetër shkruan se Allahu Teala thotë:

***“Krijesat i krijova që ato të përfitojnë prej Meje, jo unë prej tyre.”***<sup>25</sup>

Ebu Seid Hudri tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Nuk ka asgjë që Allahu Teala ka krijuar pa krijuar diçka që mund ta mposht atë. Dhe Ai e krijoi rahmetin e Tij të tillë që ta mposht zemërimin e Tij.”***<sup>26</sup>

Në një hadith të njohur thuhet:

***“Para se të krijonte krijesat, Allahu Teala shkroi dhe tha për rahmetin e Tij: “Sigurisht që rahmeti Im e mposht zemërimin Tim.”***<sup>27</sup>

Muadh ibn Xhebel dhe Enes ibn Malik transmetojnë se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Kush thotë sinqerisht: “La ilahe illallah!, do të hyjë në xhennet.”***<sup>28</sup>

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Atë që fjalët e fundit i ka “la ilahe ilallah” nuk do ta prekë zjarri i xhehenemit.”***<sup>29</sup>

---

<sup>24</sup> Nuk u gjet në këtë formë. Një i ngjashëm gjendet te Buhari

<sup>25</sup> Nuk është gjetur në burime.

<sup>26</sup> Ibn Hibban n *es-Sevab*.

<sup>27</sup> Muttefekun alejhi, nga Ebu Hurejre.

<sup>28</sup> Taberani nga Zejd ibn Erkam, është përmendur më parë.

**“Kush e takon Allahun pa i përshkruar ortak Atij, zjarri i xhehenemit është i ndaluar - haram për atë.”<sup>30</sup>**

**“Ai që ka qoftë edhe vetëm një grimcë iman zemrën e tij, nuk do të hyjë në xhehenem.”<sup>31</sup>**

**“Sikur jobesimtari ta dinte rahmetin e gjerë të Allahut, asnjëri prej tyre nuk do ta humbiste shpresën për xhennet.”<sup>32</sup>**

Kur Resulallahu, s.a.v.s., lexoi ajetin:

**“...dridhja e Orës (së Kiametit), është vërtet një ngjarje e madhe!”** 22-Haxh: 2, tha:

**“A e dini cila është ajo ditë? Kjo do të ndodhë atë ditë kur Ademit a.s., t’i thuhet:**

**- Çohu, ndaj ata nga pasardhësit tuaj që do të hynë në xhehenem e afroji në xhehenem. Ademi a.s. do të pyesë:**

**- Sa prej tyre?, e do t’i thuhet:**

**- Nga çdo njëmijë, nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë janë për xhehenem, një për xhennet.”**

---

<sup>29</sup> Ebu Davud dhe Hakimi, nga Muadh.

<sup>30</sup> Buhari dhe Muslim, nga Enesi.

<sup>31</sup> Ahmedi, nga Sehl ibn Bejd.

<sup>32</sup> Muttefekun alejhi, nga Ebu Hurejre.

Kur e dëgjuan këtë, as'habët ranë në dëshpërim, filluan të qajnë dhe atë ditë nuk shkuan në punët e tyre. Resulallahu, s.a.v.s., i pyeti pse nuk punojnë, e ata thanë:

- *Kush mund të punojë pas asaj që na tregove?!*, e Resulallahu, s.a.v.s., ju tha:

- ***Ku është numri juaj mes popujve tjerë? Ku janë popujt Tavil, Saris, Mensik, Je'xhud e Me'hxuxh, popuj që veç Allahu Teala ju di numrin. Ju jeni në mesin e popujve tjerë si një qime e bardhë në shpinën e një kau të zi dhe si shenja në këmbën e përparme të një kafshe.***<sup>33</sup>

Mendo për këtë. Resulallahu, s.a.v.s., i nxiti njerëzit drejt Allahut me kamxhikun e frikës, e më pas i tërhoqi ata Allahut me litarin e shpresës. Fillimisht i frikësoi, e kur vërejti se kjo shkaktoi dëshpërim, atëherë i shëroi me ilaçin e shpresës dhe i ktheu në rrugën e mesme e në qëllimin kryesor. E dyta nuk është në kundërshtim me të parën. Por së pari, Resulallahu s.a.v.s, u tregoi atyre atë që e pa si sebeb për shërimin e tyre, e kur pa se kishin nevojë për shërim edhe me shpresë, e tregoi të gjithë ngjarjen.

Prandaj detyra e vaizit është ta ndjek rrugën e Resulallahut s.a.v.s, zotërinë e vaizëve, dhe të përdor mjetet e frikës dhe shpresës sipas nevojës, duke marrë parasysh sëmundjet e brendshme. Vaizi që nuk i përmbahet kësaj, bën më shumë dëm se hair.

---

<sup>33</sup> Tirmidhi, nga Imran ibn Husajn.

Resulallahu s.a.v.s, ka thënë: **“Sikur ju të mos kishit bërë gjynahe, Allahu Teala do të krijonte një popull që bën gjynahe, që t’ju falë.”**<sup>34</sup>, e në një transmetim tjetër:

**“Sikur ju të mos bënit gjynahe, do të frikësohesha për ju nga diçka që është edhe më e keqe se gjynahu.”**

- *Çfarë është ajo?*; pyetën, e u përgjigj:

- ***Vetëpëlqimi dhe mendjemadhësia!***<sup>35</sup>

**“Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, Allahu Teala është më i mëshirshëm ndaj robit të Tij se sa nëna e mëshirshme ndaj fëmijës së vet.”**<sup>36</sup>

**“Vërtetë që Allahu Teala në ditën e Gjykimit do të shpallë një falje të përgjithshme që askush nuk mundet as ta paramendojë. Bile edhe Iblisi do të guxojë të shpresojë se kjo falje do ta përfshijë edhe atë.”**<sup>37</sup>

**“Allahu Teala ka njëqind mëshirë – rahmet. Nëntëdhjetë e nëntë i ka mbajtur për Vete, e vetëm një e ka zbrit në këtë botë; përmes këtij rahmeti krijesat ndjejnë dhembshuri mes vete dhe kanë mëshirë ndaj njëra-tjetrës, përmes atij rahmeti nëna është e butë dhe e mëshirshme ndaj fëmijës së vet, përmes atij rahmeti edhe kafsha ka mëshirë ndaj të voglit të vet.**

---

<sup>34</sup> Muslimi nga Ebu Ejjub Halid ibn Zejdi r.a

<sup>35</sup> Bezzer dhe Ibn Hibban në **‘Dhuafa’** nga Enesi.

<sup>36</sup> Muttefekun alejhi, nga Omeri r.a.

<sup>37</sup> Ibn ebu Dun’ja, nga Ibn Mesud

**E në ditën e Gjykimit Allahu Teala atë rahmet do t'ia shtojë atyre nëntëdhjetë e nëntë rahmeteve, dhe të gjithin do ta lëshojë mbi krijesat e Tij, e madhësia e secilit prej atyre njëqind rahmeteve është sa madhësia e qiejve dhe Tokës; atë ditë vetëm ata që kanë merituar plotësisht të shkatërrohen do të shkatërrohen, e te Allahu Teala është shkatërruar vetëm kryengritësi i përbuzur.”<sup>38</sup>**

Resulallahu, s.a.v.s., tha: **“Asnjërin prej jush veprat e veta nuk do ta dërgojnë në xhennet as ta shpëtojnë nga xhehenemi.”** As'habi pyeti:

- *As ty, o i dërguar i Allahut?* Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***As mua, por mua më ka mbuluar rahmeti i Allahut.***<sup>39</sup>

**“Punoni e gëzohuni; por dijeni se asnjërin nga ju nuk do ta shpëtojnë veprat e veta!”<sup>40</sup>**

**“Vërtetë unë e ruajta shëfatim tim për gjynahqarët e mëdhenj nga ummeti im! Mendoni se shëfati im do të jetë për ata që zbatojnë urdhrat e të devotshmit? Shëfati im është për ata që janë përllyer me gjynahe e që janë fundosur në to!”<sup>41</sup>**

---

<sup>38</sup> Muttefekun alejhi, nga Ebu Hurejre

<sup>39</sup> Muttefekun alejhi, nga Ebu Hurejre.

<sup>40</sup> Është përmendur më parë.

<sup>41</sup> Buhari dhe Muslim Nga Ebu Hurejre, Tirmidhi, Ibn Maxhe nga Xhabiri, Ahmed i nga Ibn Omeri.

**“Jam dërguar me fe të vërtetë, të pastër, të thjeshtë, të lehtë.”<sup>42</sup>**

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë: **“Dua që pasuesit e të dy Librave (Tevrat e Inxhil) ta dinë se feja jonë është tolerante.”<sup>43</sup>** Në këtë kuptim tregon edhe fakti se Allahu Teala u përgjigjet lutjeve të besimtarëve kur iu lutën:

**“Rabbi ynë, mos na ngarko neve barrë të rëndë siç i ngarkove ata që ishin para nesh!”** 2-Bekare: 286, dhe:

**“...heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta.”** 7-Araf: 157

Muhammed ibn Hanefi transmeton se Alia r.a., ka treguar: **“Kur zbriti ajeti: “...andaj ti sillu me zemërgjerësi” (15:85), Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti Xhebrailin:**

- **Çka është kjo “zemërgjerësi”?!,** e Xhebraili a.s., tha:  
- Kjo është kur e falë personin që të ka bërë padrejtësi, nuk e qorton më; e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **O Xhebrail! Allahu Teala është aq fisnik saqë nuk qorton atë që e falë.** Atëherë Xhebraili, a.s., filloi të qajë, e me të edhe Resulallahu, s.a.v.s., qau. Allahu Teala ju dërgoi Mikailin, a.s., i cili ju tha:

- **Rabbi juaj po ju dërgon selam dhe thotë:**  
**“Si ta qortoj Unë atë që e kam falur?! Qortimi Im nuk është si fisnikëria Imë.”**

---

<sup>42</sup> Ahmedî nga Ebu Umame, si dhe Taberani nga Ibn Abbas.

<sup>43</sup> Ebu Ubejd në veprën *Garibul-hadith*, si edhe Ahmedî.

Ka edhe shumë hadithe tjera që flasin për shpresën. Edhe as'habët dhe gjenerata e parë (*selefi salihin*), gjithashtu kanë folur për shpresën.

Alia, r.a., ka thënë: *“Kush bën një gjynah, e Allahu Teala ia fshehn në këtë botë - Allahu është aq fisnik sa nuk do t'ia zbulojë as në ahiret. E kush bën një gjynah, dhe për të dënohet në këtë botë – Allahu është aq i drejtë sa nuk do ta dënojë edhe një herë në ahiret.”*

Sufjan es-Sevri ka thënë: *“Llogarinë time nuk do t'ia besoja as prindërve të mi, sepse e di me siguri se Allahu Teala është më i mëshirshëm ndaj meje se ata.”*

Njëri nga *selefi salihin* ka thënë: *“Kur besimtari bën një gjynah të fshehtë, Allahu e fshehë këtë nga melaiket që mos ta shohin e të mos ia shënojnë në librin e tij.”*

Muhammed ibn Saib i shkroi Esved ibn Salimit:

*“Kur gjynahqari ngrit duart duke iu lutur Allahut:*

*- O Rabbi im!;*

*melaiket e pengojnë zërin e tij, e ashtu edhe herën e dytë e të tretë, por kur robi ngritë duart dhe lutet për herë të katërt:*

*- O Rabbi im!;*

*atëherë Allahu Teala thotë:*



**- Deri kur do ta pengoni zërin e robit Tim? Robi im e ka kuptuar se nuk ka askush që mund t'ia falë gjynahet përveç Meje dhe u strehua tek Unë. Jeni dëshmitarë se e fala."**

Ibrahim ibn Ed'hem, ka treguar: *"Isha duke bërë tavaf në një natë të errët dhe me shi. U ndala para derës së Qabesë e pranë Multezemit, dhe i bëra dua Allahut:*

*- O Rabbi im, më ruaj nga gjynahet.*

*Ndërkohë dëgjova një zë:*

**- O Ibrahim! Të gjithë e duan këtë nga Unë; e nëse i ruaj të gjithë, kë do ta fali?**

Hasan Basriu ka thënë: *"Sikur besimtari të mos bëjë gjynahe, do të shihte fshehtësitë e qiejve. Por Allahu Teala e ndalon me gjynahe."*

Xhunejd-i Bagdadi r.a., ka thënë: *"Sikur, nga fisnikëria e Allahut, të hapej një herë perdja e syrit, të këqijtë bashkohen me të mirët."*

Malik ibn Dinar takoi Ebanin e i tha:

*- Deri kur do t'ju flasim njerëzve për lehtësimet?, e Ebani tha:*

*- O Ebu Jahja! Vërtetë shpresoj se në ditën e Gjykimit të shohësh falje aq të madhe nga Allahu, sa ta grisësh xhyben nga gëzimi.*

Thuhet se Ribi ibn Hirash, një nga taibinët e zgjedhur, kishte folur pas vdekjes. Vëllai i tij tregon: *“Kur më vdiq vëllai, ishte i mbuluar me rrobat e tija, e kur e vendosëm në tabut, rrobat iu larguan nga fytyra, ai u ngrit ulur, dhe tha:*

*- Vërtetë që e takova Rabbin tim! Ai nuk është i zemëruar! E pashë se nuk është ashtu si ju po mendoni, prandaj, mos shpifni për Allahun! Muhammedi s.a.v.s., po më pret, e edhe as’habët e tij, që t’ju bashkohem! Më pas ra, si një gur në legen me ujë. E bartëm dhe e varrosëm.”*

Resulallahu s.a.v.s., ka treguar: **“Dy nga beni israilët u vëllazëruan në rrugën e Allahut. Njëri bënte shumë gjynahe e tjetri bënte ibadet dhe këshillonte e largonte shokun nga gjynahet. Ky gjynahqari një herë i tha: “Më lerë me Rabbin tim! Mos je dërguar të më përcjellësh e kontrollosh?” Një ditë, ky abidi<sup>44</sup> e pa shokun e vet duke bërë një gjynah shumë të madh, iu zemërua, e i tha: “Ty Allahu Teala nuk do të falë!” Por, në ditën e Gjykimit, Allahu Teala do të thotë:**

**- Kush mund ta ndalë rahmetin Tim për robët e Mi?!, dhe këtij gjynahqarit i thotë:**

**- Ti shko, ty të fala; e më pas i thotë abidit:**

**- E ty të caktova xhehenemin!”**

E për këtë hadith, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

---

<sup>44</sup> Ai që bën shumë ibadet; që adhuron; zahid;

***“Pasha Atë që në dorën e Tij është shpirti im, ky abidi ka thënë fjalë që ia shkatërroi edhe dynjallëkun edhe ahiretin e tij.”***<sup>45</sup>

Tregohet se një çifut ishte hajdut për katërdhjetë vjet. Një ditë para tij kaloi Isa, a.s., e pas Isës a.s., ishte një nga Havarijjët. Hajduti tha me vete:

- *Ja ku po kalon i dërguari i Allahut, e pas tij një Havarij. Nëse ju bashkohem, bëhem i treti prej tyre. Shkoi dhe iu afrua Havarijjut. Por derisa po ecte pas tij, filloi ta qortojë veten dhe si respekt ndaj Havarijjut, e me vete tha:*

- *Njeriut si unë nuk i takon të ecë bashkë me këtë Havarijjun. Havarijjuni e vërejti prezencën e hajdutit, dhe mendoj me vete:*

- *Një i këtillë pranë meje?!, dhe u ngut t’i afrohet Isës, a.s., e hajduti mbeti mbrapa. Atëherë Allahu Teala i shpalli Isës, a.s.:*

- ***Thuaju këtyre të dyve që nga fillimi të nisin me vepra të mira. Havarijjut iu shkatërrouan veprat e mira prej mendjemadhësisë së tij, e hajdutit iu shkatërrouan veprat e këqija për shkak që e përbuzi veten.***

Isa a.s., i njoftoi të dy për shpalljen, dhe e pranoi hajdutin mes Havarijjunëve.

---

<sup>45</sup> Ebu Davud, nga Ebu Hurejre

Nga Mesruku transmetohet se, derisa njëri prej pejgamberëve ishte në sexhde, një gjynahqar e shkeli në qafë aq shumë sa gurët iu ngjitën në ballë. Ky pejgamberi (a.s.) ngriti kokën nga sexhdeja me zemërim, e tha:

- *Ik nga unë! Allahu Teala kurrë nuk do të falë ty!, e atëherë Allahu Teala i shpalli:*

- ***Ti po shikon të jesh mbi robët e mi? Unë vërtetë që e fala atë!***

Në këtë kuptim është edhe hadithi që e përcjellë Ibn Abbas r.a., e aty thuhet se Resulallahu s.a.v.s., i mallkoi mushrikët duke bërë dua të kunutit, e iu shpall ajeti:

**“Ti nuk ke asgjë në dorë...”** (3:128), dhe Resulallahu, s.a.v.s., hoqi dorë nga mallkimi. Pas kësaj ata të gjithë e pranuan Islamin.<sup>46</sup>

Tregohet se dy abidë ishin të barabartë në ibadet. Në ditën e Gjykimit, Allahu Teala do t’i vendos të dy në xhennet, por njëri prej tyre do të jetë në gradë më të lartë se tjetri. Kur ai me gradë më të ulët pyet:

- *O Rabb, pse e vendose atë në grada më të larta kur në ibadet ne ishim të barabartë?!; e Allahu Teala do të thotë:*

- ***Në dynja ai nga Unë kërkonte gradë më të lartë në xhennet, e ti kërkoje shpëtim prej xhehenemit dhe të hysh në xhennet; prandaj secili mori atë që kërkoi.***

---

<sup>46</sup> Buhari, nga Ibn Omeri, si edhe Tirmidhi.

Ky transmetim na tregon se më mirë është të bëhet ibadet me shpresë, sepse më shumë vjen dashuri tek ata që shpresojnë sesa tek ata që kanë frikë. Ka dallim të madh mes atij që i shërben sulltanit me frikë nga dënimi, dhe atij që i shërben duke shpresuar në mirësinë dhe fisnikërinë e Sulltanit.

Për këtë arsye Allahu Teala edhe urdhëron që të mendohet mirë për njerëzit, dhe Resulallahut, s.a.v.s., i tha:

***“Kërkoni nga Allahu grada të larta! Sepse ju po kërkoni nga i Xhymerti.”***<sup>47</sup>,

dhe:

***“Kur kërkoni nga Allahu Teala, shtoni dëshirat dhe kërkoni xhennetin Firdevs, sepse për Allahun Teala asgjë nuk është teprim.”***<sup>48</sup>

Ebu Bekir ibn Sulej tregon: *“Shkuam te Malik ibn Enes para vdekjes së tij dhe e pyetëm për gjendjen e tij, e ai na tha:*

*- Nuk di si t'ju them. Por së shpejti do të shihni se çfarë falësi i madh është Allahu Teala; e pak pas kësaj vdiq.*

---

<sup>47</sup> Tirmidhi, nga Ibn Mesud.

<sup>48</sup> Muslimi dhe Buhari, nga Ebu Hurejre, dhe Tirmidhi nga Muadh dhe Ubade ibn Samit

Jahja ibn Muadh i bënte dua Allahut Teala: *“O Rabbi im! Shpresa ime se Ti m’i falë gjynahet, gati se po e kalon shpresën time në veprat e mia, sepse për veprat e mia po mbështetem në sinqeritetin tim, e si të arrij sinqeritetin kur unë njihem për të këqijat e mia; ndërsa për gjynahet e mia po mbështetem tek falja Jote, e si të mos m’i falësh gjynahet kur Ti veçohesh për fisnikëri!”*

Tregohet se një mexhusi kërkoi nga Ibrahim i a.s., ta pranojë si mysafir. Ibrahim i tha:

- *Nëse bëhesh musliman, të pranoj në konak. Mexhusi u largua, e Allahu Teala i shpalli Ibrahimit, a.s.:*

- ***O Ibrahim!, përse kushtëzove konakun me ndërrim të fesë? Ka shtatëdhjetë vite ne e ushqejmë, e ai është në kufr. Çfarë të kishte penguar që ta pranosh si mysafir e ta ushqesh?*** Pas kësaj, Ibrahim i a.s., e gjeti mexhusin, e ktheu në shtëpi dhe e gostiti. Mexhusi e pyeti:

- *Çka është arsyeja që po vepron në këtë mënyrë?, e Ibrahim i a.s., ia tregoi të gjitha, e ky u habit dhe tha:*

- *Allahu kështu vepron me mua?! Atëherë më mëso Islamin. Edhe unë do të bëhem musliman.*

Ebu Sehl El-Sa’luki e pa në ëndërr Ebu Sehl Ez-Zuhaxhin, i cili vazhdimisht e frikësonte xhematin, dhe e pyeti:

- *Si është gjendja?, e ai u përgjigj:*

- *Është më lehtë se që kemi menduar.*

Kur një person e pa në ëndërr Ebu Sehl El-Sa'lukin në gjendje aq të mirë sa nuk mund të përshkruhet, dhe e pyeti:

- *Si i arrite në këtë gradë?!*, ai tha:
- *Me mendim të mirë për Rabbin tim.*

Tregohet se Ebu Abbas ibn Surejxh sa ishte me sëmundjen nga e cila edhe do të vdiste, pa ëndërr se ka ardhur dita e Gjykimit, e Allahu Teala pyeti:

- ***Ku janë alimët?*** Ndërkohë u mblodhën dijetarët, dhe Allahu i pyeti:

- ***Çfarë keni bërë me diturinë tuaj?***, e ata u përgjigjën:
- *Rabbi ynë, nuk bëmë mjaft, nuk vepruam drejtë.*

Allahu Teala e përsëriti pyetjen, sikur të mos ishte i kënaqur me përgjigjen, dhe Ibn Surejxh tregon se ky u përgjigj:

- *Sa për mua, e di se në librin e veprave të mia nuk ka shirk, e Ti ke premtuar se gjithçka tjetër do të më falësh.*

Allahu Teala atëherë tha:

- ***Shkoni! Ju fala!*** Tri netë pas kësaj ëndrre Ibn Surejxh kaloi në ahiret.

Një pijanec i mbloshi shokët, dhe skllavit të tij ia dha katër derhemë të shkojë në pazar e të blejë fruta. Skllavi kaloi pranë një vendi ku ishte ulur Mensur ibn Ammar, që po kërkonte para për një të varfër, e thoshte:

- *Kush i jep këtij fukaraje katër dërhëmë, unë do t'i bëj katër dua për të.* Skllavi ia dha katër dërhëmët, e Mensuri e pyeti:

- *Çka të bëj dua për ty?* Skllavi tha:

- *Kam një zotëri, dhe dua të lirohem nga ai.* Mensuri e bëri duanë, e pastaj e pyeti:

- *Cila është kërkesa jote e dytë?* Skllavi tha:

- *Dua katër dërhëmë në vend të këtyre katër dërhëmëve që ju dhashë.* Mensuri e bëri duanë e më pas e pyeti për kërkesën e tretë, e skllavi tha:

- *Dua që zotëria im të bëj teube.* Mensuri prapë e bëri duanë dhe kur e pyeti për kërkesën e fundit, skllavi tha:

- *Dua që Allahu Teala të më falë mua, zotërinë tim, ty dhe gjithë këta njerëz.* Mensuri e bëri edhe duanë e katërt, e skllavi u kthye te zotëria i vet. Zotëria e pyeti përse u vonua, e ky i tregoi çfarë kishte ndodhur. Zotëria e pyeti se çfarë kërkoi, e skllavi tha:

- *Për vete kërkova lirinë time.*

- *Të lirova;* i tha zotëria dhe e pyeti për duanë e dytë, e skllavi tha:

- *Kërkova që Allahu Teala të m'i kthejë ata katër dërhëmë.* Zotëria i tha:

- *Merri katër dërhëmë prej meje, dhe prapë e pyeti:*

- *Cila ishte duaja e tretë?,* skllavi i tha:

- *Kërkova që Allahu të ketë rahmet për ty dhe ti të pendohesh.* Zotëria tha:



- *U pendova, e kur e pyeti për duanë e katërt, skllavi i tha:*

- *Kërkova që Allahu të më falë mua, ty, këtyre njerëzve dhe atij që bënte duatë; e Zotëria i tij tha:*

- *Unë nuk mund të bëj asgjë për këtë. Kur fjeti atë natë, ëndërroi se dikush po i thotë:*

- ***Ti i bëre ato që ishin në fuqinë tënde. A mendon se Unë nuk do ta bëj atë që është në fuqinë Time? Të fala ty, edhe skllavin tënd, edhe Mensur ibn Ammar, edhe njerëzit që ishin aty.***

Abdulvehab ibn Sakafi ka treguar: *“Pashë tre burra e një grua si bartnin një kufomë. E zëvendësova gruan, e bartëm tabutin te varrezat, dhe e varrosëm. Më pas e pyeta gruan se çfarë e kishte rahmetlinë, e më tha se ishte djali i saj. E pyeta:*

- *A nuk keni fqinjë ju?, e më tha:*

- *Kemi, por ata e përbuznin.*

*E pyeta për arsyen, e më tregoi se djali i saj kishte qenë me dy gjini. Më erdhi keq për të, dhe e përcolla deri në shtëpi. I dhashë pak para, grurë dhe rroba. Atë natë ëndërrova se më erdhi një person me rroba të bardha, fytyra e tij ishte e bukur si hëna e plotë, e më falënderoi.*

- *Kush je ti?, e pyeta, e më tha:*

- *Jam ai që sot e varrosët. Rabbi im më mëshiroi, për shkakun se njerëzit më përbuznin.*

Ibrahim Atrush tregon: *“Ishim në Bagdad me Ma’ruf Kerhij, buzë lumit Tigris. Përnjëherë, në lum u lajmëruan disa të rinj në një anije; i binin deficit, pinin e argëtoheshin. Dikush i tha Ma’rufit:*

*- Shih këta të rinj si bëjnë gjynah haptas! Bëji dua Allahut që t’i mallkojë!” Ma’rufi ngriti duart, e filloi:*

*- Allahu im! Ashtu siç po i lumturon në këtë botë, ashtu lumturoi edhe në ahiret! Të pranishmit thanë:*

*- Ne të kërkuam të bësh dua kundër tyre!, e ai ju tha:*

*- Nëse Allahu dëshiron t’i lumturojë në ahiret, këta do të pendohen, e Allahu do të pranojë pendimin e tyre.”*

Njëri nga selefi salihin bëri dua: *“O Rabbi im! Njerëzit bëjnë gjynahe, e Ti edhe më tutje ju dhuron nimete të bollshme dhe ju siguron riskun. Ti je i Gjithëmëshirëshmi dhe i Gjithëfuqishmi; njerëzit të kundërvihen Ty, e Ti në vazhdimësi ju dhuron nimete e risk, pa asnjë zemërim”.*

Pra, leximi, dëgjimi dhe mësimi i kësaj e shton shpresën dhe i jep shpresë edhe të dëshpëruarit. Por nuk është e drejtë që këto t'i dëgjojnë budallenjtë e mashtruar. Ata duhet të dëgjojnë e mësojnë se çfarë do të themi për frikën. Sepse shumica e njerëzve mund të udhëhiqen në rrugë të drejtë vetëm me frikë. Ashtu si skllavi i keq dhe fëmija i padëgjueshëm që hyjnë në rrugë të drejtë me kamxhik. Përndryshe ju mbyllen dyert e mirësisë së kësaj bote, dhe të ahiretit.

## Kapitulli i dytë

### PËR FRIKËN

#### HAKIKATI I FRIKËS

Dije se frika do të thotë brengosje e zemrës nga mendimi se në të ardhmen do të hasë në diçka që nuk i pëlqen. Kjo u kuptua duke e shpjeguar hakikatin e shpresës. Ai që është i afërt me Allahun Teala, që zemrën e ka të mbushur me hakikat dhe e kalon kohën duke vëzhguar vazhdimisht bukurinë e Allahut, i tilli nuk do të ketë kohë të mendojë për të ardhmen, prandaj nuk do të ketë as frikë e as shpresë; frika dhe shpresa atij i janë vetëm dy pengesa që e pengojnë nefsën të arrijë në rehati.

Duke vënë shenjë në këtë, Vasiti, ka thënë: *“Frika është një perde mes Allahut dhe robit”*, dhe ka thënë:

*“Nëse hakikati i bëhet i njohur zemrës, atëherë aty nuk ka vend për shpresë e frikë”.*

Shkurtimisht, është mangësi në vëzhgim kur i dashuruari të jetë i preokupuar me frikën e ndarjes derisa vëzhgon atë që dashuron. Vëzhgimi i vazhdueshëm është grada më e lartë e dashurisë. Por ne këtu po flasim për fillimet e gradave.

Edhe frika përbëhet nga dituria, gjendja dhe veprimi.

Sa për diturinë, kjo nënkupton njohjen e sebepeve që të shtyjnë të bësh diçka që nuk të pëlqen. Kjo është, për shembull, si një person që ka bërë ndonjë shkelje në raport me sulltanin, pastaj ka rënë në duart e atij sulltani dhe ka frikë se mos vritet, por në të njëjtën kohë ekziston edhe mundësia që sulltani ta falë e të shpëtojë. E frika e tij shtohet aq sa ai i njeh sebepe sipas të cilave do të dënohet. Padyshim, këto sebepe janë gjëra si: sa e rëndë është shkelja e tij dhe sa është sundimtari i keq, i zemëruar dhe hakmarrës. Gjithashtu, kjo është gjendje kur ai nuk ka shefatxhi dhe të gjithë e nxitën sulltanin në hakmarrje, e ai nuk ka asnjë vepër të mirë që do të zhvlerësonte shkeljen e tij. Duke i ditur të gjitha këto, frika e tij shtohet dhe kjo bëhet sepse që ai të ndjejë dhimbje në zemër. Nëse këto sebepe dobësohen, edhe frika zvogëlohet.

Nganjëherë frika nuk është prej shkeljes që e bën personi, por për shkak të cilësive të atij nga kush frikësohet, si për shembull kur njeriu e sulmon ndonjë bishë; njeriu frikësohet për shkak të bishës, sepse bisha zakonisht shqyen atë çfarë sulmon. Ndonjëherë frika lind nga natyra dhe karakteristikat e asaj prej të cilës njeriu ka frikë, siç është frika nga vërshimet ose zjarri, sepse uji është i krijuar të rrjedhë e vërshojë, e zjarri për të djegur.

Prandaj, njohja e shkaktarëve të rrezikut në të ardhmen është arsye e dhimbjes në zemër, e ajo dhimbje është frika. Gjithashtu, frika nga Allahu Teala nganjëherë mund të jetë nga njohja e Tij dhe cilësive të Tij, sepse Allahu Teala mund të shkatërrojë të gjitha botët kur të dëshirojë dhe në këtë askush nuk mund ta ndalë, e nganjëherë frika mund të lajmërohet duke menduar për dënimin që do të japë për gjynahet e bëra, e nganjëherë, duke menduar për madhësinë dhe ndëshkimin e Tij.

Pra, ai që i njeh të metat e veta dhe e di se Allahu Teala nuk do të përgjigjet për atë që bën por njerëzit do të përgjigjen për veprat e veta, atij i shtohet edhe frika ndaj Allahut. Ai që i frikësohet më së shumti Allahut është ai që e njeh më së miri Allahun. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Unë më së shumti i frikësohem Allahut.”***<sup>49</sup>

E me një ajet thuhet:

**“Në të vërtetë, nga robët e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët.”** 35-Fatir: 28

Duke u përsosur marifeti, rritet edhe zjarri i zemrës dhe frika. Pastaj zjarri i zemrës kalon nga zemra në pjesët e trupit, dhe në cilësi. Kur ky zjarr mbulon trupin, shkakton dobësim, zbehje, alivanosje, britma e vajtim.

---

<sup>49</sup> Buhari, nga Enesi, r.a..

Ndonjëherë ndodh të pëlçasë tëmthi, që mund të shkaktojë vdekje, ose të vijë te derdhja e gjakut në tru, që turbullon mendjen; ose kjo frikë bëhet edhe më e fortë me zjarrin, që mund të shkaktojë dëshpërim të plotë. Kur ky zjarr kalon në pjesë të trupit; i largon ato nga gjynahu, i lidh në ibadet për të kompensuar të kaluarën dhe për t'i përgatitur për të ardhmen. Prandaj edhe është thënë:

*“Frika nuk është në derdhjen dhe fshirjen e lotëve, frika është largim nga gjërat që domosdo dënohen.”*

Ebu Kasim Hakim ka thënë:

*“Të gjithë ikin nga ajo që kanë frikë, vetëm ai që i frikësohet Allahut i afrohet Allahut”,*

ndërsa kur e pyetën Zunnun Misrinë:

- *Kur i frikësohet robi Allahut?, ai u përgjigj:*

- *Kur është në gjendjen e të sëmurit i cili ruhet nga çdo gjë që ia zgjat sëmundjen.*

Sa për zjarrin e frikës në cilësi; ky zjarr frenon epshet, dhe largon nga gjynahet që i ishin të dashura, e i bëhen të neveritshme, si mjalti që bëhet i neveritshëm për atë që e do mjaltin kur e kupton se në atë mjaltë ka helm. Personi i djegë epshet e tij me këtë zjarr frike, disiplinon gjymtyrët, e zemra i zbutet dhe aty lind frikë-respekti, mërzia, përlulja dhe nënshtrimi, e nga zemra largohen arroganca, inati dhe zilia. Zemra fillon të brengoset e të mendojë përfundimin, dhe merret me veten duke mos menduar për asgjë tjetër.

E gjithë përpjekja e tij duhet të jetë vetëkontrolli, llogaridhënia, lufta kundër epsheve dhe dëshirave, të mos harxhojë kohën kot dhe ta mbrojë veten me punë, fjalë dhe veprime. Gjendja e tij është e ngjashme me personin e kapur në kthetrat e një kafshe grabitqare, e ai mendon a do të mund të gjej një boshllëk dhe të shpëtojë, apo do të më copëtojë menjëherë? E brendshmja dhe e jashtme e tij janë gjithmonë të preokupuara me atë prej çfarë frikësohet. Kjo është gjendja e atij të cilin e mbërthen dhe mbizotëron frika; as'habët dhe taibinët ishin në këtë gjendje.

Forca e vetëkontrollit, kërkimit të llogarisë dhe e luftës është në baraspeshë me forcën e frikës, e frika shihet në dhimbjen dhe në zjarrin e zemrës. Forca e frikës është në baraspeshë me njohjen e Allahut Teala, cilësive dhe veprave të Tij si edhe të metave të veta dhe rreziqeve dhe vështirësive që do t'i hasë.

Grada më e ulët e frikës është frika që ndikon në veprim dhe largon nga gjërat e dyshimta. Largimi nga gjërat e dyshimta quhet *vera*<sup>50</sup>. Kur frika i shtohet edhe më shumë, ai largohet edhe nga gjërat sado pak të dyshimta, dhe kjo quhet *takva* – devotshmëri.

---

<sup>50</sup> **Vera**; devotshmëri e përparuar, veprim sipas të vërtetës; përmbajtje nga të gjitha gjynahet.

*Takva* do të thotë të braktisë plotësisht atë që është e dyshimtë dhe ta marrë vetëm atë që nuk është dyshimtë; dhe për këtë arsye takvaja ndonjëherë e largon njeriun edhe nga gjërat që nuk janë të dëmshme, që të mos bie në gjëra të cilat janë të dëmshme. Kjo gjendje është drejtësi në *takva*. Nëse kësaj i shtohet edhe hyzmeti, atëherë personi që posedon këto cilësi nuk ndërton shtëpi ku nuk do të jetojë, nuk grumbullon pasuri që nuk do ta harxhojë, as nuk i intereson dynjallëku, duke e ditur se të njëjtin do ta braktisë, prandaj nuk harxhon as një frymë të vetme për asgjë tjetër përveç Allahut. Personi i tillë meriton të bartë epitelin *siddik*. Domethënë, siddiki përfshinë takvanë, takvaja përfshinë *vera*-në, e *vera* përfshinë *namusin (iffe)*. E *namus* do të thotë të përmbahesh nga dëshirat e epshit.

Pra, frika ndikon në pjesët e trupit që të largohen nga e keqja dhe të bëjnë të mirën, e meqë kjo largon nga dëshirat e epshit, quhet *namus*. Më lartë se kjo është *vera*, që është më e përgjithshme se *namusi*. Pra, *vera* mund të mos gjendet te secili te kush gjendet *namusi*, por ku ka *vera* me siguri ka *namus*. Për shkak se *vera* vjen pas *namusit*, ajo është një gradë më e lartë dhe në të njëjtën kohë është edhe largim nga të gjitha llojet e ndalesave. E *takvaja* është më e lartë se *vera*, sepse *takva* nënkupton braktisje të së ndaluarës dhe të asaj në çka ka dyshime, e mbi takvanë është grada *siddik* (e sinqeritetit) dhe *mukarreb* (afërsisë).



Raporti i gradës së fundit me gradat e mëparshme, është si raporti i të veçantës me të përgjithshmen. Në këtë aspekt, kur përmend të veçantën, ke përmendur edhe të përgjithshmen. Domethënë, te ai që është në gradën *mukarreb* dhe *siddik*, janë të pranishme edhe të gjitha cilësitë para kësaj. Për shembull, për një person mund të themi se është arab ose persian. Nëse është arab mund të themi se është Kurejsh ose s’është, nëse është Kurejsh, ai është ose Hashemi ose Alevi (pasardhës të Alisë, r.a.). Nëse është Alevi, ai është ose Hasani ose Huseini, dhe kur themi; “*ai është Hasani*” (pra, nga brezi i Hasanit), ai i ka të gjitha cilësitë që i përmendëm. Nëse themi vetëm “*ai është Alevi*”, nuk dihet a është Hasani apo Husejni.

Njëjtë edhe kur themi për dikë që është siddik, kemi thënë edhe se ai është me namus, posedon vera dhe është i devotshëm. Nuk është e drejtë të mendohet se shumë emërtime kanë veç e veç kuptime të ndryshme. Nëse mendon kështu, do të ngatërrosh gjërat.

Kjo që shpjeguam është hakikati i frikës.

## GRADAT E FRIKËS

Dije se frika është cilësi e lavdëruar. Dikush mund të mendojë se çfarëdo frike është e lavdëruar dhe se sa më e madhe dhe e fortë frika, aq edhe më e lavdëruar, por kjo është gabim. Frika është kamxhiku i Allahut Teala me të cilën Ai i inkurajon robët e Tij në kujdes, dituri dhe veprim, që të arrijnë afërsinë e Tij.

Kamxhiku nevojitet për kafshët, njëjtë edhe për fëmijët, por kjo nuk do të thotë se është e lavdëruar të teprohet në përdorim të kamxhikut. Dhe njëjtë edhe frika, si çdo gjë tjetër, mund të jetë e dobët, e tepruar ose e matur, dhe e lavdëruar është pikërisht frika e matur.

Frika e dobët i ngjan butësisë së një gruaje; kur dëgjon një vaz të prekshëm ose kur sheh diçka të tmerrshme, menjëherë qan dhe fillon të derdhë lot. Por kur kjo kalon, ajo kthehet në gjendjen e mëparshme. Kjo frikë është e dobët dhe sjell pak dobi, bash sikur me një shkop të vogël të godasësh kafshën e madhe, e ajo as nuk e ndjen, dhe ti me këtë nuk mund ta detyrosh të bëjë çfarë ti dëshiron.

Fatkeqësisht, ky lloj është frika e shumicës së njerëzve, me përjashtim të arifëve dhe dijetarëve; e nuk po mendoj për zyrtarët që mbajnë emërtimin e dijetarit, sepse bash ata janë më së largëti frikës.

Unë me emërtimin *dijetar* po mendoj në ata që e njohin Allahun Teala, i njohin cilësitë dhe veprat e Tij; e të tillë sot ka pak. Prandaj Fudajl ibn Ijad ka thënë: *“Nëse të pyet dikush: “A ke frikë nga Allahu”, mos u përgjigj. Sepse, nëse përgjigjesh me “Jo” do të bësh kufr, e nëse thua “Po”, atëherë po gënjen.”*

Me këto fjalë ka treguar se frikë e dëshiruar është ajo që i largon gjymtyrët e trupit nga gjynahi, dhe i lidh ato në ibadet. Frika që nuk ndikon në gjymtyrët e trupit nuk ka vlerë, bile as nuk është e drejtë të quhet *frikë*.

Sa i përket frikës së tepruar, kjo bën që njerëzit të dëshpërohen dhe ta humbin shpresën për shkak të tejkalimit të maturisë, që gjithashtu është e qortuar. Sepse edhe frika e tepruar i pengon njerëzit të bëjnë vepra të mira. Frika e tepruar ndonjëherë e dobëson njeriun, e bën të sëmurë, konfuz, apo edhe e bën të çmendet. Por, qëllimi nga frika është sikur qëllimi nga kamxhiku - inkurajimi në veprim. Nëse qëllim nuk do të ishte veprimi, frika nuk do të ishte e lavdëruar, për faktin se në esencë frika është mangësi. Sepse burim i frikës është padituria dhe pafuqia. Për shkak të paditurisë, personi nuk e di përfundimin, e po ta dinte, nuk do të kishte frikë. Frika ndodh kur ka hezitim në diçka. Sa i përket pafuqisë, kjo është kur personi ndeshet me ndonjë rrezik, e nuk mund ta largojë.

Pra, frika është cilësi e lavdëruar në fe në raport me të metat e njeriut. Ajo që lavdërohet në esencë është dituria dhe fuqia. Çdo gjë që lejohet për të përshkruar Allahun është diçka që lavdërohet në fe. E ajo me të cilën nuk lejohet të përshkruhet Allahu nuk është përsosmëri. Diçka e tillë lavdërohet në fe vetëm krahasuar me një mangësi më të madhe se ajo, siç është më e lehtë të durohet dhimbja e ilaçit sesa dhimbja sëmundjes dhe vdekjes. Të gjitha llojet e frikës që e dëshpërojnë njeriun janë të këqija.

Siç e shpjeguam më lart, frika mund t'i çojë njerëzit në shumë rreziqe, përfshirë marrëzinë dhe vdekjen, si rrahja që mund ta çojë fëmijën në vdekje dhe kafshën në shkatërrim. Kjo lloj frike është gjithashtu e keqe. Resulallahu, s.a.v.s., shpesh flet për sebetet e shpresës për të na shpëtuar nga frika që çon në dëshpërim të skajshëm ose në një nga rreziqet që përmendëm.

Në çfarëdo që synohet, e lavdëruar është vetëm ajo që dërgon në qëllimin e dëshiruar, ndërsa ajo që nuk dërgon në qëllim, ose i tejkalon kufijtë, është e papëlqyeshme. Dobi të frikës janë kujdesi, devotshmëria, vera, ibadeti, dhikri, meditimi dhe sebetet e të tjera që na afrojnë Allahut. Të gjitha këto kërkojnë jetë, shëndet të trupit dhe mendje të shëndoshë, dhe gjithçka që i dëmton këto, është e qortuar.

Nëse thua se, *Personi që vdes nga frika e Allahut është shehid, prandaj si mund të konsiderohet e keqe kjo frikë?*

Dije se, ai fiton gradën e shehidit vetëm pse vdes nga frika, që do të thotë se po të kishte vdekur nga një sebeb tjetër nuk do ta fitonte atë gradë.

Pra, vdekja me frikë është fazilet në krahasim me vdekjen pa frikë. Por, ata që janë në rrugën e Allahut duke përparuar në aspektin e diturisë, meditimit dhe në luftë me nefsin, çdo moment janë duke u ngritur në gradën e shehidëve. Grada e fëmijës së vvarë ose të çmendurit që e shqyen bisha nuk mund të jetë më e lartë se grada e pejgamberit ose *siddikut* që vdes me vdekje natyrale. Por nuk është drejtë të mendohet kështu. Sepse lumturia më e mirë është një jetë e gjatë e kaluar duke i bërë ibadet Allahut, e gjithçka që ndërpret jetën ose shkatërron mendjen a shëndetin, me çka rrezikon jetën - është e dëmshme dhe mangësi, ani që është fazilet në raste të caktuara. Për shembull, grada e shehidit është fazilet në raport me më të ulëtit, por nuk është fazilet në raport me gradën e *muttakive* dhe *siddikëve*.

Prandaj, nëse frika nuk nxitë në veprim, prezenca e saj është e njëjtë si mungesa e saj; është si kamxhiku që nuk e bën kafshën të lëvizë.

E nëse është frikë që ndikon, atëherë ajo ka vlerë në raport me ndikimin e saj. Nëse njeriu prej frikës ruan vetëm namusin, që është largim nga ajo që e kërkon epshi, kjo është një gradë për të. Nëse sjell devotshmëri, kjo është gradë më e lartë, e grada më e lartë është grada e siddikëve, kur robi e çliron të jashtmen dhe të brendshmen nga gjithçka pos Allahut, kur te ai nuk ka vend për asgjë tjetër pos për Allahun Teala. Kjo është grada më e lartë e lavdëruar e frikës, e kjo është e mundur me mendje dhe shëndet. Kur frika shkakton humbje të mendjes a shëndetit, atëherë vet frika është një sëmundje që duhet shëruar, aq sa mundet. Prandaj Sehl et-Tusteri, ju tha nxënësve të tij që duruan urinë për disa ditë: *“Ruajeni mendjen. Allahu nuk ka robë të sinqertë e të mirë me mendje të mangët.”*

## FRIKA E NJERIUT

Dije se, frika lind nga të menduarit se do të ndeshet me diçka që nuk i pëlqen. Ajo që nuk i pëlqen është ose e tmerrshme në vetvete - si zjarri, ose është *mekruh* që çon në dëm, si gjynahet që bëjnë që njeriu në ahiret të ndeshet me atë që nuk i pëlqen ose si një i sëmurë që duhet të përmbahet nga ngrënia e gjërave që i shkaktojnë vdekjen.

Secili që ka frikë duhet të mendojë se nga cila këto dyja ka frikë, që ajo frikë të bëhet më e fortë, dhe të fillojë t'i djegë zemrën kur e kujton. Për këtë arsye, gradat e atyre që kanë frikë janë të ndryshme, e edhe frikat e tyre ndryshojnë në varësi të gjërave prej të cilave kanë frikë.

Për shembull, frika nga vdekja pa bërë teube, frika se do ta prishë teuben, se dobësohet e nuk mund t'i zbatojë urdhrat e Allahut, se nga zemra i largohet mëshira e i ndërrohet me mizori, se pasimi i epshit i bëhet shprehi, se do t'i pëlqejë vetja, se do te bëhet mendjemadh, se do të jetë i zënë me gjëra të kota, se mund të bëhet jofalënderues për nimetet që i janë dhënë, se mashtrohet me nimetet e shumta, të mos zbulohet e shëmtuara në ibadetin e tij, pasojat e thashethemeve, tradhtisë, mashtrimit dhe fshehjes të së keqes, se çfarë mund t'i ndodh në pjesën e mbetur të jetës, dënimi në këtë botë me turp para vdekjes, se mashtrohet me stolitë e dynjasë,

se Allahu ia zbulon fshehtësitë kur ai është i pakujdesshëm karshi Tij, se përfundimin do ta ketë të keq, ose frika nga paracaktimi i Allahut – të gjitha këto janë frika të arifit, dhe secila prej këtyre frikave sjell dobi të veçantë, e që është ruajtja nga gjithçka që mund të dërgojë te ajo prej së cilës frikësohet. Atë që e mbërthejnë adetet dhe ka frikë se ato do ta pushtojnë, duhet të përpiqet të shkëputet nga ato adete. Ai që ka frikë se Allahu ia zbulon fshehtësitë, duhet të përpiqet ta pastrojë zemrën nga vesveset. Kështu, ai duhet të përpiqet të përmirësojë gjithçka nga e cila ka frikë. Më e madhja nga këto frika është frika e frymës së fundit. Sepse ky është moment i rëndësishëm. Por më e fuqishme, ajo që tregon më shumë përsosmërinë dhe dijen e personit, është frika nga e kaluara. Sepse e ardhmja i nënshtrohet të kaluarës dhe në të njëjtën kohë është shkëlqimi i saj pas ndërhyrjes së shumë sebepeve. Fryma e fundit është shfaqje e paracaktimit në ezel. Ai që i frikësohet përfundimit dhe ai që i frikësohet paracaktimit të Allahut janë si shembulli i dy personave që sulltani ka marrë vendim për ta, e vendimi mund të jetë heqja e kokës, por mund të jetë edhe dhënia e një pozite, e ata ende nuk janë lajmëruar dhe nuk e dinë vendimin. Njëri prej tyre mendon për vendimin dhe përmbajtjen, ndërsa tjetri mendon se a është sulltani në atë moment në disponim të mirë, apo i zemëruar. Mendimi i këtij të dytit është gradë më lartë, sepse mendon për sebin.



Kështu, është më e rëndësishme të mendosh për vendimin në ezal sesa të presësh për vendimin në të ardhmen. Resulallahu, s.a.v.s., e tregoi këtë duke e mbyllur dorën e djathtë derisa ishte në minber, dhe tha:

***“Ky është Libri i Allahut, në të cilin Ai i përcaktoi banorët e xhennetit sipas emrave të tyre e të baballarëve të tyre. Asnjë nuk mund të shtohet dhe asnjë nuk mund të pakësohet”,*** e më pas e mbylli dorën e majtë, e tha:

***“Ky është Libri i Allahut, në të cilin Ai përcaktoi banorët e xhennetit sipas emrave të tyre e të baballarëve të tyre. Asnjë nuk mund të shtohet dhe asnjë nuk mund të pakësohet. Ndonjëri prej jush bën vepra si gjynahqarët, deri sa të thuhet se është prej tyre. Më pas Allahu do ta shpëtojë para vdekjes, qoftë edhe vetëm për aq kohë sa shtrëngohet e lëshohet dora kur mjelë devenë. Po kështu, edhe gjynahqari bën veprat e të mirëve deri sa të thuhet se është prej tyre. Më pas Allahu do ta shpëtojë para vdekjes, qoftë edhe vetëm për aq kohë sa shtrëngohet e lëshohet dora kur mjelë devenë. I lumtur është ai që e arrin lumturinë me caktimin e Allahut. Gjynahqari është faqezi me caktimin e Allahut, e veprat vlerësohen sipas përfundimit.”***<sup>51</sup>

Kjo është sikur të ndahet frika në dysh. Disa njerëz i frikësohen Allahut për shkak të gjynaheve që kanë bërë, ndërsa të tjerë i frikësohen Madhësisë së Allahut.

---

<sup>51</sup> Tirmidhi, nga Abdullah ibn Amr ibn As.

Padyshim që kjo e dyta është gradë më e lartë. Prandaj personi me këso frike, edhe nëse ngritët në gradën e siddikëve, frika e tij prapë vazhdon, ndërsa tjetri përballet me rrezikun për tu mashtruar.

Pra, frika nga gjynahet gjatë vazhdimit në ibadet është frikë e salihëve, ndërsa frika nga Madhështia e Allahut Teala është frikë e muvahhidit dhe siddikëve. Kjo frikë është fryt i merifetit të Allahut. Kushdo që e njeh Dhatin dhe cilësitë e Allahut e di se duhet t'i frikësohet Allahut, edhe nëse nuk bën gjynah. Bile edhe gjynahqari, sikur ta njihte Allahun në vërtetësi, do t'i frikësohej Allahut, jo gjynaheve të veta. Domethënë, Allahun duhet pasur frikë sepse Ai e krijoi njeriun, i mundësoi bërjen e gjynaheve, e lehtësoi rrugën e gjynahit dhe i krijoi sebetet e gjynahit. Lehtësimi i sebetëve të gjynahit do të thotë largim i njerëzve nga gjynahet. Megjithatë, ai nuk kishte bërë ndonjë gabim para gjynahit që ta meritojë këtë, njësoj si lehtësimi i rrugës së ibadetit për atë që bën ibadet (abid). Sepse ai nuk kishte bërë ndonjë të mirë më parë, që ta fitojë të drejtën për ta bërë ibadet. Gjynahqari, e pranoi ose jo, është gjykuar për gjynah në ezal. Edhe atij që bën ibadet, ibadeti i është paracaktuar në ezal dhe ai do të bëjë ibadet. Kush është ai që e ngriti Muhammedin a.s., në gradën më të lartë para se ta krijonte atë, kush është ai që e zbriti Ebu Xhehlin në më të ulëtën e të ulëtëve para se ta krijonte dhe pa bërë ai asnjë gjynah? Sigurisht që Allahu.

Meqenëse është Allahu që i bën këto, para së gjithash, njeriu duhet t'i frikësohet Madhështisë së Tij. Ai që i nënshtrohet Allahut, i nënshtrohet Allahut me vullnetin që Allahu e krijoi tek ai dhe me fuqinë që Allahu ia dha. Edhe ai që bën gjynah, bën gjynah për shkak të vullnetit të prerë dhe fuqisë së gjynahit që Allahu e krijoi tek ai. Pas vullnetit dhe fuqisë, veprimi vjen si domosdoshmëri. Sikur ta dija se çfarë është sebepi që e nderoi njerin duke i dhënë vullnetin për t'u nënshtuar, dhe çfarë është sebepi që e largoi dikë tjetër, duke i dhënë vullnetin për të bërë gjynah. Si mund t'i lihet kjo gjendje njeriut? Meqenëse bazohet në kaderin ezel, pa ndonjë sebeb të mëparshëm, natyrisht që të mençurit kanë frikë nga Ai që vlerëson dhe gjykon si të dojë, e kjo është frikë nga Dhati. Pas kësaj është sekret i kaderit, që nuk lejohet të shpjegohet.

Kuptimi i frikës nga cilësitë e Allahut është i mundur përmes shembujve. Po të mos kishte leje nga sheriati, askush nuk do të guxonte të fliste për këtë. Në një haber tregohet se Allahu i shpalli Davudit a.s.:

***“O Davud, ki frikë prej Meje, sikurse ke frikë nga kafshët grabitqare.”***

Ky shembull, edhe pse nuk ta tregon ty sebepin e këtij kuptimi, ta tregon esencën. Sepse të njohësh sebepin do të thotë të njohësh sekretin e kaderit, e kjo i zbulohet vetëm atyre që e meritojnë.

Pra, personi i frikësohet bishës jo pse i ka bërë diçka keq, por për shkak të cilësive, forcës dhe ashpërsisë të bishës, për faktin se bisha vepron si të dojë; nëse te vret, ajo nuk ndjen dhimbje, e nëse të lëshon, kjo nuk vjen nga dhembshuria dhe mëshira e bishës, as nga dëshira që ti të jetosh. Ti nuk vlen për të; qofsh ti gjallë a i vdekur për të është njëjtë, për të s'ka dallim mes vrasjes së njëmijë njerëzve si ti dhe vrasjes së një milingone, sepse për të kjo nuk ka peshë, e Allahu është shumë më lartë se çfarëdo krahasimi. Ai që e njeh Allahun përmes vëzhgimit të brendshëm, që është më i qartë e më i fortë se vëzhgimi i jashtëm, e di se Allahu Teala flet vetëm të vërtetën kur thotë: ***“Këta hynë në xhennet, dhe Unë nuk brengosem, dhe këta hynë në zjarr, dhe Unë nuk brengosem.”***

Njohja se Ai është i pavarur nga gjithçka dhe nuk e brengos asgjë, të mjafton që ta kuptosh se duhet të kesh frikë prej Tij. Kjo është frika prej Dhatit të Allahut.

Grupi i dytë i atyre që kanë frikë janë ata që frikësohen duke menduar për diçka që nuk ju pëlqen, për shembull mendimi për momentin e vdekjes dhe dhimbjen e vdekjes, pyetjet e Munkirit e Nekirit, vuajtjen në varr, ringjalljes dhe qëndrimit para Allahut, për turpin nga zbulimi i punëve të fshehta, pyetjeve edhe për imtësitë më të vogla, mendimi i tmerrit të urës së Siratit dhe Xhehenemit, frika nga privimi i mundshëm nga xhenneti dhe nga bukuria e Allahut, si dhe

frika nga grada e ulët; të gjitha këto janë frika që lindin nga të menduarit për gjëra të tilla. Kjo është arsyeja pse ato janë të tmerrshme.

Gjendjet e atyre që frikësohen për këto dallojnë, e grada më e lartë e frikës është frika nga privimi prej bukurisë së Allahut, që është frika e arifëve, e gradë më e ulët se kjo është frika e dijetarëve, zahidëve, salihëve dhe njerëzve të zakonshëm. Ata që nuk shikojnë përmes marifetit dhe të cilëve nuk u është hapur basireti, nuk mund ta njohin kënaqësinë e takimit dhe dhimbjen e ndarjes. Bile, kur thuhet se arifi nuk i frikësohet zjarrit të xhehenemit por perdes që pengon vëzhgimin, njerëzit habiten nga kjo dhe e konsiderojnë këtë një mendim të kotë. Po të mos e kishte ndaluar sheriati, ata do të përpiqeshin ta mohonin kënaqësinë e shikimit në bukurinë e Allahut. Edhe nëse e pranojnë këtë me gjuhë, kjo është nga imitimi, por nuk do ta pranojnë me zemër, sepse nuk njohin tjetër përveç kënaqësisë së stomakut dhe epshit. Kënaqësinë e arifit mund ta kuptojë vetëm arifi. Shpjegimi dhe detajet nuk janë të lejuara për ata që nuk janë arifë, e vet arifët nuk kanë nevojë që këtë ta shpjegojnë.

Pra, frika e atyre që kanë frikë ndahet në këto grupe. Allahu Teala, me fisnikërinë e Tij, na dhuroftë ndihmesë të bukur!

## FAZILETI I FRIKËS DHE NXITJA NË TË

Dije se fazileti i frikës nganjëherë mund të kuptohet me të menduar dhe me nxjerrje të mësimit, e nganjëherë nga ajetet dhe hadithet. Mënyra e të menduarit dhe nxjerrja e mësimit është kjo:

Fazileti i diçkaje matet me atë se në çfarë mase ndikon ajo në lumturinë e takimit me Allahun Teala në ahiret. Qëllimi final është lumturia, e lumturia më e madhe e robit është afrimi me Allahun dhe takimi me Të. Gjithçka që ndihmon në këtë drejtim ka fazilet, e fazileti është ne lidhje me arritjen e përfundimit. Dhe është e njohur se lumturia e takimit me Allahun Teala në ahiret mund të arrihet vetëm duke fituar dashurinë dhe afërsinë e Tij në këtë botë. Dashuria arrihet vetëm me marifet, e marifeti mund të arrihet vetëm me të menduar të vazhdueshëm, ndërsa afërsia arrihet vetëm me dhikr të vazhdueshëm. Dhikri i vazhdueshëm dhe të menduarit arrihen vetëm nëse nga zemra largohet dashuria për dynjallëk, e dashuria për dynjallëk mund të dalë nga zemra vetëm duke braktisur kënaqësitë dhe epshet e kësaj bote. Dëshirat dhe kërkesat e nefsit mund të braktisen vetëm me kundërshtim e epshit, dhe kundërshtimi i epshit është më së shumti i mundur përmes zjarrit të frikës.

Pra, frika është një zjarr që djeg epshin dhe fazileti i kësaj matet sipas shkallës së djegies të epshit dhe sipas asaj se sa arrin të largojë nga gjynahi e të nxisë në ibadet, e kjo dallon sipas gradave të frikës, siç e shpjeguam tashmë. E si të mos jetë frika fazilet, kur ajo sjell dëlirësi, vera, takvallëk dhe xhihad, e të gjitha këto cilësi janë më të pranueshme që na afrojnë tek Allahu, përmes frikës.

Sa i përket për faziletit të frikës që tregohet në ajete dhe hadithe, ato janë shumë për t'u numëruar. Dëshmia që do të jetë e mjaftueshme për ty në këtë çështje është se te ata që i frikësohen Allahut, Allahu Teala i ka përmbledhë faziletet e frikës si udhëzimin, mëshirën, diturinë dhe rizanë, që vlen edhe për banorët e xhennetit që kanë arrit të gjitha gradat.

### ***Ajete për këtë çështje:***

**“...udhëzime e mëshirë për ata që kanë frikë ndaj Rabbit të tyre.”** 7-Araf: 154,

**“Në të vërtetë, nga robët e Tij, Allahu ia kanë frikën vetëm dijetarët.”** 35-Fatir: 28, pra, për shkak të diturisë së tyre, Allahu i përshkruan si ata që ia kanë frikën Atij.,

**“Allahu është i kënaqur me ata, e edhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Rabbin e vet.”** 98-Bejina: 8

Gjithçka që tregon faziletin e diturisë tregon edhe faziletin e frikës, sepse frika është fryt i diturisë. Tregohet se Musa a.s., ka thënë: *“Për ata që kanë frikë ka gradë më të lartë ku të tjerët nuk mund të jenë ortakë”*. Pra, *Refik-i A'la* (grada më e lartë) është vetëm e tyre. Sepse ata janë dijetarë. Dijetarët, pasi që janë trashëgimtarë të peygamberëve, janë me peygamberët. Miqësia në *Refik-i A'la* është ekskluzivisht për peygamberët dhe për ata që bashkohen me ta. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., kur ishte para vdekjes, ishte i lirë të zgjidhte; ose të mbetet në dynja, ose të takohet me Allahun Teala. Atëherë tha:

**“O Allah, dua *Refik-i A'la* prej Teje.”**<sup>52</sup>

Pra, nëse shikojmë se çfarë lind frikën, do të shihet se kjo është dituria, e nëse shikohet fryti i frikës, shohim se ajo është devotshmëria (*takva*). Ndërsa fazileti i diturisë dhe devotshmërisë nuk është i fshehur për askënd. Bile është kaq e qartë ashtu si hamdi që i takon vetëm Allahut dhe salavati vetëm Resulallahut, s.a.v.s..

---

<sup>52</sup> Muttefekun alejhi, nga Ajshe, r.anha



Prandaj thuhet: *“Hamd i takon Allahut, Rabbit të botëve, përfundimi i mirë për të devotshmit (muttekijj) dhe veçanërisht salat dhe selam Muhammedit, s.a.v.s., dhe familjes së tij”*, e për devotshmërinë (takva) një ajet thotë:

**“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin devotshmëria (takva) juaj.”** 22-Haxh: 37

Takva, siç e shpjeguam më lartë, përbëhet nga largimi dhe ruajtja nga gjërat haram si pasojë e frikës. Për këtë thuhet:

**“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më së shumti Atij.”** 49-Huxhurat: 13

Allahu Teala ia këshilloi takvallëkun edhe atyre që ishin më parë, edhe atyre që erdhën më pas:

**“Ne ju patëm sugjeruar atyre që iu pat dhënë libri para jush, e edhe juve, që të keni frikë nga Allahu.”**

4-Nisa: 131

Allahu Teala gjithashtu thotë:

**“Frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!”**

3-Ali Imran: 175

Duke e urdhëruar frikën, Allahu Teala e bëri atë kusht besimi. Prandaj asnjë besimtar nuk mund të jetë pa frikë, edhe nëse është frikë e dobët, e dobësia e frikës vjen nga marifeti i dobët dhe imani i dobët.

Ndërsa Resulallahu, s.a.v.s., për faziletin e takvallëkut, thotë:

**“Kur Allahu Teala t’i mbledh të gjitha gjallesat në vendin e gjykimit në Ditën e caktuar të gjykimit, ata afër dhe larg do të dëgjojnë njësoj një zë, që ju thotë:**

**- O njerëz! Qysh se ju krijova, ju kam dëgjuar deri në këtë ditë, e sot ju më dëgjoni Mua; sot janë vetëm veprat tuaja, pasojat e të cilave do t’i shijoni. O njerëz! Unë caktova lidhje e marrëdhënie, e edhe ju caktuat lidhje e marrëdhënie. Ju lidhjet e Mia i zhvlerësuat, e lidhjet e juaja i lartësuat. Unë thashë: “Më i nderuari prej jush është më i devotshmi prej jush”, e ju thoshit: “Ky e ai, i biri i filanit a fistekut” dhe “Filani është më i pasur se fisteku”. Sot Unë do të zhvlerësoj lidhjet dhe marrëdhëniet e juaja e do t’i lartësoj të Miat. Ku janë të devotshmit?! Atëherë do të ngritët menjëherë një bajrak për ta, e ata do ta pasojnë këtë bajrak në rrugë për te vendqëndrimet e tyre, dhe do të hynë në xhennet, pa dhënë llogari.”<sup>53</sup>**

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Kulmi i hikmetit është frika nga Allahu.”<sup>54</sup>**

Resulallahu, s.a.v.s., i tha Ibn Mesudit:

**“Nëse dëshiron të më takosh, pas meje të kesh shumë frikë Allahun.”**

---

<sup>53</sup> Taberani në *el—Evsat*, Hakimi në *Mustedrek*, dhe es-Sa’leb, në tefsirin e tij, nga Ebu Hurejre.

<sup>54</sup> Ebu Bekr ibn Ial et-Fekih në *Mekarim el-ahlak*, dhe Bejheki në *esh-Shuab*, nga Ibn Mesud.

Fudajli b. Ijaz ka thënë: *“Kush ka frikë Allahun, ajo frikë do ta nxisë në të gjitha të mirat.”*

Esh-Shibli ka thënë: *“Sa herë që i frikësohesha Allahut, kjo m'i hapte dyert e hikmetit dhe mësimit që kurrë më parë nuk i kisha parë.”*

Jahja ibn Muadh ka thënë: *“Çdo besimtari që bën një gjynah, i pasojnë dy mirësi: njëra është frika nga dënimi i Allahut, e tjetra është shpresa në mëshirën e Tij, bash si një dhelpër mes dy luanëve.”*

Me një transmetim, Musa a.s., tregon:

***“Allahu Teala thotë: ‘Të gjithëve do t’ju jetë e vështirë llogaridhënia, dhe të gjithë do të japin përgjegjësi, përpos më të devotshmit. Do të më vije turp t’i ndal ata për llogaridhënie.’”***

Vera dhe takva janë emërtime që janë marrë nga disa kuptime, e që kusht e kanë frikën, nëse në to nuk ka frikë, nuk do t’i kishin këto emërtime. Po kështu, edhe dhikrin Allahu Teala e bëri veçanërisht për ata që kanë frikë, e tha:

***“Do të këshillohet ai që ka frikë.”*** 87-Ala: 10

***“Për ata që i frikësohen paraqitjes para Rabbit të vet, janë dy xhennete.”*** 55-Rahman: 46

Resulallahu, s.a.v.s., në një hadith kudsî tregon:

***“Allahu Teala thotë: Beto hem në madhërinë Time, Unë nuk do të bashkoj dy frikë dhe dy siguri për robin Tim. Nëse robi im është i sigurt prej Meje në këtë botë, unë do ta frikësoj atë në ditën e Gjykimit. Nëse më frikësohet në këtë botë, do ta bëj të sigurt në ditën e Gjykimit.”***<sup>55</sup>

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Çdo gjë i frikësohet atij që i frikësohet Allahut. E ai që i frikësohet dikujt tjetër përveç Allahut, Allahu e bën atë të frikësohet nga çdo gjë.”***<sup>56</sup>

Gjithashtu, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Më të mençurit prej jush janë ata që më së shumti i frikësohen Allahut, dhe të cilët më së miri respektojnë dhe zbatojnë urdhrat dhe ndalesat e Tij.”***

Jahja ibn Muadh ka thënë: *“Sa i mjerë është njeriu! Sikur t’i frikësohej xhehenemit ashtu siç i frikësohet varfërisë, do të hynte në xhennet.”*

Zunnuni Misri ka thënë: *“Kush ka frikë Allahun Teala, i shkrihet zemra, i forcohet dashuria ndaj Allahut, dhe i kthjellet mendja”,* dhe gjithashtu ka thënë:

---

<sup>55</sup> Ibn Hibban në *Sahih*, Bejheki në *esh-Shuab* nga Ebu Hurejre, si edhe Ibn Muhaber në *ez-Zuhd*, dhe Ibn Ebu Dun’ja në *Kita bel-haifin*, nga Hasani.

<sup>56</sup> Ebu esh-Shejh Ibn Hibban në *Kitab s-sevab* nga Ebu Umame,

*“Frika duhet të jetë më e madhe se shpresa. Sepse kur mbizotëron shpresa, zemra ngatërrohet.”*

Ebu el-Hasan ed-Darir thoshte: *“Shenja e lumturisë është frika nga gjynahet. Sepse frika është mes robit dhe Allahut dhe është fre për robin. Nëse këputet ky fre, robi do të shkatërrohet bashkë me ata që janë shkatërruar.”*

I thanë Jahja ibn Muadhrit:

- *Kush do të jetë më i sigurti nga njerëzit në Ditën e Gjykimit nesër? Ai tha:*

- *Ai që sot ka më së shumti frikë Allahun.*

E Sehl ka thënë: *“Pa kafshatë hallall, nuk ka frikë.”*

Hasan Basriun e pyetën:

- *O Ebu Seid! Çfarë të bejmë? Bisedojmë me njerëz të tillë që aq shumë na frikësojnë, sa zemrat donë të na dalin prej vendit!, e Hasani ju tha:*

- *Vallahi, më mirë për ju është të shoqëroheni me njerëz që ju frikësojnë, se sa të shoqëroheni me njerëz që ju bëjnë të ndiheni të sigurt.*

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Zemra në të cilën nuk ka frikë, do të shkatërrohet.”*

Ajsha, r.anha e pyeti Resulallahun, s.a.v.s., për kuptimin e ajetit:

**“Dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë”** (23:60), se a ka të bëjë kjo me njerëz që vjedhin e bëjnë zina? e Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

***“Jo. Kjo ka të bëjë me atë që agjëron, falë namaz dhe jep sadaka e zeqat, por ka frikë se këto ibadete nuk do t’i pranohen.”***<sup>57</sup>

Përpos kësaj, ka shumë transmetime që kanë mbërri deri tek ne, e që ju tërheqin vërejtjen njerëzve që assesi të mos ndihen të sigurt nga dënimi i Allahut, dhe e gjitha kjo është lavdërim për frikën, sepse qortimi i diçkaje do të thotë lavdërim i të kundërtës së saj, dhe e kundërta e frikës është siguria, siç është dëshpërimi e kundërta e shpresës.

Pra, ashtu siç qortimi i dëshpërimit që tregon faziletin e shpresës, edhe qortimi i sigurisë tregon faziletin e frikës. Bile, do të themi se krejt ajo që transmetohet për faziletin dhe lavdërimin e shpresës është dëshmi për faziletin dhe lavdërimin e frikës. Sepse shpresa dhe frika janë dy veti të pandashme. Secili që shpreson në takim me të dashurin duhet të frikësohet edhe nga ndarja, e nëse nuk i frikësohet ndarjes, atëherë as nuk po e do.

---

<sup>57</sup> Tirmidhi, Ibn Maxhe dhe Hakimi.

Pra, shpresa dhe frika janë të pandashme mes vete. Natyrisht, është e mundur që njëra të jetë më e fortë se tjetra, dhe zemra mund të jetë e angazhuar me njërin, duke mos përfillë tjetrën, për shkak të neglizhimit momental, sepse kusht i frikës dhe shpresës është që personi të ketë kujdes nga e dyshimta. Pra, ajo që dihet sigurt, për të nuk shpresohet e as nuk ka frikë.

Do me thënë, e dëshiruar është edhe ajo që mund të jetë edhe ajo që nuk mund të jetë. Nëse mendon se do të ndodhë, kjo e shqetëson zemrën dhe kjo është shpresa; nëse mendon se nuk do të ndodhë, kjo shkakton dhimbje në zemër, dhe kjo është frika. Pra, kur gjendja është e dyshimtë, është e qartë se frika dhe shpresa nuk janë të ndara nga njëra-tjetra. Megjithëkëtë, me disa sebepe, njëra anë e dyshimeve mund të jetë më e fortë, dhe kjo quhet supozim. Ky supozim bëhet sepse që njëra mundësi të jetë më e fortë se tjetra. Nëse mbizotëron supozimi që të ndodhë e dëshiruara, ana e shpresës bëhet më e fortë dhe ajo e frikës dobësohet, e njëjtë vlen edhe në rastin e kundërt. E në të dy rastet, frika dhe shpresa mbesim të pandashme. Prandaj Allahu Teala thotë:

**“Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar,...”**

21-Enbija: 90,

dhe:

**“Duke e lutur Rabbin e tyre nga frika dhe nga shpresa.”** 32-Sexhde: 16

Arabët kanë shprehur frikën me shprehjen *rexha* (që do të thotë *shpresë*), e Allahu Teala thotë:

**“Ç’është me ju që Allahut nuk i shprehni madhërinë që e meriton?”** 71-Nuh: 13. Në Kur’an shpesh gjejmë që termi *shpresë* (*rexha*) shpreh kuptimin *frikë* (*havf*), sepse ato gjithmonë shkojnë bashkë, ndërsa arabët e kanë zakon të quajnë diçka me emrin e asaj për çka kjo është ngushtë e lidhur.

Do të them gjithashtu se të gjitha shkrimet që tregojnë faziletin e të qarit nga frika prej Allahut, tregojnë faziletin e frikës, sepse të qarit është fryt i frikës. Allahu Teala thotë:

**“Le të qeshin pak, e të qajnë shumë.”**

9-Teube: 82, dhe:

**“Ata bien me fytyrë përtokë, duke qarë dhe Ai ua rrit përuuljen”** 17-Isra: 109, dhe:

**“Vallë, prej kësaj fjale po çuditeni dhe po qeshni e nuk po qani?**

**Madje, jeni edhe të shkujdesur!”** 53-Nexhm: 59-61.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: **“Secilin besimtar që nga syri i pikon lot, qoftë edhe sa koka e mushkonjës, nga frika prej Allahut, pastaj ngrohtësia e tij i prek fytyrën, Allahu do ta ruajë nga Zjarri.”**<sup>58</sup>,

---

<sup>58</sup> Taberani dhe Bejheki, nga Enesi.



***“Kur besimtarit i rrëqethet zemra nga frika e Allahut, gjynahet i bien si gjethet e pemës.”<sup>59</sup>***

***“Ai që qan nga frika e Allahut nuk hyn në zjarr, aq sa qumështi (i mjelë) që nuk kthehet në sisë.”<sup>60</sup>***

Ukbe ibn Amir tregon se pyeti Resulallahun, s.a.v.s.:

- *Cila është rruga e shpëtimiti, o i dërguar i Allahut?, e Resulallahu, s.a.v.s., iu përgjigj:*

- ***Ruaje gjuhën, qëndro në shtëpi dhe qaj për gabimet e tua.***<sup>61</sup>

Aisha, r.anha, ka treguar: “E pyeta Resulallahun (s.a.v.s.):

- *A do të hyjë dikush nga ummeti yt në xhennet pa dhënë llogari?, e mu përgjigj:*

- ***Po, ai që i kujtohen gjynahet e veta, dhe qanë.”***

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: ***“Nuk ka gjë më të çmuar tek Allahu se sa një pikë loti e derdhur nga frika prej Allahut apo një pikë gjaku e derdhur për rizanë e Allahut.”***<sup>62</sup>

---

<sup>59</sup> Taberani dhe Bejheki, nga Abbasi.

<sup>60</sup> Tirmidhi, Nrsai dhe Ibn Maxhe, nga Ebu Hurejre.

<sup>61</sup> Është përmendur më parë..

<sup>62</sup> Tirmidhi, nga Ebu Umame.

***“Allahu im! Para se lotët të bëhen gjak dhe dhëmbët të bëhen prush, më dhuro dy sy që qajnë shumë që të shërojnë zemrën duke derdhur lot.”<sup>63</sup>***

Resulallahu s.a.v.s., në një hadith të gjatë gjithashtu ka thënë se shtatë lloj njerëzish Allahu Teala i vendos nën hijen e Arshit, në ditën kur nuk do të ketë hije tjetër, e një prej atyre është ai që në vetmi përmend Allahun (bën dhikër), dhe i mbushen sytë me lot.<sup>64</sup>

Ebu Bekr es-Siddik r.a., ka thënë: *“Kush mund të qajë, le të qajë, e kush nuk mundet, le të bëhet sikur po qanë.”*

Ndërsa Muhammed ibn Munkedir, kur qante, lotët i shpërndante me dorë nëpër fytyrë e mjekër, e thoshte:

*“Kam dëgjuar se zjarri i xhehenemit nuk do të prekë ku ka prekë loti.”*

Abdullah ibn Amr ibn el-As ka thënë: *“Qani, e nëse nuk qani, atëherë bëhuni sikur po qani! Sepse, pasha Atë që në dorën e Tij është shpirti im, sikur dikush prej jush të kishte njohuri të vërtetë, do të qante me zë të lartë deri sa zëri t'i shterej, dhe do të falte namaz deri sa kurrizi t'i thyhej.”*

---

<sup>63</sup> Tirmidhi dhe Ebu Nuajm nga Ibn Omeri Taberani, Ebu Nejm nga Ibn Omeri, Husejn Mervezi nga Ibn Mubarek prej SAilm ibn Abdullah

<sup>64</sup> Muttefekun alejhi, nga Ebu Hurejre.

Ebu Sulejman Darani, ka thënë: *“Atij që loti ia lagë sytë nga frika e Allahut, nuk do të përballet me poshtërim në ditën e Gjykimit. Nëse lotët e tij rrjedhin, me pikën e parë të lotit të tij Allahu Teala do ta fikë zjarrin e xhehenemit. Nëse qan për një xhemat, ai xhemat nuk do të ndëshkohet.”*

Ebu Sulejman gjithashtu ka thënë: *“Qarja është nga frika. Shpresa dhe gëzimi janë nga zelli i madh.”*

“Ka'bu'l-Ahbar ka thënë: *“Pasha Atë që në dorën e Tij është shpirti im, për mua më e dashur është të qaj nga frika e Allahut dhe të më rrjedhin lot në faqe, sesa të jap sadaka një mal me dukat.”*

Abdullah ibn Omer, ka thënë: *“Për mua më e dashur është të lëshoj një lot nga frika e Allahut sesa të jepja një mijë dukat sadaka!*

Hanzala tregon: *“Një herë ishim me Resulallahun s.a.v.s., e ashtu na këshilloi sa na i zbuti zemrat, na u mbushën me frikë, e sytë lotonin; e njohëm veten. U ktheva në shtëpi, e gruaja mu afrua dhe folëm për dynja, e unë harrova çka kisha dëgjuar nga i Dërguari i Allahut. Pastaj mu kujtua, e mendova:*

*- Jam dyfytirësh! Më humbi ajo frika dhe ndjenja e mirë që pata! Dola në rrugë dhe fillova të bërtasë:*

- *Hanzala është dyfytyrësh! Hanzala është dyfytyrësh!... Ndërkohë, takova Ebu Bekrin, e më tha:*

- *Jo, Hanzala nuk është dyfytyrësh! Shkova te i dërguari duke përsëritë:*

- *Hanzala është dyfytyrësh!, e edhe i dërguari i Allahut më tha:*

- ***Jo, Hanzala nuk është dyfytyrësh!*** Unë i thashë:

- *O i dërguar i Allahut! Ishim te ti, e ti ashtu na këshillove sa zemrat na u zbutën dhe u mbushën me frikë, e nga sytë na rrodhën lot; e njohëm veten. U ktheva në shtëpi dhe filluam të flasim për dynja, e unë harrova atë që e dëgjova te ti!*

*Atëherë i dërguari i Allahut më tha:*

- ***O Hanzala! Po të ishit ju vazhdimisht në atë gjendje, melaiket do të shtrëngonin duart me ju rrugëve e në shtrojat tuaja, Por, o Hanzala kjo gjendje herë vjen, herë shkon.***<sup>65</sup>

Pra, krejt çka thuhet për faziletin e shpresës, qarjes, takvasë, diturisë, edhe për qortimin e të qenit i sigurt nga dënimi; e gjitha kjo tregon edhe faziletin e frikës, sepse të gjitha këto janë të lidhura me frikën.

---

<sup>65</sup> Muslimi.

## MË MIRË TË DOMINOJË FRIKA APO SHPRESA; APO TË DYJA NJËJTË?

Dije se ka shumë hadithe për faziletin e frikës dhe shpresës, prandaj ai që mendon për to mund të dyshojë e mos ta dijë se cila prej tyre është më e mirë. Nuk është e duhur as e drejtë pyetja: *“A më e vlefshme është frika apo shpresa?”*, sepse është sikur të pyesësh: *“A më e vlefshme është buka apo uji?”*, e do të marrësh përgjigjen se buka është më e vlefshme për të uriturin, e uji më i vlefshëm për të eturin.

Nëse është edhe i uritur edhe i etur, atëherë shikohet se cila dominon, e nëse dominon uria, për të buka është më e vlefshme, e nëse dominon etja, atëherë për të uji do të jetë më i vlefshëm. Nëse është sa i uritur aq edhe i etur, edhe vlerat e bukës dhe ujit për të janë barabar. Kjo sepse gjithçka që kërkohet për një qëllim, vlera i dihet vetëm në raport me qëllimin, jo vetvetiu. Frika dhe shpresa janë si dy ilaç që shërojnë zemrat. Vlera e tyre është sipas sëmundjes së zemrës. Nëse zemrën ia mposht sëmundja e sigurisë nga dënimi i Allahut, frika si ilaç është më e mirë, e nëse zemrën ia mposht sëmundja e dëshpërimit nga mëshira e Allahut, atëherë shpresa është ilaç më e mirë për të. Edhe kur e dominojnë gjynahet, frika është ilaç më i mirë.

Në përgjithësi, mund të thuhet se frika është më e mirë, në bazë të shpjegimit që thotë se buka është më e vlefshme, se *sekenxhebin* (pije nga uji, uthulla dhe mjalti) sepse me bukë shërohet uria, e me *sekenxhebin* shërohet sëmundja e vrerit. Vrerit është një sëmundje e rrallë, ndërsa uria është më e shpeshtë, dhe nevoja për bukë është më e madhe, dhe për këtë arsye buka është më e vlefshme. Duke marrë parasysh këtë, mund të themi se frika është më e mirë, sepse njerëzit më shumë zhyten në gjynahe dhe më shumë mashtrohen me faljen e Allahut Teala.

Nëse shikojmë paraqitjen e shpresës dhe frikës, atëherë shpresa është më e mirë, sepse shpresa ujitet nga oqeani i rahmetit, e frika ujitet nga oqeani i zemërimit. Kush mendon për mëshirën e Allahut dhe mirësitë e Tij, dashuria e tij për Allahun është më e madhe, e përtej dashurisë nuk ka asnjë gradë tjetër. Baza e frikës është të kujtuarit e cilësive që kërkojnë ashpërsi dhe dhunë. Pra, dashuria nuk përzihet me frikën, ashtu siç nuk përzihet as me shpresën.

Shkurtimisht; për atë që kërkohet për qëllim tjetër, më e përshtatshme është të përdoret termi "*më e mirë*" sesa "*e mirë*". Pra, nuk ka të bëjë me atë se cila është mbi të tjetrën, por cila është më e dobishme.

Prandaj, ne themi se, për shumicën e njerëzve ana e frikës është më e dobishme se ajo e shpresës, sepse shumica e njerëzve kanë më shumë gjynahe, e ajo që i përshtatet gjynahqarit është frika, jo shpresa.

Sa i përket personit të devotshëm që i braktis gjynahet e fshehta dhe të hapura, atij i përshtatet që frika dhe shpresa të jenë të barabarta. Prandaj, është thënë se *po të peshohej frika dhe shpresa e besimtarit, ato me siguri do të ishin të barabarta*. Transmetohet se Alia r.a., i tha njërit prej fëmijëve të vet: *"Evlad! Frikësoju Allahut aq sa, edhe nëse i shkon Atij me veprat e mira të të gjithë njerëzve, Ai nuk t'i pranon, e edhe shpresoj e mbështetu në Allahun aq sa, edhe nëse i shkon me gjynahet e të gjithë njerëzve, Ai të falë."*

Prandaj Omeri r.a., ka thënë: *"Nëse të gjithë njerëzit do të hyjnë në xhehenem, përveç njërit, shpresoj se unë jam ai. Dhe nëse të gjithë njerëzit do të hyjnë xhennet përveç njërit, kam frikë se unë jam ai."*

Pra, kjo që e shpjeguar është shkalla e fundit e frikës dhe shpresës. Ajo që ju përshtatet njerëzve si Omeri r.a., është se frika dhe shpresa e tyre janë të barabarta. Mirëpo, është mashtrim për një gjynahqar të mendojë se ai nuk do të jetë prej atyre që do të hyjnë në xhehenem në Ditën e Gjykimit.

Nëse thua:

*“Kur flitet për dikë si Omeri r,a , nuk duhet që frika e shpresa të jenë baras te ai, por shpresa duhet të dominojë, siç u shpjegua në fillim të librit se fuqia e shpresës duhet qenë përshtatshëm fuqisë së shkaktarëve që e nxisin, sikur te mbjellja së farës; ai që mbjellë farë të mirë në tokë të pëlleshme, e ujit tokën me kohë dhe i plotëson të gjitha kushtet tjera që kërkohen, sigurisht që shpresa i mbizotëron mbi frikën. Kjo duhet të jetë gjendja e secilit besimtar të devotshëm”;*

Atëherë dije se,

ai që diturinë e merr nga fjalët e shembujt, gabon shpesh. Fjalët e Omerit që i sollëm si shembull nuk mund të krahasohen me kohën tonë, sepse sepse pse shpresa mbizotëron është njohuria e fituar përmes përvojës. Pra, për tokë të pëlleshme, farë të mirë, motin, përmbytjet dhe rreziqet tjera - këto janë gjëra që mësohen përmes përvojës.

Por, rasti jonë është si shembulli i farës që nuk është provuar më parë, lloji i së cilës është i panjohur, hedhur në tokë të cilës ka kohë që nuk i dihet cilësia. Në këso rasti, sado që njeriu të angazhohet dhe të bëjë gjithçka që është në mundësinë e tij, atij shpresa nuk ia mund frikën.



Në çështjen tonë, *farë* është imani, e kushtet e imanit janë të qarta, ndërsa *tokë* është zemra, e ajo ka papastërti të fshehta si shirk, dyfytërsi dhe intrigë dhe është shumë e vështirë që gjërat e fshehura në zemër të zbulohen.

*Katastrofa natyrore* që godasin të mbjellat janë epshet dhe stolitë e dynjasë, për të cilat zemra mund të jetë e lidhur në të ardhmen, edhe nëse tani nuk është, e kjo nuk mund të vërtetohet dhe njihet vetëm me përvojë, sepse mund të paraqiten sebepe që personi nuk mund t'i kundërshtojë, diçka që më parë nuk e ka përjetuar. Mot i ligë, bubullima dhe breshër, janë tmerret në momentin e vdekjes dhe lëkundja e besimit në atë moment, dhe kjo është çfarë ai nuk e ka përjetuar ende. Më pas vjen *korrija* - fryti, që do të thotë të hyrje në xhennet, e edhe kjo është diçka që ai nuk e ka përjetuar më parë.

Nëse një person që e di të vërtetën e gjithë kësaj është i dobët në zemër dhe në thelb është frikacak, frika e tij padyshim se do të mbizotërojë mbi shpresën e tij, që do ta shpjegojmë kur të flasim për gjendjet e atyre që kishin frikë, nga as'habët, taibinët dhe selefi salihin. E nëse zemrën e ka të fortë e të guximshme, nëse posedon njohje të plotë, shpresa dhe frika edhe mund t'i jenë të barabarta, por që shpresa nuk do t'ia dominojë frikën.

Omeri r.a., vazhdimisht e kontrollonte zemrën, në detaje. Bile e pyeste Huzejfen r.a., se a sheh te ai shenja të dyfytyrësisë, sepse Resulallahu, s.a.v.s., vetëm Huzejfen e mësoi si ta njohë dyfytyrësinë. E kur Omeri r.a., ishte në këtë gjendje frike, kush tjetër guxon të pretendojë se e ka zemrën larg nga njolla e dyfytyrësisë? Edhe nëse është larg, kush mund ta sigurojë atë se është i mbrojtur nga dënimi i Allahut? Kush mund të jetë i sigurt nga fryma e fundit? Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

***“Vërtetë që personi do të bëjë vepra të banorëve të xhennetit për pesëdhjetë vjet dhe mes tij e xhennetit do të mbetet vetëm një pëllëmbë”***, e në transmetim tjetër:

***“... do të mbetet aq kohë sa shtrëngohet e lëshohet grushti kur mjelë devenë. Pastaj e mund ajo që është shkruar dhe fillon të bëjë vepra të banorëve të xhehenemit dhe do të hyjë në xhehenem.”***<sup>66</sup>

Është e vështirë të mendohet koha që kalon sa shtrëngohet e lëshohet grushti kur mjelë devenë; e këtu në fakt po flitet për mendimin që lajmërohet në zemër në momentin e vdekjes, që sjell përfundim të keq. Si mund njeriu të ndjehet i sigurt prej kësaj? Prandaj, qëllimi më i lartë i besimtarit është që frika dhe shpresa e tij të barazohen.

---

<sup>66</sup> Muslimi, nga Ebu Hurejre, Bezzar dhe Taberani, si edhe Buhari dhe Muslim, nga Ibn Mesud

Dominimi i shpresës te shumica e njerëzve është pasojë e mendjemadhësisë dhe padijes, e Allahu i bashkon frikën e shpresën në përshkrimin e atyre që Ai i lavdëron:

**“Na luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar.”**

21-Enbija: 90

Shembull është Omeri r.a.. E ku janë njerëzit si Omeri, r.a.? Për shumicën e njerëzve sot (koha e Gazalit), më e udhës është që frika t’ju dominojë shpresën, por me kusht të mos i dërgojë në dëshpërim, braktisje të veprave të mira dhe humbje të shpresës në faljen e Allahut, që do të bëhej shkaktar i dembelisë dhe heqjes dorë prej angazhimit, si edhe motiv për shkatërrim e gjynahe; e atëherë nuk do të ishte frikë, por dëshpërim dhe pashpresë. Frika e motivon njeriun për veprim dhe mbrapsje të epshit, e ndalon zemrën të mos anojë kah dynjallëku; kjo është frika e lavdëruar, e nuk është frika fjalë e zemrës që ndalon gjynahin dhe motivon për ibadet, siç nuk është as dëshpërim që do të rezultonte me pashpresë.

Jahja ibn Muadh ka thënë:

*“Kush i bën ibadet Allahut vetëm nga frika, është zhytur në detin e mendimeve. Kush i bën ibadet Allahut vetëm nga shpresa, bie në shkretëtirën e hutimit. E kush i bën ibadet Allahut nga frika dhe shpresa bashkë, ai ecë në rrugë të drejtë.”*

Edhe Mekhul Dimeshki ka thënë:

*“Kush i bën ibadet Allahut vetëm nga frika, ai është harixhi. Kush i bën ibadet Allahut vetëm nga shpresa, është murxhi. Kush i bën ibadet Allahut vetëm për shkak të dashurisë është zindik. E kush i bën ibadet Allahut nga frika, shpresa dhe dashuria, ai është muvahhid.”*

Prandaj, në ibadet duhet të bashkohen të tria, me atë që ana e frikës duhet të mbizotërojë deri në kohën para vdekjes, e në momentin e vdekjes, më e mira është që të mbizotërojë shpresa dhe mendimet e mira. Sepse frika është sikur kamxhiku që nxitë në veprim, ndërsa në momentin e vdekjes veprimi merr fund, e atëherë frika nuk mund të bëjë tjetër veçse shqetëson dhe mërzitë. Por shpresa e forcon zemrën, bën ta duash Allahun dhe të lidh më shumë me Allahun, dhe në momentin e vdekjes zemra ia përkujton njeriut mëshirën e pafund të Allahut.

Ajo që i përshtatet secilit është ta lëshojë këtë botë me dashurinë e Allahut, sepse kush dëshiron takim me Allahun, edhe Allahu dëshiron takim me të, e dashuria është bashkë me shpresën. Personi që shpreson në mirësinë e Allahut është i dashur. Qëllimi i diturisë dhe i veprimit është marifeti, e marifeti e lind dashurinë, sepse kthimi është te Allahu dhe vdekja afron Atij. Ai që i shkon të dashurit, gëzimi do t'i jetë sipas dashurisë që ka, e ai që ndahet nga i dashuri, i shtohet vuajtja dhe mërzia.

Nëse në momentin e vdekjes në zemër mbizotëron dashuria për familjen, fëmijët, pronën, pasurinë, të afërmit dhe miqtë, kjo do të thotë se të gjithë të dashurit e këtij personi janë në këtë botë; kjo botë është bërë xhenneti i tij. Sepse xhenneti është vendi ku ndodhen të gjitha që personi i do. Pra, vdekja e tij është largim nga xhenneti i tij dhe ndarje nga ajo çfarë ai do.

Kur njeriu nuk ka të dashur tjetër përveç Allahut, dhikrit të Tij, njohjes së Tij dhe mendimit për Të, dhe dynjaja e largon nga të gjitha këto, atëherë dynjaja bëhet burgu i tij. Sepse burgu është ndarje e njeriut nga ajo që njeriu e do. Vdekja e tij është shkuarje te i Dashuri dhe lirim nga burgu, e dihet gjendja e atij që lirohet prej burgut, kur mes tij dhe asaj çfarë ai do nuk ka kurrfarë pengese.

Ky është shpërblimi dhe dënimi i vërtetë me të cilin, menjëherë pas vdekjes do të përballet secili që largohet nga kjo botë. Allahu Teala për robët e Tij të mirë ka përgatitur nimete që syri nuk i ka parë, veshi nuk i ka dëgjuar, e njeriu as që ka mundur t'i imagjinojë; dhe ka përgatitur pranga, zinxhirë e forma tjera të nënçmimit dhe dënimit për ata që preferojnë këtë botë ndaj ahiretit, të cilët kënaqen me dynjallëk. E lusim Allahun Teala që të na japë të vdesim si myslimanë e të na bashkojë me robët e Tij të mirë!

E vetmja shpresë që kjo dua të na pranohet është të fitojmë dashurinë e Allahut., e dashuria e Allahut mund të fitohet vetëm duke nxjerr nga zemra dashurinë për të tjerët, për pozitë, pasuri dhe gjithçka tjetër pos Allahut. Më e mira është të bëjmë duanë që e ka bërë Resulallahu, s.a.v.s.: ***“Allahu im! Më dhuro dashurinë Tënde, dashurinë e atyre që të duan Ty, dashurinë e asaj që më afron tek dashuria Jote! Më bëj të dua dashurinë tënde më shumë se ujin e ftohtë në ditë të nxehtit të madh.”***<sup>67</sup>

Qëllim e kemi të tregojmë se shpresa është më e mirë në momentin e vdekjes. Sepse shpresa e tërheq më shumë dashurinë, por para vdekjes, frika është më e mirë. Sepse frika më shumë e shuan zjarrin e epsheve dhe më shumë e largon dashurinë ndaj dynjallëkut prej zemrës, dhe e nxit zemrën në ibadet. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

***“Kur të vdisni, vdisni duke menduar mirë për Rabbin tuaj.”***<sup>68</sup>

Allahu Teala thotë: ***“Unë jam ashtu si robi Im mendon për Mua, e le të mendojë për Mua çfarë të dojë.”***

Sylejman et-Tejmi në shtratin e vdekjes, i tha të birit:  
- *Evlad! Më lexo për lehtësimet dhe shpresën, që ta takoj Allahun me mendime të mira.*

---

<sup>67</sup> Tirmidhi, nga Muadhi, është cekur edhe në librin *Dhikr dhe Dua*.

<sup>68</sup> Muslimi, nga Xhabiri, e tashmë është përmendur.

Sufjan es-Sevri kur ishte në shtratin e vdekjes dhe dhimbjet iu shtuan, i mblodhi rreth vetes dijetarët, e ata i dhanë shpresë duke folur për mëshirën e madhe të Allahut Teala. Edhe Ahmed ibn Hanbel, kur ishte në shtratin e vdekjes i kërkoi të birit:

- *Më trego hadithe që flasin për shpresën dhe mendimet e mira.*

Qëllim i gjithë kësaj është që njeriu ta dojë Allahun Teala. Prandaj Allahu Teala e urdhëroi Davudin, a.s.:

- ***Bëj që robët e Mi të më duan.*** Davudi a.s., e pyeti:
- *E si ta bëj këtë?;* e Allahu Teala tha:
- ***Duke ua përkujtuar atyre nimetet dhe të mirat që Unë ju dhashë.***

Pra, po kuptohet se lumturia më e madhe është që personi të vdesë i dashuruar në Allahun, e ta duash Allahun është e mundur duke e njohur Atë dhe duke nxjerr dashurinë e dynjasë nga zemra. Dynjanë e përjeton si një burg që e pengon të takohet me të Dashurin e tij. Një prej robëve të mirë të Allahut e pa në ëndërr Sulejman Daranin duke fluturuar, dhe e pyeti për këtë, e ai iu përgjigj:

- *Tash jam i lirë nga burgu!* Kur u zgjua ky robi nga gjumi, pyeti për Daranin, e i thanë se atë natë Darani kishte kaluar në ahiret.

## ILAÇI QË LARGON FRIKËN

Dije se shpjegimet tona për sabrin në librin *“Sabr dhe shukr”* mjafton për t'iu përgjigjur kësaj çështjeje. Pra, sabri vjen pas frikës dhe shpresës. Sepse grada e parë e fesë përbëhet nga besimi në Allahun dhe kushtet e imanit, e që përfshinë edhe besimin në xhennet dhe xhehenem. Prandaj imani i motivon njerëzit të kenë frikë nga xhehenemi dhe të shpresojnë për xhennet. Kjo frikë dhe shpresë e forcon sabrin. Sepse xhenneti është i rrethuar me pengesa që mund të kapërcehen vetëm me sabër dhe shpresë të fortë. Edhe xhehenemi është i rrethuar me epshe, që mund të luftohen vetëm me sabër dhe me forcën e frikës. Prandaj Alia, r.a., ka thënë: *“Kush e dëshiron xhennetin duhet të ikë nga epshet, e kush i frikësohet xhehenemit, duhet të ikë nga haramet.”*

Kur personi të ngritët në gradën e sabrit, që i shfaqet nga frika dhe shpresa, më pas duke kaluar në gradën e luftës (*muxhahede*) thellohet në dhikër dhe në mendim të vazhdueshëm. Sepse dhikri i vazhdueshëm sjell afërsinë, mendimi i vazhdueshëm sjell në merifet, e prej afërsisë dhe marifetit lind dashuria. Pas kësaj vjen grada e kënaqësisë (*rida*), mbështetja në Allahun (*tevekkul*) dhe grada tjera.



Kjo është renditja e gradave në rrugën e fesë. Pra, pas bindjes së fortë nuk ka gradë tjetër përveç frikës dhe shpresës, e pas tyre nuk ka gradë tjetër përveç sabrit. Pas sabrit vjen grada *muxhahede* - lufta me nefsin dhe largimi nga gjithçka pos Allahut. Pas muxhahedes, për atë që Allahu Teala ia ka hapur rrugën, vjen grada *hidajet* dhe *marifet*. Pas marifetit vjen grada e dashurisë dhe afërsisë. Dashuria domosdo nënkupton kënaqësi me veprimet e të Dashurit dhe mbështetja në ndihmën e Tij, e kjo është grada *tevvukul* (mbështetja në Allahun). Pra, ajo që kemi shpjeguar për sabrin është e mjaftueshme për të qartësuar këtë çështje.

Por ne do të fokusohemi veçmas te frika, e themi se frika vjen në dy mënyra, ku njëra është më e mirë se tjetra, si frikët e një babai dhe fëmijës së vet në shembullin më poshtë:

Nëse një fëmijë gjendet në shtëpi, e aty futet ndonjë bishë ose gjarpër; fëmija, ndoshta nuk do të frikësohet, ndoshta edhe e drejton dorën kah gjarpri që ta ledhatojë e të luajë me të, por, nëse me fëmijën gjendet edhe babai i tij, i cili e di se sa i rrezikshëm është gjarpri, ai do të frikësohet dhe do të ikë, e kur fëmija të sheh babanë e frikësuar duke ikur nga gjarpri, edhe fëmija ia jep vrapit dhe do ta mbizotërojë frika, prandaj vepron njëjtë si babai.

Frika e babait është rezultat i njohjes së natyrës të gjarprit, helmit dhe cilësive tjera, e frika e fëmijës është rezultat i imitimit të babait, sepse fëmija ka mendim të mirë për të atin dhe e di se ai nuk frikësohet pa sebeb; kështu edhe fëmija do ta kuptojë se gjarpri është i rrezikshëm, ani që ende nuk e di sebebin.

Nëse e kuptove këtë shembull, atëherë dije se edhe frika nga Allahu Teala i ka dy grada: njëra është frika nga ndëshkimi i Allahut dhe tjetra është frika nga Vet Allahu.

Frika nga Allahu është frika e dijetarëve dhe arifëve, ata kanë frikë nga Madhështia e Tij. Dijetarët dhe arifët i dinë të fshehtat e ajeteve:

**“Allahu ju paralajmëron që t’i ruheni Vetes së Tij.”**

3-Ali Imran: 28,

**“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij”** 3-Ali Imran: 102

**E para**, frika nga dënimi i Allahut është frika e njerëzve të rëndomtë, dhe kjo arrihet me besim në xhennet dhe xhehenem dhe në faktin se xhenneti fitohet me ibadet, e xhehenemi është dënim për shkak të gjynaheve. Dobësia e kësaj frike vjen nga gafleti dhe imani i dobët.

Gafleti mund të eliminohet duke menduar për tmerrin në ditën e Gjykimit, për vuajtjet e ndryshme atje, dhe duke shikuar ata që kanë frikë, duke folur me ta e duke vështruar gjendjet e tyre. Nëse nuk mund të shoqërohet me ta dhe t'i shohë, atëherë edhe dëgjimi i tregimeve të tyre ka ndikim.

**E dyta**, pra frika nga Dhata i Allahut është grada më e lartë e frikës. Njeriu më së shumti duhet të këtë fikë nga Dhata i Allahut. Njeriu i frikësohet largimit nga Allahu dhe shpreson t'i afrohet Atij. Zunnuni Misri ka thënë: *"Frika nga xhehenemi në krahasim me frikën e ndarjes nga Allahu është si të kesh frikë nga një pikë uji në det."* Kjo është frika e dijetarëve:

**"Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët."** 35-Fatir: 28

Ashtu si dijetarët, të gjithë besimtarët kanë hisen e tyre nga kjo frikë. Frika e njerëzve të rëndomtë është përmes imitimit, jo përmes *basiretit* - largpamësisë, si fëmija që e përshkruam më lart. Prandaj nuk është habi që aso frike është e dobët dhe shpejt kalon. Bile, nëse fëmija sheh gjuetarin e gjarpërinjve si e kapë gjarprin me dorë, edhe ai do të provojë të bëjë ashtu, njëjtë siç u përmbajt dhe u frikësua nga gjarpri duke parë babanë e vet.

Besimet e fituara përmes imitimit të tillë janë përgjithësisht të dobëta, por personi mund ta forcojë vazhdimisht këtë besim duke menduar për sebepe, duke vepruar në përputhje me atë që e kërkon besimi dhe duke braktisë gjynahet. E nëse ngritët në gradën e marifetit dhe njëh Allahun, domosdo i frikësohet Atij dhe për ta pasur frikë nuk ka nevojë të kërkojë ndonjë zgjidhje tjetër. Dëshiroi apo jo, ai frikësohet. Prandaj Allahu Teala i shpalli Davudit, a.s.:

***“O Davud, ki frikë prej Meje, sikurse ke frikë nga kafshët grabitqare.”***

Për të pasur frikë nga kafshët grabitqare, njeriu nuk ka nevojë të kërkojë njohuri tjetër përveç njohjes së egërsisë së tyre. Edhe ai që e njëh Allahun Teala e di se Allahu bën çfarë të dojë pa hezitim e duke mos u bazuar në askënd, e di se Ai cakton dhe gjykon pa frikë prej askujt, e di se Ai i afron melaiket dhe e largon shejtanin pa asnjë sebep, dhe i di fjalët e Allahut Teala: ***“Këta hynë në xhennet, nuk më intereson, këta hynë në xhehenem, e as kjo nuk më intereson”***, prandaj me siguri se do t'i frikësohet Allahut.

Nëse mendon se Allahu Teala dënon vetëm për gjynah dhe shpërblim vetëm për ibadet, atëherë mendo për atë se Ai nuk ka përgatitur kushte për të devotshmin që i devotshmi të zbatojë urdhrat e fesë, deshi ai a jo, e as nuk ia mundësoi gjynahqarrit të bëjë gjynah, deshi ai a jo, sepse

pa marrë parasysh që Allahu Teala ia përcaktoi pakujdesin, i krijoi epshin dhe ia mundësoi t'i përmbushë ato epshe, vepra do të duhej domosdo të bëhet përshtatshëm këtyre, prandaj nëse Ai e ka larguar për shkak të gjynaheve të robit, pse e çoi në gjynah? A është kjo për shkak të ndonjë gjynahi të mëparshëm, e kështu deri në pafundësi, ose ajo vazhdimësi kryhet në gjynahin e parë që nuk ka shkakuar nga robi, sepse ashtu i është përcaktuar në ezel?

Për këtë kuptim flet hadithi ku Resulallahu, s.a.v.s., tregon: ***“Ademi dhe Musa a.s., po debatonin mes vete para Rabbit të tyre, dhe Ademi e mundi Musanë, a.s., e Musa tha:***

*- Ti je Ademi, të cilin Allahu Teala e krijoi me dorën e fuqisë së Tij e në të fryu nga Shpirti i Tij, i bëri melaiket të të bëjnë sexhde dhe të vendosi në xhennet, pastaj i zbriti të gjithë njerëzit në tokë për shkak të gabimit tënd.*

**Ademi a.s., i tha:**

*- E ti je Musa, të cilin Allahu Teala e zgjodhi Pejgamber, foli me ty, pastaj t'i dhuroi pllakat ku ishte shpjegimi për gjithçka dhe të afroi Vetes; ma thuaj, a e di ti sa vite para se të më krijonte mua Allahu Teala e kishte shkruar Tevratin?*

**Musa a.s., tha:**

*- E ka shkruar katërdhjetë vjet më parë.*

**Ademi a.s., e pyeti:**

- A ke parë që në Tevrat shkruan: **“Ademi u rebelua kundër Rabb-it të tij.”**?

**Musa a.s., pohoi, e Ademi a.s., tha:**

- E si do të më qortosh mua që kam vepruar diçka që Allahu Teala ma ka caktuar se do ta veprojë, katërdhjetë vjet para se të më krijojë?!”

E në fund, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

**“Kështu Ademi e mundi Musanë, a.s..”**<sup>69</sup>

Ai që e di se bapin e kësaj çështjeje, që e di fshehtësinë e kaderit përmes marifetit që shfaqet nga nuri i hidajetit, ai është arif, e ai që beson në këto vetëm duke i dëgjuar është besimtar i rëndomtë, e të dy bartin ndjenjën e frikës. Secili rob është në dorën e fuqisë së Allahut, ashtu si një fëmijë i dobët që bie në kthetrat e një luani. Të gjithë do të pajtohemi se mund të ndodhë që luani ta lëshojë fëmijën, por edhe mund ta bëjë copë-copë. Për neve, kjo është një sjellje e rastësishme.

Për këtë sjellje të rastësishme ka një numër se bapesh të ndërli dhura, por meqenëse ato se bape nuk njihen, kjo quhet *rastësi*. Mirëpo, në raport me diturinë e Allahut për ato se bape, kjo assesi nuk lejohet të quhet *rastësi*.

---

<sup>69</sup> Muslimi, nga Ebu Hurejre.

Sikur marifeti i atij fëmije të kapur në kthetrat e luanit të ketë arritur gradën e përsosmërisë, ai nuk do të ketë frikë nga luani, por do t'i frikësohet Atij që e krijoi luanin dhe që i krijoi cilësitë shkatërruese të luanit. Sepse luani është i nënshtruar fuqisë së Allahut; nëse Allahu i jep uri, ai do ta bëjë atë fëmijë copë-copë. Nuk po dua të them se të kesh frikë nga Allahu është si të kesh frikë nga luani por, siç do të kuptohet kur të hiqet perdja, frika është e njëjta, sepse në realitet, Allahu është Ai që shkatërron, përmes luanit. E dije mirë se edhe luanët e ahiretit janë si luanët e kësaj bote.

Ashtu siç Allahu Teala krijon sebepe për dënim dhe ato për shpërblim, si edhe njerëzit që i veprojnë ato sebepe. Caktimi i Allahut Teala në ezel për atë që do të ndodh (*kader*) kur vjen koha dhe vendi që të realizohet caktimi (*kaza*), e çon personin drejt asaj për çka është krijuar. Allahu Teala e krijoi xhennetin dhe i krijoi banorët e xhennetit, të cilët bëjnë vepra të cilat i dërgojnë në xhennet, deshën ata a jo. E krijoi edhe xhehenemin dhe i krijoi banorët e tij, të cilët bëjnë vepra të cilat i dërgojnë në xhehenem, deshën ata apo jo.

Ai që e sheh veten duke u përpëlitur mes valëve të kaderit, te ai domosdo do të mbizotërojë frika. Kjo është frika e arifëve, të cilët e kanë kuptuar fshehtësinë e kaderit.

E ai që nuk mund ta shohë hakikatin e kësaj çështje me zemër (*basiret*), duhet të përpiqet të shërohet me dëgjimin e haditheve dhe duke menduar për gjendjet dhe fjalët e arifëve dhe të atyre që kanë frikë. Dhe kur këtë e krahason me gjendjet e atyre që mashtrohen me shpresa, nuk do të ketë më asnjë dyshim se më mirë e ka të pasojë arifët. Sepse ata janë peygamberët, evliatë dhe dijetarët. E të sigurt ndjehen faraonët, injorantët dhe budallenjtë.

Peygamberi ynë, s.a.v.s., zotëruesi i të gjitha krijesave, ishte ai që i frikësohej më së shumti Allahut. Madje, sipas një transmetimi, gjatë faljes së namazit të xhenazes së një fëmije, Peygamberi, a.s., u lut:

***“O Allah, ruaje nga vuajtja e varrit dhe xhehenemit”.***<sup>70</sup>

Në një transmetim tjetër thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., e dëgjoi dikë duke thënë:

- *I lumi ti, ti je një prej zogjve e xhenetit*; e Resulallahu, s.a.v.s., u zemërua, e i tha:

***- Ku e di ti se ai është një prej zogjve të xhenetit?! Pasha Allahun, unë jam i dërguar i Tij, e nuk e di çfarë do të ndodh me mua! Vërtetë që Allahu Teala e krijoj xhenetin dhe i krijoj banorët e tij, dhe atyre askush nuk do t’ju shtohet, as nuk do të pakësohen!***<sup>71</sup>

---

<sup>70</sup> Taberani, nga Enesi, r.a..

<sup>71</sup> Muslimi, nga Ajshe, r.anha



Resulallahu, s.a.v.s., i tha të njëjtat fjalë edhe në xhenazen e Osman ibn Madh'un, që ishte një prej muhaxhirëve të parë, kur nëna e Osmanit tha:

*"Lumi ti! Ti do të shkosh në xhennet!"*

Më vonë nëna e Osmanit, Umu Seleme, ka treguar:

*- Pasha Allahun, pas Osmanit kurrë më për askënd nuk kam dëshmuar pafajësi!*

Muhammed ibn Havla el-Hanefi ka thënë:

*"Pasha Allahun, për askënd nuk do të pohoj pafajësi, as për babanë tim, pos për Resulallahun, s.a.v.s.."*

Transmetuesi tregon se shiatë u mërztën për këto fjalë, e el-Hanefi filloi të flasë edhe për virtytet e larta të Alisë r.a., dhe ta lavdërojë.

Sipas transmetimit, njëri që ishte ndër të parët që bëri hixhret me Resulallahun s.a.v.s., dhe ishte një nga *as'habi suffa* ra dëshmor në luftë, e nëna e tij tha:

*- I lumi ti. Ke bërë hixhret me Resulallahun s.a.v.s., e tash je shehid; ti fluturove në xhennet!,*

por Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

*- Ku e di ti? Ndoshta ka fol fjalë të padobishme ose ka ndaluar gjëra të padëmshme.*

Në një hadith tjetër thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., shkoi për të vizituar një nga shokët e tij, që ishte i sëmurë, dhe dëgjoi si një grua tha:

- *Xhenneti është gati për ty.* Resulallahu, s.a.v.s., pyeti:

- ***Kush është kjo zonja që shpërndan xhennetin në emër të Allahut?*** I sëmuri tregoi se është nëna e tij, e Resulallahu, s.a.v.s., i tha asaj:

- ***Nga e di ti! Ndoshta ka fol çka nuk i përket dhe ka mbajtur çka nuk i duhet.***

Si të mos ketë frikë besimtari kur Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

***“Suret Hud, Vakia, Tekvir dhe Nebe më kanë bërë të plakem”***<sup>72</sup>, e dijetarët kanë thënë se, si duket kjo është për shkakun që kjo sure flet për largim nga rahmeti i Allahut:

***“Qoftë larguar (nga mëshira e Allahut) fisi Ad, populli i Hudit!”*** 11-Hud: 60,

***“Qoftë larguar (nga mëshira e Allahut) fisi Themud!”***

11-Hud: 68,

***“Qoftë larguar (nga mëshira e Allahut) populli i Medjenit, siç qe larguar edhe fisi Themud!”*** 11-Hud: 95,

ndërsa Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: ***“Sikur të kishte dashur Allahu Teala, ata nuk do të bënin shirk.”***

---

<sup>72</sup> Tirmidhiu nga Ibn Abbas

E në suren Vakia, Allahu Teala thotë:

**“Ardhjen e saj askush nuk do ta mohojë.**

**Disa do t’i ulë e disa do t’i lartësojë.”** 56-Vakia: 2-3

Kjo do të thotë se çfarë do të ndodh është përcaktuar paraprakisht. Lapsi thau dhe ngjarja ka ndodhur; ose ata që në dynja ishin të lartësuar, do të poshtërohen, ose ata që në dynja ishin të poshtëruar, do të lartësohen.

Edhe surja Tekvir tregon për vështirësitë dhe pasojat e ditës së Gjykimit:

**“kur xhehenemi të flakërojë**

**dhe xhenneti të afrohet;**

**atëherë çdokush do të marrë vesh çfarë kishte përgatitur (për këtë Ditë).”** 81-Tekvir: 12-14

Ndërsa në suren Nebe, thuhet:

**“Ditën, kur njeriu do të shohë se ç’kanë bërë duart e tij...”** 78-Nebe: 40

**“...askush nuk flet pos atij që e lejon Mëshiruesi”**

78-Nebe: 38

Kur’ani Kerim nga fillimi deri në fund është i mbushur me atë që shkakton frikë dhe brengë për secilin që e lexon me kujdes dhe vëmendje. Edhe po të mos kishte asgjë tjetër, do të mjaftonte ky ajet:

**“Vërtet, Unë jam Falës për atë që pendohet, beson e bën vepra të mira dhe pastaj qëndron në rrugë të drejtë.”**

20-Ta Ha: 82

Pra, këtu falja është e lidhur me katër kushte, prej të cilave njeriu është i paaftë të përmbushë plotësisht qoftë edhe një të një prej tyre.

Edhe më të rreptë janë ajetet:

**“E për sa i përket atij që është penduar, që ka besuar dhe ka bërë vepra të mira, ai le të shpresojë se është nga të shpëtuarit.”** 28-Kasas: 67,

**“Për t'i marrë në pyetje këta të sinqertë për sinqeritetin e tyre.”** 33-Ahzab: 8,

**“Ne do të merremi me ju, o ju dy të rëndësishmit (njerëz dhe xhinë).”** 55-Rahman: 31,

**“A janë ata të sigurt në kurthin e Allahut?”** 7-Araf: 99,

**“Ja, kështu është ndëshkimi i Rabbit tënd, kur dënon vendet që janë zullumqare. Vërtet, ndëshkimi i Tij është i dhembshëm, e i ashpër.”** 11-Hud: 102,

**“Ditën kur do t'i tubojmë të devotshmit te i Gjithëmëshirshmi si mysafirë të ftuar.**

**Ndërsa gjynahqarëve u grahim në xhehenem të etshëm.”** 19-Merjem: 85-86,

**“Dhe nuk ka asnjë prej jush që të mos arrijë tek ai (xhehenemi).”** 19-Merjem: 71,

**“E ju pra veproni si të dëshironi.”** 41-Fusilet: 40,

**“Kush është që dëshiron fitimin e botës tjetër (ahiretit), Ne do t'ia shtojmë fitimin e tij”**

42-esh-Shura: 20,

**“E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.**

**Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë.”** 99-Zilzal: 7-8,

**“E Ne i kthehemi ndonjë vepre që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur.”** 25-Furkan: 23,

**“Pasha kohën!**

**Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.**

**Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”**

103-Asr: 1-3

Këto janë ato katër kushtet që, nëse plotësohen, mund të sjellin shpëtimin. Edhe pejgamberët a.s., e atyre iu dhanë pozitativat më të larta - prapë patën frikë dhe nuk ndiheshin të sigurt nga dënimi i Allahut, sepse nga dënimi i Allahut nuk frikësohet e ndihet i sigurt vetëm ai të cilin tashmë po e pret shkatërrimi.

Bile, e kemi treguar se edhe Resulallahu, s.a.v.s., dhe Xhebraili, a.s., qanë nga frika prej Allahut, prandaj Allahu Teala ju shpalli:

- ***Pse qani kur ju ruajta nga dënimi?!***, e ta thanë:
- ***O Rabb, e kush mund të jetë i sigurt nga dënimi Yt?!***

Ata e dinin mirë se Allahu Teala ua di të gjitha të fshehtat, e nuk kishin njohuri për përfundimin e vet, dhe me këtë, fjalët e Tij: ***"Ju ruajta nga dënimi"*** i morën si sprovë që - nëse me këtë ju qetësohen zemrat e ju humbet frika, mund të mendojnë se janë mbrojtur nga dënimi.

Kur e vendosën Ibrahimin a.s., në katapultë, ai tha: ***"Më mjafton Allahu"***, e derisa po e hidhnin në zjarr, Xhebraili i erdhi dhe e pyeti:

- ***A ke nevojë për mua?***, e Ibrahim, a.s., u përgjigj:
- ***Nuk kam nevojë për ty!***

Me këtë përgjigje, Ibrahim a.s., tregoi besnikëri ndaj fjalës që e tha: ***"Më mjafton Allahu"***.

Zaten, "më mjafton Allahu" është dua e madhe... Për këtë njofton Allahu Teala:

**"Dhe të Ibrahimit - i cili i plotësoi detyrimet."**

53-Nexhm: 37

Allahu Teala lajmëron edhe për Musanë, a.s.:

**"Ata të dy thanë: "Rabbi ynë, kemi frikë se do të na ndëshkojë menjëherë ose t'i kalojë kufijtë kundër nesh".**

**Ai (Allahu) tha: "Mos u frikësoni, se Unë (me ndihmën Time) jam me ju, dëgjoj (ç'do t'ju thotë) dhe shoh (ç'do të bëjë me ju)".**" 20-Ta Ha: 45-46

E përkundër kësaj, kur magjistarët hodhën magjinë, Musa a.s., ndjeu frikë në vete, sepse nuk ishte i sigurt nga dënimi i Allahut. Prandaj Allahu Teala përsëri e qetësoi:

**"Mos u frikëso, se, në të vërtetë, ti do të fitosh!"**

20-Ta Ha: 68

Kur morali i muslimanëve në betejën e Bedrit u dobësua, e Resulallahu, s.a.v.s., bëri dua:

**"O Allahu im! Nëse ky grup shkatërrohet, nuk do të mbetet askush në sipërfaqen e tokës që të bën ibadet Ty",**

Ebu Bekr i tha:

- *Nuk ka nevojë për dua, mjafton ajo që të premtoi Allahu.*<sup>73</sup>

---

<sup>73</sup> Buhari, nga Ibn Abbas.

Grada e Ebu Bekrit ishte grada e besimit në premtimin e Allahut. Grada e Resulallahut, s.a.v.s., është grada e frikës nga dënimi i Allahut. Nuk ka dyshim se grada e Resulallahut, s.a.v.s., është më e përsosur se grada e Ebu Bekrit. Sepse grada e frikës nga dënimi i Allahut mund të vijë vetëm nga njohja e veprave të fshehta të Allahut dhe kuptimeve të cilësive të Tij që sjellin përfundime të caktuara. Ai që e di se është i paaftë të dijë gjithçka ashtu siç është, frika e tij domosdo forcohet. Në këtë kuptim janë edhe këto ajete për Isanë, a.s.:

***“Dhe kur Allahu tha: "O Isa, bir i Merjemes, a ti njerëzve u the: "Adhuromëni mua dhe nënën time si zota krahas Allahut"? (Isai) tha: "Larg asaj të mete je Ti (o Rabbi im). Nuk më takon mua ta them atë që s'është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, ti do ta dije. Ti e di çka ka në mua, e unë nuk di çka ka në Ty. Ti je më i dijsmi i të fshehtave!"*** 5-Maide: 116, dhe ajeti:

***“Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robër Tu, e nëse u falë atyre, Ti je i gjithëfuqishmi, i Urti.”***

5-Maide: 118

Isa a.s., të gjitha ia dorëzoi Allahut e veten e largoi; sepse e dinte se nuk kishte asgjë në duart e tij, se gjithçka varet nga vullneti i Allahut dhe se kjo nuk mund të kuptohet me logjikë e as të vlerësohet me analogji, e lëre më të gjykohet me bindje e plotë.



Kjo është gjendja që ua copëton zemrat arifëve, sepse dita e madhe e Gjykimit është në dorën e Allahut Teala, i Cili do t'i dënojë përhershëm shumë njerëz që në këtë botë i mbushën zemrat me sëmundje të ndryshme, me mosbesim e përçarje, prandaj nëse edhe ty të dënon, nuk i jep ndonjë rëndësi. Dhe na njofton për këtë:

**“Sikur Ne të donim, do t’ia jepnim secilit udhëzimin e tij, por do të përmbushet Fjala Ime: *“Me të vërtetë që do ta mbush xhehenemin me xhinde dhe njerëz bashkërisht!”***

32-Sexhde: 13

**“Do të plotësohet Fjala e Rabbit tënd: *“Me të vërtetë që do ta mbush Xhehenemin me xhinde dhe njerëz bashkërisht!”*** 11-Hud: 119

E si njeriu të mos i frikësohet asaj që është përcaktuar në ezel dhe si nuk përgatitet për këtë? Sikur të ishte vendimi i qartë, edhe mund të kërkohej zgjidhje, por në rastin tonë nuk ka zgjidhje tjetër përveç dorëzimit dhe kërkimit të së fshehtës që është caktuar në ezel në sebepe të dukshme, e që shfaqen sot, në gjymtyrë dhe zemër. Atij që i lehtësohen sebetet e së keqes, i mbyllen dyert e mirësisë dhe i forcohen lidhjet me dynjanë, ai mund ta kuptojë me siguri dhe lehtësi se kaderi i tij është gjynahqar. Sepse të gjithë i drejtohen qëllimit për të cilin janë krijuar.

Për ata që u janë hapur dyert e mirësisë, lidhjet e zemrave të tyre me dynjanë u janë këputur, dhe që i janë drejtuar plotësisht Allahut, me të dukshmen dhe të fshehtën e tyre; sikur ata ta dinin me siguri se çfarë do të ndodhë më pas, kjo mund të ju ndihmojë të zvogëlojnë frikën e tyre. Por, rreziku i përfundimit dhe vështirësia për të qëndruar në këtë gjendje e shton zjarrin e frikës dhe është e pamundur ta shuash atë zjarr. Pra si mund të jetë njeriu i sigurt që gjendja e tij nuk do të ndryshojë duke qenë se zemrën e ka në mes të dy gishtave të Allahut Teala, e zemra rrotullohet më shumë se uji që vlon, Allahu Teala, Ai i cili i rrotullon zemrat, thotë:

**“Vërtet që askush nuk është i sigurt prej dënimit të Rabbit të vet.”** 70-Mearixh: 28

Më i padituri nga njerëzit është ai të cilit i thuhet: *“Ruaje veten, nuk je i sigurt nga dënimi i Allahut!”*, e ai vazhdon të ndjehet i mbrojtur nga dënimi i Allahut.

Po të mos ishte Allahu i mëshirshëm ndaj arifëve e po të mos ua kishte rehatuar zemrat me shpresë, zemrat e tyre do të digjeshin nga zjarri i frikës. Pra, ashtu siç është mëshira e Allahut Teala ndaj robërve të Tij të veçantë sebeb i shpresës, edhe sebebpet e gafletit janë një mëshirë për njerëzit e rëndomtë.

Sepse sikur të largohesh për djathtë dhe të zbulohesh e vërteta për të gjithë ashtu siç është, zemrat do të copëtoheshin nga frika prej Allahut Teala, i Cili i rrotullon zemrat si të dëshirojë Ai.

Njëri prej arifëve ka thënë: *“Sikur vetëm për një moment të vendoset një perde mes meje dhe personit që e njoh si muvahhid prej pesëdhjetë vjetësh, dhe ai vdes pa e parë në atë moment - nuk do të mund të gjykoj se ai ishte muvahhid. Sepse nuk e di se çfarë ndryshimesh ka kaluar zemra e tij në atë moment”*.

E dikush ka thënë: *“Sikur ta dija se do të vdes si musliman duke qëndruar para derës së dhomës sime, por mund të vdes si shehid nëse shkoj te dera e shtëpisë, unë do të preferoja të parën. Sepse nuk e di se çfarë mund të më ndodhë me zemrën derisa të arrij te dera e shtëpisë”*.

Ebu Derda betohej në Allahun se, kushdo që është i sigurt se të vdesë me iman në frymën e fundit, vdes pa iman.

Sehl ka thënë: *“Në secilin mendim dhe në secilën lëvizje, të sinqertit frikësohen se do të vdesin pa iman në frymën e fundit. Për ta janë fjalët e Allahut Teala:*

***“Zemrat e tyre i kanë plot frikë.”*** (23-Muminun: 60)

Kur Sufjan Sevri ishte në shtrat të vdekjes, qante me zë, e njerëzit përreth i thanë:

- *O Ebu Abdullah! Mos e humb shpresën në rahmetin e Allahut. Falja e Tij është më e madhe se gjynahet tua!*, e Sufjani ju tha:

- *Nuk po qaj për gjynahet e mia, po qaj për imanin tim. Sikur ta dija se vdes me iman, nuk do të më interesonin gjynahet e mia, edhe sikur të ishin sa malet.*

Tregohet se njëri prej atyre që i frikësohen Allahut e këshilloi vëllain e vet:

*“Kur të më vijë vdekja, ulu te koka ime dhe nëse sheh se vdes me iman, merre të gjithë pasurinë time, me to blej bademe e sheqerka dhe shpërndaju të gjitha fëmijëve në qytet, e thuaju se kjo është për gëzimin e atij që ka shpëtuar. E nëse vdes pa iman, atëherë për këtë lajmëroi të gjithë, që të mos mashtrohen e të ma përcjellin xhenazen. Në varrim le të më vijë vetëm ai që vërtetë dëshiron, që të mos jem dyfytyrësh edhe pas vdekjes.”* Vëllai e pyeti:

- *E nga ta di unë se të ka ardhur vdekja?*, e ky i tregoi se çka do të jetë shenja, dhe kur vdiq dhe vëllai e pa shenjën, ia shiti pasurinë, bleu bademe e sheqerka dhe të gjitha ua shpërndau fëmijëve.

Sehl e kishte zakon të thoshte: *“Muridi frikësohet mos po sprovohet me gjynahe, e arifi frikësohet mos po sprovohet me kufr.”*

Ebu Jezid Bistami ka thënë:

*“Kur nisem për në xhami, më duket sikur në vete kam të lidhur një litar, dhe frikësohem mos po më tërheq në pazar e në kishë, deri sa të hyj në xhami, e atëherë, ai litar sikur hiqet nga unë. Kështu më ndodh çdo ditë, nga pesë herë.”*

Tregohet se Isa, a.s., ka thënë:

*“O Havarijjët e mi! Ju i frikësoheni gjynahit, e ne, pejgamberët, i frikësohemi kufrit.”*

Në tregimet për pejgamberët thuhet se një pejgamber (a.s.) iu ankua Allahut se është i uritur, pluhurosur e pa rroba, për shumë vite, fustani që kishte veshur ishte prej leshi, e Allahu Teala i shpalli:

***- O rob i im, a nuk je i kënaqur që ta kam mbrojtur zemrën nga kufri, e tash po më kërkon të mira të dynjallëkut?***

Pejgamberi mori dhé, e hodhi mbi kokë, e tha:

*- Jam i kënaqur, o Rabbi im! Më mbroj nga kufri!*

Nëse arifët, me imanin e tyre të fortë kaq shumë i frikësoheshin frymës së fundit, si mund të mos kenë frikë ata me iman më të dobët?

Ka shumë sebepe të vdekjes pa iman në frymën e fundit siç janë bidati, dyfytyrësia, mendjemadhësia dhe cilësi tjera të këqija e të qortuara. Prandaj as’habët kishin aq shumë frikë nga dyfytyrësia. Bile Hasan Basri ka thënë: *“Sikur ta dija me bindje të plotë se në mua nuk ka dyfytyrësi, kjo do të më ishte më e dashur se gjithçka që Dielli e ndriçon.”*

Natyrisht që kjo dyfytyrësi nuk është e kundërt me imanin, por është dyfytyrësia bashkë me imanin, pra dikush mund të jetë edhe musliman edhe dyfytyrësh, dhe kjo dyfytyrësi ka shumë shenja, që na i ka treguar Resulallahu s.a.v.s.: **“Kush i ka këto katër, ai është vërtetë hipokrit (*munafik*), edhe nëse agjëron, falë namaz dhe thotë që është mumin: kur flet - gënjen, kur premtion - nuk e përmbush premtimin, kur diçka i besohet - mashtron, kur hasmohet - e tepron”,** e në disa rivajete thuhet edhe:

**“...kur zotohet, tradhton.”<sup>74</sup>**

As’habët dhe taibinët e interpretonin dyfytyrësinë shumë gjerësisht, sa që vetëm besimtarët e sigurtë – *sidik* - mund të shpëtonin prej saj.

---

<sup>74</sup> Muttefekun alejhi, nga Abdullah ibn Amr, e është përmendur në *Librin për themelet e besimit*.

Hasan Basriu ka thënë: *“Nëse gjendja e brendshme dhe e jashtme personit janë të ndryshme, nëse gjuha dhe zemra e tij janë të ndryshme, nëse ardhja dhe shkuarja e tij nuk janë të njëjta, kjo është dyfytyrësi.”*

Kush mund të mbrohet nga të gjitha këto? Bile, kjo te njerëzit është bërë normale dhe adet, e plotësisht është harruar që kjo është gjynah. Kjo gjendje ndodhi menjëherë pas kohës së peygamberllëkut, e mendoni se çfarë po ndodh në kohën tonë! Bile Huzejfe, r.a., ka thënë: *“Në kohën e Resulallahut, s.a.v.s., dikush për një fjalë llogaritej dyfytyrësh, e sot atë fjalë e dëgjoj prej jush edhe nga dhjetë herë në ditë.”*

As’habët e Resulallahut, s.a.v.s., thoshin: *“Ju sot bëni disa vepra të tilla që, nuk jepni rëndësi aq sa një fije floku, e në kohën e Resulallahut, s.a.v.s., ato vepra i konsideronim gjynahe të mëdha.”*

Dikush ka thënë: *“Kur ti bën një punë të njëjtë si dikush tjetër, por ti punën e tij nuk e sheh të denjë, kjo është shenjë e dyfytyrësisë, e dyfytyrësi është edhe kur të pëlqen qoftë edhe pak padrejtësia, ose e urren qoftë edhe pak të vërtetën.”*

E dikush tjetër ka thënë: *“Dyfytyrësi është edhe kur të lavdërojnë për një cilësi që nuk e ke, e ty të pëlqen.”*

Një person i tha Ibn Omerit: *“Ne kur shkojmë te pushtetarët, e konfirmojmë atë që ata thonë, por kur largohemi flasim kundër tyre. , e Ibn Omeri i tha:*

*- Në kohën e Resulallahut, s.a.v.s., ne këtë e konsideronim shenjë të dyfytërisë.*

Sipas transmetimit, Ibn Omeri dëgjoi një person duke folur kundër Haxhaxhit dhe i tha:

*- Po të ishte Haxhaxhi këtu, a do të flisje kështu? Ky u përgjigj se jo, e Ibn Omeri i tha:*

*- Në kohën e Resulallahut, s.a.v.s., ne këtë e llogarisnim dyfytërisë.*

Edhe më i ashpër është transmetimi ku tregohet se disa njerëz ishin ulur te dera e Huzejfes dhe, sa po prisnin te dera, folën diçka për Huzejfien. Kur Huzejfe doli, ata heshtën, e ky ju tha:

*- Vazhdoni. Ata vazhduan të heshtin, e Huzejfe ju tha:*

*- Në kohën e Resulallahut, s.a.v.s., ne këtë e konsideronim si shenjë të dyfytërisë. Ky ishte Huzejfe, që shumë mirë e njihte dyfytërisin dhe cilësitë e saj. Dhe thoshte: “Do të vijë një kohë kur zemra e njeriut do të jetë aq e mbushur me iman, sa nuk do të ketë vend për dyfytërisë, qoftë edhe sa maja e një gjilpëre. Do të vijë një kohë kur zemra e njeriut do të mbushet me dyfytërisë aq shumë sa nuk do të ketë vend për iman, qoftë edhe sa maja e një gjilpëre.”*



Nga ky shpjegim i joni e kuptove se arifët kanë frikë të mos vdesin pa iman në frymën e fundit, dhe se sebeper për këtë janë gjëra që kanë ndodhur para vdekjes - bidatet, gjynahet e dyfytyrësia. Cili rob mund të jetë i pastër nga këto? Edhe kur është i bindur se është pastruar, ai është dyfytyrësh, sepse është thënë:

*“Kush mendon se është i pastër nga dyfytyrësia, ai është dyfytyrësh.”*

Dikush i tha një arifi:

- *Kam shumë frikë nga dyfytyrësia!, e ky arifi i tha:*
- *Po të ishe dyfytyrësh, nuk do të kishe frikë nga dyfytyrësia.*

Arifi vazhdimisht rrotullohet mes kaderit të tij dhe frymës së tij të fundit, dhe ka frikë nga të dyja.

Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Besimtari është mes dy frikash. Njëra është nga e kaluara e tij; ai nuk e di se çfarë ka bërë Allahu Teala me të kaluarën e tij, e tjetra është për të ardhmen - nuk e di se çfarë ka caktuar Allahu Teala për të. Pasha Atë që në dorën e Tij është shpirti im, pas vdekjes nuk ka ankesë apo pëlqim, e as pas dynjasë nuk ka vendqëndrim tjetër pos xhennet ose xhehenem.”<sup>75</sup>***

---

<sup>75</sup> Bejheki, nga Hasani

## KUPTIMI I PËRFUNDIMIT TË KEQ

Nëse thua se frika e të gjithë këtyre kryesisht është nga përfundimi i keq; atëherë, çka është përfundim i keq?;

Dije se përfundimi i keq i ka dy grada, ku njëra është më e lartë dhe më e rrezikshme se tjetra. Grada më e lartë dhe më e rrezikshme është kur dyshimi ose mohimi mbizotëron në zemër në kohën e mundimeve të vdekjes dhe kur shfaqen tmerret e vdekjes, e shpirti i merret në gjendje kur ato dominojnë, e më pas mohimi që ia dominoi zemrën bëhet perde e përhershme mes tij dhe Allahut Teala, sepse kufri dhe mohimi janë sebeb për vuajtje të përhershme.

Grada e dytë është më e padëmshme; kur në momentin e vdekjes, diçka nga dynjaja dhe kënaqësitë e saj e pushtojnë zemrën, dhe ti mendon për të e kjo ta mbulon aq shumë zemrën sa aty nuk mbetet vend për asgjë tjetër. Nëse vdes në këtë gjendje, vdes me zemrën tërësisht të kthyer kah dynjaja dhe me dashuri për dynja, e kur zemra të largohet nga Allahu, në mes vendoset një perde. Kur vendoset perdja, fillon vuajtja. Zjarri që ka nderur Allahu i arrin zemrat që janë larguar nga Ai. E zemrës të cilën besimtari e ka ruajtur nga dashuria e kësaj bote dhe është kthyer kah Allahu, Zjarri i thotë:

- *Kalo, o besimtar! Sepse nuri yt ma shuan zjarrin!*

Është e rrezikshme për njeriun të japë shpirt në gjendje kur në zemër i mbizotëron dashuria ndaj dynjallëkut. Sepse njeriu vdes ashtu siç ka jetuar; nuk është e mundur që zemra të marrë një gjendje tjetër pas vdekjes. Sepse gjendja e zemrës mund të ndryshohet vetëm me veprime, e me vdekje veprimet pamundësohen; i vdekuri nuk mund të bëjë asgjë, e as nuk është në gjendje të kthehet në këtë botë që ta kompensojë atë që i ka ikur; dhe atëherë pason dëshpërimi i madh.

Por nëse imani dhe dashuria ndaj Allahut janë për një kohë të gjatë fuqishëm të rrënjosura në zemër, dhe nëse këtë e vërtetojnë veprat e mira, kjo do të krijojë gjendjen e personit e cila shfaqet në zemër në momentin e vdekjes. Nëse imani i tij është sa një kokërr, ai do të nxirret shpejt nga xhehenemi; nëse imani i tij është më i vogël, ai do të qëndrojë më gjatë në xhehenem, e nëse në zemër ka qoftë edhe një grimcë iman, edhe kjo sigurisht se do ta nxjerrë nga xhehenemi, qoftë edhe pas mijëra vjetësh.

Nëse thua, *Sipas shpjegimit tënd, njeriu pas vdekjes duhet të shkojë menjëherë në xhehenem, pse atëherë Allahu ia vonon atij dënimin deri në ditën e Gjykimit dhe i jep atij një afat të gjatë?*;

Dije se, kushdo që mohon vuajtjen në varr është bidatxhi dhe i privuar nga nuri i Allahut, nga nuri i Kur'anit dhe nga nuri i imanit. Gjykimi i shëndoshë sipas atyre me largpamësi – *basiret* – është ajo që vërtetohet me hadithe, se:

***“Varri është ose një gropë e xhehenemit ose një bahçe e xhennetit,”***

dhe se:

***“Në varrin e atij që vuan në varr do të hapen shtatëdhjetë dyer të xhehenemit.”***

Nëse në frymën e fundit përfundimi është i keq, ai do të përballet me telashe sapo të vdesë. Dënimet dallojnë sipas kohëve. Kur vendoset në varr, melaiKET Munkir dhe Nekir e pyesin, e pas kësaj vjen vuajtja në varr. Më pas vjen llogaridhënia në ditën e Gjykimit dhe turpërimi para njerëzve, pas kësaj rreziku i Siratit, e pastaj tmerret e Zebanit, e hadithet flasin edhe për të tjerat. Kjo do të thotë se gjynahqari përballet në çdo moment me dënime dhe vuajtje të ndryshme, përveç nëse Allahu e mëshiron me rahmetin e Tij.

Assesi mos mendo se dheu e ha vendin e imanit, dheu i ha vetëm pjesët e trupit. Kur vjen koha e premtuar, pjesët e trupit ribashkohen dhe shpirti kthehet në trup.

Shpirtat e lumtur prej momentit të vdekjes e deri në ringjallje janë në krahë të zogjve të gjelbër të varur nën Arsh, e gjendja e shpirtave kryengritës është e kundërta e kësaj, Allahu na ruajt!

Nëse pyet se çka është sebepe i përfundimit të keq; dije se ka shumë sebepe, e që nuk mund të shpjegohen në detaje. Megjithatë, është e mundur të theksohen këto në mënyrë të përmbledhur.

Ne themi se janë dy sebepe të vdekjes në dyshim dhe mohim:

**Sebepe i parë** mund të mendohet së bashku me zuhd, devotshmërinë dhe veprat e mira. Për shembull, është zahid, por është edhe bidatxhi, dhe përfundimi i tij është shumë i rrezikshëm, edhe nëse veprat i ka të mira. Kur them *bidat* nuk e kam fjalën për ndonjë xhemat që janë bidatxhi, sepse shpjegimi i kësaj shkon shumë gjatë, por po flasim për rastin kur personi beson në atë që nuk përputhet me të vërtetën e Qenies (Dhat) të Allahut, cilësitë e Tij dhe veprat e Tij, dhe përpiqet të argumentojë të kundërtën. Ky bidat i vjen si pasojë e të menduarit dhe qëndrimit të vet me të cilin i kundërvihet të tjerëve, në çka ai është i bindur dhe me çka është verbëruar; ose është pasojë e pasimit të dikujt që promovon aso qëndrimi a besimi.

Kur vdekja t'i afrohet dhe ky vetëdijesohet për prezencën e melekut të vdekjes, kur zemra të tronditet për shkak të asaj që ka në vete, ndoshta në ato momente të vdekjes i shfaqet pasaktësia e bindjes së tij në të cilën ka besuar nga padija, sepse në ato momente të vdekjes hiqet perdja.

Meqenëse edhe dhembjet e vdekjes janë fillimi i vdekjes, disa gjëra ndoshta edhe i zbulohen (*keshf*) në ato momente. Kur kupton se ajo që e ka besuar duke u mbështetur në mendimin e vet, e ishte i bindur në saktësinë e saj - është boshe dhe pathemeltë, ai mendon se gjithçka në të cilën ka besuar nuk është e vërtetë. Sepse ai nuk sheh dallim në mes të besimit në Allahun, të Dërguarin e Tij a.s., të vërtetave tjera të fesë dhe besimit të tij të gabuar. Nëse në momentin e frymës së fundit personi është në këso gjendje e nuk i kthehet besimit të drejtë, atëherë ai ka përfunduar keq, dhe shpirti i tij është larguar derisa ky ishte mushrik, Allahu na ruajt! Për ta flet ajeti:

**“Atyre do t’u prezantohet nga Allahu çka nuk mund ta marrin me mend.”** 39-Zumer 47, si edhe ajetet:

**“Thuaj: “A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti humbasin nga punët e veta,**

**për ata, përpyekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënë vepra të mira?”** 18-Kehf: 103-104

Siç mund të ndodh që njeriut të pangarkuar me punët e kësaj bote në ëndërr t'i shfaqet (*keshf*) ajo çka do të ndodh në të ardhmen, njëjtë edhe në mundimet e vdekjes mund t'i shfaqen disa të vërteta. Sepse punët e kësaj bote dhe epshet e trupit ia pengojnë zemrën të shikojë botën e melekutit dhe të shohë aty gjërat ashtu siç janë. Megjithatë, siç bëhet shfaqja (*keshf*) në momentin e vdekjes sepse për ta kuptuar gjërat ashtu siç janë, ajo (*keshfi*) mund të bëhet sepse edhe për ta kuptuar besimin e vet të gabuar. Kushdo që ka një besim të gabuar për Qenien (Dhat), Cilësitë dhe Veprimet e Allahut Teala, qoftë përmes mendimit të vet apo imitimit, përballet me këtë rrezik. Vetëm *zuhdi* dhe *mirësia* nuk mjaftojnë për të parandaluar këtë. Nga ky rrezik njeriun mund ta shpëtojë vetëm besimi i drejtë i bazuar në të vërtetën. Nga ky rrezik janë të mbrojtur njerëzit *naiv* – *qëllimmirë*, e me këtë po mendoj në ata që përgjithësisht dhe fuqishëm besojnë në Allahun Teala, besojnë në të dërguarit e Tij dhe në ditën e Gjykimit, si për shembull beduinët dhe populli i rëndomtë. Ata nuk përfshihen në debate për këto çështje, as nuk sjellin gjykime të veta në besim, as nuk përpiqen të imitojnë deklarata të ndryshme të kelamistëve. Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Shumica e njerëzve të xhennetit janë njerëz naiv (qëllimmirë).”***<sup>76</sup>

---

<sup>76</sup> Bezar, nga Enesi, e është përmendur më parë.

E për këtë arsye, Selefët e ndaluan zhytjen në dituri të kelamit dhe hulumtimet dhe urdhëruan besimin e plotë në atë që kishte zbritur nga Allahu Teala, të besohet në gjithçka që ka sjellë Resulallahu s.a.v.s., të mos krahasohet Allahu me asgjë, dhe të mos zhytet në komentime. Sepse në hulumtim të cilësive të Allahut ka rrezik të madh e pengesa të shumta; janë rrugë vështirë të kalueshme e mendjet nuk janë në gjendje të arrijnë Madhështinë e Allahut. Udhëzimi i Allahut me nurin e jekinit është i fshehur nga zemrat e kthyer kah dashuria për dynjanë, e ajo çfarë thonë hulumtuesit sipas mendjes së tyre janë të dyshimta dhe kundërshtojnë njëra-tjetrën. Zemrat së pari lidhen me fanatizëm për atë që dëgjojnë nga mësuesit e tyre. Pastaj angazhohen me dashurinë e kësaj bote dhe kthehen kah dynjaja. Epshtet e kërkesat ua ngushtojnë fytyrën dhe ju pamundësojnë mendimin e drejtë. Kur mes njerëzve hapen biseda për Allahun dhe cilësitë e Tij, mendimet e tyre ndryshojnë dhe secili xhahil fillon të pohojë se është i përkryer dhe se e ka kuptuar hakkun, e gjuhët e tyre fillojnë të flasin për përvoja personale që ju përshtaten zemrave të dëgjuesve, Kjo gjendje rrënjësohet tek ata për shkak të lidhjes së tyre të gjatë me të, dhe kështu rruga e shpëtimit ju mbyllet atyre plotësisht. Prandaj shpëtimi i njerëzve të rëndomtë është në veprime të mira dhe largim nga gjithçka që tejkalon mundësitë e tyre.



E sot, freri është lënë i lirë dhe llomotitja është përhapur gjithkah. Secili xhahil beson se ajo që i përshtatet mendimit të tij është dituri dhe iman i vërtetë, e ai mendon se përvojat dhe parashikimet e tij janë të vërteta. Por ata shpejt do ta kuptojnë të vërtetën. Kur të hiqet perdja, atyre mund t'i kushtohen këto vargje:

***Ti mendon se ditët janë të mira,  
sepse ti ashtu i sheh.  
Dhe nuk ke frikë nga e keqja  
që do të vjen me kader.  
Netët të sollën qetësinë, e po të mashtrojnë.  
por kur terri të zbardhet, hidhërimet do të fillojnë.***

Të jesh i sigurt se kushdo që largohet nga besimi i vërtetë, në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, dhe zhytet në debatime për këtë çështje, do të përballet me këto rreziqe. Një person që përfshihet në debate të tilla për Qenien (Dhat), Cilësitë dhe Veprimet e Allahut Teala, është si personi të cilit i dëmtohet barka në mes të detit dhe ai bie në prehrin e dallgëve. Ato dallgë edhe mund ta hedhin personin në bregun e shpëtimit, por kjo është pak e besueshme; dhe ato vazhdojnë ta hedhin në prehrin e njëra-tjetrës dhe më e besueshme është se do të mbytet në to.

Kushdo që i mbahet besimit që rrjedh nga mendjet e shkurtra të hulumtuesve, qoftë me dëshmi që ata më herët i kanë shënuar, ose pa dëshmi, besimi i tij është i prishur. Ai që ju beson plotësisht këtyre dhe lidhet me ta, ai u mashtrua nga shkurtpamësia e vet dhe mendon se ka shpëtuar nga dënimi i Allahut..

Pra, kjo është gjendja e atyre që debatojnë vetëm nga mendja e vet. Por, nëse ai mund të kalojë në nurin e shfaqjes që shkëlqen në botën e pejgamberllëkut dhe vilajetit, atëherë ai do ta gjejë të vërtetën, mirëpo arritja në këtë gradë kjo ndodh rrallë. Nga ky rrezik mund të shpëtojnë ata që janë naiv – qëllimmirë nga njerëzit e rëndomtë, që i frikësohen dënimit të Allahut, që merren me ibadet dhe që nuk zhyten në punë të panevojshme.

Pra, ky është një nga sebetet e rrezikshme që dërgojnë në përfundim të keq.

**Sebepi i dytë** është dobësia e imanit dhe preokupimi i zemrës me dashurinë për dynjallëk. Sa herë që imani dobësohet, edhe dashuria ndaj Allahut dobësohet e dashuria për dynjallëk aq shumë forcohet sa që nuk mbetet vend për dashuri ndaj Allahut, përpos fjalëve të kota, që nuk lënë ndonjë gjurmë të dukshme në luftim të dëshirave të nefsit dhe braktisje të rrugës së shejtanit.

Këso gjendje e zhytë njeriun gjithnjë e më thellë në epshe, ashtu që zemra errësohet dhe ngurtësohet. Mizoritë e nefsit grumbullohen në zemër dhe e shuajnë plotësisht nurin e imanit në zemër, edhe ashtu të dobët. Tani kjo bëhet natyrë e personit. E kur të vijnë vuajtjet e vdekjes, dashuria ndaj Allahut edhe më shumë dobësohet. Sepse ai largohet nga jeta e kësaj bote, e cila është dashuria e tij më e madhe, dhe ndjen dhimbjen e këtij largimi. Për shkak se e di se largimi nga dynjaja është caktim i Allahut, në vetëdije i lajmërohet përbuzje ndaj vdekjes vetëm për faktin se kjo është prej Allahut. Në atë rast është e mundur që te ai, në vend të dashurisë të lajmërohet urrejtje për Allahun Teala, si në rastin e babait i cili pak e do fëmijën e vet, e nëse fëmija ia merr pronën që ky e ka më të dashur se atë fëmijë, dhe ia shkatërron, ajo dashuri e dobët ndaj fëmijës i shndërrohet në armiqësi. Nëse personi vdes në këtë gjendje, ai vdes me përfundimi të keq dhe mbetet në shkatërrim të përjetshëm, e ajo që çon në këso përfundimi është dashuria e madhe për dynjallëk, animi kah dynjaja dhe gëzimi i tij me dynjanë, e kjo për shkak të imanit të dobët që shkakton dobësim të dashurisë për Allahun. Ai që në zemër të vet kultivon dashurinë për Allahun Teala, e cila është më e fortë se dashuria për dynjallëk, i tilli është larg nga këso rreziku dhe kërcënimi.

Dashuria për dynjanë është *koka* e të gjitha gjynaheve; është një sëmundje kronike. Fatkeqësisht, mosnjohja e Allahut është përhapur tek njerëzit, sepse ai që e njeh Allahun do ta dojë Allahun. Prandaj vet Allahu Teala thotë:

***“Thuaj: “Nëse baballarët tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin e Tij.”***

9-Teube: 24

Kjo do të thotë se vdekja e një personi që mendon për një mohim të tillë në momentin e vdekjes dhe i cili është i zemëruar për shkak se Allahu Teala e ka ndarë nga familja e tij, pasuria dhe nga gjëra të tjera të kësaj bote, për atë person kjo është sikur të shkosh tek ajo që nuk e do dhe të ndahesh nga ajo që e do. Gjendja e tij është si gjendja e një skllavi që nuk e do zotërinë e tij dhe ikë nga ai, por kapet me forcë dhe sjellët para zotërisë së vet, e dihet çfarë turpi dhe dënimi pason. Por, ai që vdes me dashuri është si një skllav i mirë që do sinqerisht zotërinë e tij dhe që me mall ka pritë takimin me të. Atij i mjafton gëzimi dhe kënaqësia e madhe e takimit me zotërinë e vet, por ai do të pranojë edhe shumë shpërblime tjera nga zotëria i tij.

Ky përfundimi i dytë është më pak i dëmshëm se i pari. Sepse kjo gjendje nuk nënkupton që ai do të qëndrojë përgjithmonë në xhehenem. Dhe ka dy sebepe për këtë: sebepi i parë është imani i fortë, por gjynahet e shumta, e sebepi i dytë është imani i dobët, por me pak gjynahe. Sepse sebep i bërjes së gjynahit është kur epshi mbizotëron dhe vendoset në zemër për shkak të adetit dhe të mësuarit me gjynah gjatë jetës.

Çdo gjë që njeriu do gjatë jetës së tij, ai do ta kujtojë në momentin e vdekjes. Nëse prirja e tij është më shumë për ibadetet, në momentin e vdekjes kjo i vjen në mendje. Por, nëse prirja e tij është më shumë për gjynahe, kujtimi i gjynaheve mbizotëron në zemër në momentin e vdekjes. Në të shumtën e rasteve, kur është duke vdekur, ai preokupohet me epshet dhe gjynahet e kësaj bote dhe kështu turpërohet para Allahut. Ai që bën gjynah rrallë është larg nga rreziku, e ai që nuk bën gjynahe fare është i shpëtuar. Ai te i cili gjynahet e tij janë më të shumta se ibadetet e tij, dhe ai me këtë gjendje është i kënaqur, atëherë ky është në rrezik të madh. Le ta shpjegojmë këtë me një shembull:

Dihet se njeriu sheh në ëndërr atë me çka angazhohet gjatë ditës. Bile, ai edhe mund të shohë në ëndërr vetëm atë që i ndërlidhet me gjërat që i sheh kur është zgjuar dhe që i ka në zemër.

Kur një i ri që sapo ka arritur moshën e pubertetit ejakulon në ëndërr, mënyra e prekjes sa ishte zgjuar i bëhet sebeb për të menduar për këtë. Shkencëtari, zakonisht sheh në ëndërr gjëra nga shkenca, e tregtari gjëra nga tregtia.

Edhe vdekja është e ngjashme me gjumin, por vdekja është më e rëndë se gjumi, derisa mundimet e vdekjes janë më afër gjumit, e kjo nënkupton se personi mbanë në mend atë që i është bërë e zakonshme në jetën e tij dhe që e ka pasur shpesh në zemër, e një prej sebepeve pse diçka dominon në zemër është kohëzgjatja e angazhimit në të. Prandaj edhe kohëzgjatja e bërjes së gjynaheve ose ibadetit, mund të jenë shkaktarë të dominimit të njërës ose tjetrës në zemër. E duhet ta themi gjithashtu se, ëndrrat e njerëzve të mirë janë krejt ndryshe nga ëndrrat e gjynahqarëve.

Kështu, dominimi i të keqes në të cilën është mësuar njeriu bën që në zemrën e tij të formohet pamje e asaj të keqeje ndaj së cilës edhe zemra ndjen afërsi, e ndoshta në atë gjendje edhe i merret shpirti, dhe kjo i bëhet sebeb i përfundimit të tij të keq, ani që në zemër i ka mbetur esenca e iman, prandaj shpresohet që ky person do të shpëtohet nga fundi i keq.

Kur personit që nuk është në gjumë i bie në mend diçka, kjo ndodh për shkak të ndonjë arsyeje që Allahu e di. Njëjtë, edhe ëndrra të caktuara kanë shkaktarët e vet që i di Allahu Teala; disa na janë të njohura edhe neve, të tjerat jo. Gjithashtu, e dimë se disa mendime ndryshojnë sipas asaj që i përshtatet, nganjëherë për shkak të ngjashmërisë, nganjëherë për shkak të kundërshtisë, e nganjëherë për shkak të vendimit të arsyeshëm, dhe e gjitha kjo varësisht se çfarë ndjen personi në atë moment. Kur flasim për ngjashmëritë, kjo është ajo që - kur sheh diçka të bukur, kujton diçka tjetër të bukur. Njëjtë me kundërshtitë - kur sheh një të bukur, e kujton të shëmtuarën dhe mendon për dallimin mes tyre, e sa për vendimin e arsyeshëm, kjo është kur sheh një person mbi kalë më parë dhe pas një kohe e sheh vetëm atë kalë, ky menjëherë e kujton edhe kalorësin.

Nganjëherë ndodh që kujtimet mund të ndryshojnë nga njëri në tjetrin, pa e ditur se çfarë lidhje ka mes tyre, e që bëhet me një ose dy ndërmjetësues, si për shembull që mendimet të ndryshojnë nga një mendim në tjetër e më pas në të tretin, ashtu që mendimi i dytë plotësisht harrohet, ndërsa i treti nuk ka ndonjë lidhje me të parin, por ka me të dytin, e i dyti me të parin. Njëjtë edhe mendimet e ndryshme në ëndrra kanë shkaktarë të këtij lloji, e njëjtë vlen edhe për mundimet e vdekjes. Allahu Teala e di të vërtetën.

Sipas kësaj, ne themi se një person, zanati i të cilit është, për shembull, rrobaqepësia, shpesh sheh në ëndërr veprime të tilla si matja e rrobave, prerja e tyre, gjilpërat, qepja, gërshërët.

E vetmja mënyrë për ata që duan t'i mbajnë kujtimet e tyre larg gjynaheve dhe dëshirave epshore në momentin e vdekjes, është ta largojnë epshin nga zemrat e tyre dhe të luftojnë për një kohë të gjatë për ta mbajtur nefsin larg tyre. Zaten, kjo është ajo çfarë njeriu mund ta bëjë me vullnetin e tij, kështu që, duke u larguar nga gjynahet, duke vazhduar të bëjë vepra të mira dhe duke e larguar të keqen nga mendja, ai bën përgatitjet për momentin e vdekjes. Sepse njeriu vdes ashtu siç jeton dhe do të ringjallet ashtu siç ka vdekur. Lidhur me këtë, tregohet se një tregtari ia përkujtuan shehadetin në momentin e vdekjes, por ai vetëm thoshte: *“pesë, gjashtë, katër...”* - numëronte, sepse këtë e ka bërë gjithë jetën, dhe në këtë është mësuar.

E një arif ka thënë: *“Arshi është një xhevahir që shkëlqen si nur. Në çfarë gjendje është personi, ajo gjendje i pasqyrohet në Arsh, dhe ajo gjendje i shfaqet atij edhe në momentin e vdekjes. Ndoshta do ta shohë veten në gjendje të gjynahqarit, dhe kjo pamje do t'i shfaqet edhe në ditën e Gjykimit. Kështu ai do ta shohë gjendjen e vet dhe do të turpërohet e do të frikësohet aq shumë sa nuk mund të përshkruhet.”*



E vërtetë kjo që e ka thënë ky arifi. Edhe ëndrra e vërtetë është afër kësaj. Njeriu i fjetur mund të kuptojë se çfarë do të ndodhë në të ardhmen duke parë në *Lehvi Mahfudh*, dhe kjo është një prej pjesëve të pejgamberllëkut.

Pra, rreziku i frymës së fundit është i lidhur për gjendjet e zemrës dhe nga përzjerja e kujtimeve. Megjithatë, edhe pse lidhja e afërt dhe adeti i gjatë kanë ndikim në kujtime, zhdukja e kujtimeve të këqija nuk është tërësisht në vullnetin dhe dëshirën e njeriut. Vetëm Allahu i kthen zemrat në drejtimin që Ai dëshiron. Prandaj frika e arifëve nga fryma e fundit ishte e madhe.

Pra, edhe nëse personi dëshiron të shohë në ëndërr gjendjet e të mirëve (*salih*) veprat, sjelljet dhe ibadetet e tyre, kjo është e vështirë për të. Edhe pse ëndrra të tilla ndikojnë në veprim, sjellje dhe ibadete, për shkak që njeriu i ëndërron gjërat me të cilat është angazhuar gjatë ditës, turbullira e ëndrrave nuk mund të kontrollohet plotësisht. Për ta shpjeguar se njeriu në ëndërr sheh zakonisht atë me çfarë është i angazhuar gjatë ditës, do të tregojmë se shejh Ebu Ali el-Farmedi ka thënë:

*“Ashtu siç duhet muridi të respektojë shehun e tij me gjuhë, ai gjithashtu nuk duhet të refuzojë atë që thotë në mendjen e tij,”* dhe vazhdoi:

*"Shejhut tim, Ebu Kasim el-Kirmanit i tregova se e kam parë atë në ëndërr, se më tha:*

- Kështu është; për një çështje, e unë pyeta:*
- Pse duhet të jetë kështu?, e pas kësaj shejhu im nuk më foli për një muaj. Në fund, më tha:*
- Sikur të mos ishte në brendinë tënde ndjenja e refuzimit të asaj që thashë dhe dëshirës për të marrë përgjigje, nuk do të më pyesje në ëndërr për këtë.*

Me të vërtetë kështu është. Sepse zakonisht njeriu natën ëndërron atë që e mendon gjatë ditës. Rrallë mund të shohë diçka tjetër.

Në këtë pjesë muamele mjafton kaq shpjegim për fshehtësitë e përfundimit të keq; më shumë se kaq veç i takon diturisë mukashefe.

Nga të gjitha këto që shpjeguam e ke kuptuar se mbrojtja nga përfundimi i keq është t'i shohësh gjërat ashtu siç janë dhe ta kalosh jetën në ibadet e pa gjynahe. Nëse mendon se kjo është e pamundur ose e vështirë për ty, dhe nëse has në vështirësi për të vepruar kështu, duhet të kesh frikë si arifët, bile të qash gjatë, të mërztësh e brengosësh. Do ta shohësh këtë nga shembujt që do të sjellim nga jetët e pejgamberëve dhe të parëve tanë të mirë, e me qëllim që në zemër të të ndizet zjarri i frikës.

Nga shpjegimi ynë i mësipërm, gjithashtu, ke mundur ta kuptosh se të gjitha veprat që i bën njeriu gjatë jetës mund të kalojnë pa dobi, nëse nuk ka selamet në frymën e fundit, dhe me përzierjen e kujtimeve të kësaj bote në frymën e fundit selameti i imanit është vërtet i vështirë. Prandaj Mutarrif ibn Abdullah ka thënë: *“Nuk me habisin ata që shkatërrohen, por unë i pëlqej ata që arrijnë selamet në frymën e fundit.”*

Edhe Hamid el-Letffaf ka thënë: *“Kur melaiket të ngritën duke bartur shpirtin e besimtarit që pati përfundim të mirë dhe ka vdekur në rrugë të islamit, atëherë melaiket tjera habiten, e thonë:*

*- Si arriti ky të shpëtojë nga dynjallëku, ku u prishën personat e respektueshëm.”*

Një ditë es-Sevri po qante, dhe e pyetën për arsyen, e ju tha:

*- Kohë të gjatë kam qarë për gjynahet, tash po qaj për islamit; a do ta mbroj fenë në frymën e fundit?*

Me pak fjalë, ai që barkën e ka në det të hapur, dhe e godasin erë e fortë dhe valët e detit, më shumë ka mundësi se do të shkatërrohet, se sa që do të shpëtojë. Mirëpo, zemra e besimtarit dridhet më shumë se anija, dhe valët e kujtimeve janë shumë më të forta se valët e detit.

Rreziku më i frikshëm në momentin e vdekjes është rreziku i frymës së fundit. Në lidhje me këtë Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

***“Personi do të bëjë veprimet e banorëve të xhennetit për pesëdhjetë vjet; bile mes tij dhe xhennetit do të mbetet largësi vetëm aq sa shtrëngimi dhe lëshimi të shuplakës kur mjelë devenë, por, e mbizotërojnë gjynahet dhe ai ndërron jetë pa iman në frymën e fundit.”***

Sehl ka thënë: *“Ëndërrova se hyra në xhennet. Aty pashë treqind pejgamberë (a.s.), dhe i pyeta:*

*- Nga çfarë keni pasur më së shumti frikë në dynja?“, e ata më thanë:*

*- Nga fryma e fundit.*

Për shkak të këtij rreziku të madh, largimi nga bota si shehid në frymën e fundit është e dëshiruar ndërsa vdekja e papritur është e padëshiruar, sepse mund të ndodh në kohë kur në zemrën e njeriut dominojnë mendime të këqija. Personi mund t'i dëbojë ato me vështirësi ose me nurin e marifetit, e derisa zemra është e zënë me këto kujtime të këqija, vdekja e papritur natyrisht që është rrezik.

Sa i përket vdekjes si shehid, ky është një moment kur pasuria, fëmijët dhe të gjitha dëshirat epushore largohen nga zemra, dhe nuk mbetet asgjë përveç dashurisë për Allahun dhe shpresës në Të. Sepse ai që lufton armikun në fushën e betejës, ai lufton për të shitur jetën e vet të dynjasë dhe për të blerë jetën në ahiret, vetëm për dashurinë e Allahut dhe rizanë e Tij. Ndërsa me një ajet thuhet:

**“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të xhennetit.”**

9-Teube: 111

Pra, ata e shitën dynjanë për ahiret. Natyrisht që shitësi shet atë që nuk dëshiron më dhe e largon nga zemra dashurinë për të, ndërsa e tërë dashuria e tij është ajo që do të marrë në këmbim të asaj që jep. Edhe pse kjo gjendje mund të dominojë shpesh në zemrën e personit gjatë jetës së tij, ajo mund të mos qëndrojë në zemër në momentin e vdekjes.

Ama, fusha e betejës nuk është kështu. Lufta është shkaku i vdekjes në këtë ndjenjë, prandaj ajo është e vlefshme. Por ky nder nuk është për ata që luftojnë për gradë, për plaçkën e luftës a për lëvdatat për trimërinë, sepse kush i ka qëllim këto, edhe nëse vritet në luftë, ai është larg nga grada e shehidit; këtë e tregojnë hadithet.

Pasi të është bërë i qartë kuptimi i përfundimit të keq dhe pasojat e tmerrshme të kësaj, tani përgatitu për atë moment. Vazhdimisht kujtoje Allahun, dhe vazhdo me ibadet, dhe nga zemra largoje dashurinë për dynjanë, largoji mendimet e këqija, mbroji gjymtyrët e tua nga gjynahi, largohu nga shikimi në gjynah e gjynahqarë, sepse kjo ndikon keq në zemër dhe tërheq në atë drejtim. Prandaj, assesi mos e vono këtë e të thuash: *“Do të përgatitem kur të vjen koha”*, sepse secila frymëmarrje e jotja mund të jetë fundi yt, e mund të vdesësh në aso gjendje. Kështu vepro sa je zgjuar, e kur të shkosh për të fjetur, merr abdes, mundohu që e brendshmjia dhe e jashtmjia jote të jenë të pastra; gjumi le të zë vetëm pasi në zemër të të mbizotërojë dhikri, e nuk po mendoj në dhikr me gjuhë, ani që edhe nga kjo ka dobi, por kryesorja është që zemra të shkojë në gjumë me dhikrullah.

Të jesh i sigurt se, çfarëdo që ke në zemër para gjumit, ajo mbizotëron në zemër edhe kur je në gjumë, e ajo që mbizotëron në zemër lajmërohet gjatë gjumit. Ndërsa vdekja dhe ringjallja pas saj janë të ngjashme me gjumin dhe zgjimin; njeriu zgjohet me atë me çfarë zemra e tij ka qenë e zënë para, gjatë dhe pas gjumit, dhe njëjtë, njeriu vdes ashtu siç ka jetuar, dhe ringjallet ashtu siç ka vdekur.

Gjithashtu, të jesh i sigurt se vdekja dhe ringjallja janë dy gjendje tua, bash siç janë gjumi dhe zgjimi dy gjendje tua; nëse nuk mund ta shohësh këtë me nurin e *basiretit* dhe me syrin e bindjes, së paku besojë me zemër.

Kontrollo frymëmarrjen tënde çdo moment dhe mos e harro Allahun për asnjë çast. Sepse, edhe nëse i përkushtohesh të gjitha këtyre, dije se prapë je në rrezik të madh, e tek nëse nuk i bën; çfarë mendon ti se do të ndodhë? Fatkeqësisht, të gjithë njerëzit i janë të ekspozuar shkatërrimit përpos dijetarëve; të gjithë dijetarët i janë të ekspozuar shkatërrimit përpos atyre që veprojnë sipas diturisë që kanë; të gjithë ata që veprojnë sipas diturisë që kanë i janë të ekspozuar shkatërrimit përpos atyre që janë të sigurtë; e të gjithë të sigurtit janë në rrezik të madh.

Dije se nuk mund të arrish sukses në këtë nëse nuk je i kënaqur me atë që të është e domosdoshme nga dynjaja, e të domosdoshme i ke ushqimin, veshmbathjen dhe banimin; gjithçka tjetër është teprim. Nga ushqimi, e domosdoshme është vetëm sasia që të mbanë gjallë, dhe kur ushqehesh, duhet të hashë sikur ai që është i detyruar në të; dëshira jote për ushqim nuk duhet të jetë më e madhe se dëshira jote për të plotësuar një nevojë natyrore, sepse nuk ka dallim mes futjes së ushqimit në organizëm dhe largimit të saj prej aty; janë dy nevoja natyrore.

Siç nuk është zemra jote e ngarkuar me brengën për kryerjen e nevojës fiziologjike, njëjtë nuk duhet të jetë e ngarkuar as me futjen e ushqimit në organizëm. Dije se nëse brengosesh për stomakun, atëherë ti ke vlerë aq sa ka ajo që del prej tij. Ashtu siç e ke qëllim pastërtinë kur e kryen nevojën fiziologjike, edhe kur merr ushqim qëllimi yt duhet të jetë forcimi i organizmit për t'i bërë ibadet Allahut. Ka tri shenja që e tregojnë këtë: koha e ushqimit, sasia e ushqimit, dhe lloji i ushqimit.

Sa i përket sasisë, duhet kufizuar në një racion për një ditë dhe natë, e pjesa tjetër të kalohet në agjërim.

Sa i përket kohës, nuk duhet të hash më shumë se sasia që do të mbushte një të tretën e stomakut.

Sa i përket llojit të ushqimit, nuk duhet dëshiruar ushqim të shijshëm, por të mjaftohesh me atë që qëllon.

Nëse mund t'i zbatosh këto tri gjëra, atëherë do të jesh në gjendje të braktisësh atë që është e dyshimtë dhe do të hash kafshatë hallall. Përndryshe është e vështirë të sigurosh kafshatën hallall duke ia plotësuar epshit të gjitha dëshirat.



E sa për rrobat tua, qëllim kryesor ta kesh mbrojtjen nga të nxehtit e të ftohtit, si edhe mbulimin e pjesëve të turpshme. Më shumë se kaq është e panevojshme, sepse nënkupton humbje të kohës, brengë të vazhdueshme dhe angazhim për t'i siguruar ato, të çon në gjëra të dyshimta dhe haram. Nëse nuk je i kënaqur me rrobat që të mbulojnë dhe mbrojnë trupin nga të nxehtit e të ftohtit dhe kërkon diçka më të vlefshme, nuk do të kesh një pikë ku do të thuash mjaft, do të kërkohesh vazhdimisht më shumë, e atëherë bëhesh një prej atyre që stomakun mund t'ia kënaqë vetëm dheu.

E njëjta vlen edhe për strehimin; nëse mjaftohesh me diçka që kryen funksionin e shtëpisë, atëherë të mjafton qielli si mbulojë e dheu si shtrojë. Nëse të mundon të nxehtit a të ftohtit, strehohu në xhami. Nëse po kërkon banim të posaçëm, kjo të merr shumë kohë. Pjesa më e madhe e jetës tënde, e cila tashmë është e kufizuar dhe është kapitali yt kryesor, do të harxhohet në këtë rrugë. Nëse thua: Dua mure për të më mbrojtur nga shikimet dhe kulm për të më mbrojtur nga shiu, dhe i siguron ato, atëherë do të fillosh të dekorosh muret e tavanin, dhe kështu do të biesh në humnerë, dhe pak ke mundësi të dalësh nga aty.

Njëjtë edhe për nevojat tjera të domosdoshme; nëse je i kënaqur me sasinë e mjaftueshme, do të gjesh kohë për t'i bërë ibadet Allahut, punon për ahiret dhe përgatitesh për momentin e frymës së fundit në këtë botë. E nëse i kalon kufijtë e domosdoshmërisë/nevojës dhe nisesh pas qejfit e dëshirave, atëherë angazhimi yt humbet, e për Allahun Teala nuk është brengë se në cilën luginë do të shkatërrohesh. Prandaj, pranoje këtë këshillë nga ai që ka nevojë për këshillë më shumë se ti.

Dije se kjo jetë e shkurtër është vend i përgatitjes për ahiret, dhe nëse e kalon ditë pas dite në pakujdes e duke menduar se kohë ka mjaftueshëm, papritmas do të përfundosh në kohën që ti nuk e zgjedh, e atëherë nuk të braktis dëshpërimi dhe keqardhja. Nëse nuk je në gjendje të pasosh rrugën që të është treguar për shkak të frikës tënde të dobët, pra nëse nuk të ka frikësuar mjaftueshëm ajo që e treguam deri tash, atëherë do të sjellim edhe shembuj tjerë për gjendjet e atyre që kanë frikë nga fryma e fundit, dhe shpresojmë se kjo, bile deri diku, do të zbusë ashpërsinë e zemrës tënde. Sigurisht do ta pranosh se mendja e pejgamberëve, evliave dhe dijetarëve, si edhe veprat e tyre dhe gradat e tyre te Allahu Teala nuk janë më pak se mendja jote, veprat tua dhe grada jote, prandaj mendo mirë, me zemër e me shpirt, për gjendjet e tyre; përse ata ndjenin frikë aq të fuqishme, përse ishin shumë të pikëlluar e qanë aq gjatë?

Nga frika, disa prej tyre ishin sikur të goditur nga rrufeja, disa mbesnin të shtanguar, disave ju ra të fikët, e disa binin për tokë, si të vdekur. Nuk ka asgjë për t'u habitur nëse këto gjendje nuk ndikojnë në zemrën tënde, sepse zemrat e gafilëve janë të ngurta si guri, ndoshta edhe më të ngurta, sepse ka shkëmbinj nga të cilët edhe uji rrjedh, ka të tillë që copëtohen, e pastaj aty rrjedh ujë, e ka edhe të tillë që, nga frika prej Allahut, rrëzohet. E Allahu Teala e di atë që bëni ju.

## FRIKA E PEJGAMBERËVE DHE MELAIKEVE

Ajsha, r.anha tregon se fytyra e Resulallahut, s.a.v.s., ndryshonte kur ndryshonte moti dhe kur frynte erë e fortë; ecte nëpër dhomë, hynte e dilte; krejt kjo nga frika prej Allahut. Një herë lexoi një ajet nga sure Vakia, e i ra të fikët. Allahu Teala njofton se edhe Musës a.s., i ra të fikët:

**“E Musait i ra të fikët.”** 7-Araf: 143

Kur Resulallahu, s.a.v.s., fillonte ta falë namaz, nga gjoksi i tij dëgjohej një zë sikur uji kur vlon. Resulallahu, s.a.v.s., e pa Xhebrailin, a.s., në *Ebtah* e i ra të fikët. E Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

**“Sa herë që më vinte Xhebraili, ai dridhej nga frika e Allahut”<sup>77</sup>**, dhe tregohet se kur Xhebraili dhe Mikaili a.s., panë fatkeqësinë që i ndodhi Iblisit, filluan të qajnë. Allahu Teala ju tha:

- ***Pse po qani?***, e ata thanë:

- *O Rabb, nuk ndihemi të sigurt nga dënimi Yt*, e Allahu Teala tha:

- ***Ashtu qëndroni, mos jeni të sigurt nga dënimi Im!***

Muhammed ibn Munkedir ka thënë: *“Kur Allahu Teala krijoi xhehenemin, melekët u frikësuan shumë, e kur krijoi njeriun, melekët u rehatuan.”*

---

<sup>77</sup> Ebu Shejh nga Ibn Abbas.

Enesi r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti Xhebrailin, a.s.:

- **Përse nuk e shoh Mikailin të qesh?**, e Xhebraili tha:
- **Ai nuk ka qesh që kur u krijua xhehenemi.**<sup>78</sup>

Thuhet se Allahu Teala ka disa melaike që asnjëri prej tyre nuk ka qeshur që kur u krijua xhehenemi. Por kjo frikë nuk është për shkak se Allahu do t'i ndëshkojë ata.

Ndërsa Abdullah Ibn Omeri r.a., ka treguar: *“Dola me Resulallahun, s.a.v.s., e hymë në një prej bahçeve me hurma të Ensarëve, e Resulallahu, s.a.v.s., mori disa hurma që kishin rënë në tokë, dhe filloi t’i hajë. Më pyeti:*

- **Çfarë ke, o i biri i Omerit, pse nuk ha?**

- *Nuk kam oreks o i dërguar i Allahut; i thashë, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- **Unë kam; është mëngjesi i katërt që nuk kam ngrënë; nuk kisha çka, e po të kërkoja nga Rabbi im, sigurisht që Ai do të më jepte pasuri si Kajseri dhe Kisras. Si do të jetë puna jote, o i biri i Omerit, kur të mbetesh me popull i cili grumbullon ushqimin për gjithë vitin, e në zemra ju dobësohet imani?! Vallahi, as nuk u ngritëm në këmbë, e Allahu shpalli:**

**“Sa krijesa ka që nuk e mbajnë dot veten me ushqim! Allahu u jep atyre dhe juve! Ai dëgjon dhe di gjithçka.”** (29:80)”, e atëherë Resulallahu, s.a.v.s., tha:

---

<sup>78</sup> Ahmedî dhe Ibn Ebu Dun’ja nga Sabiti, ky nga Enesi.

***“Allahu nuk ju urdhëroi të grumbulloni pasuri, as të pasoni epshet! Kush grumbullon dukatë duke e dashur këtë jetë kalimtare, le ta dijë sigurt se jeta është në dorën e Allahut! Unë vërtetë nuk grumbulloj dukatë as argjend, e as nuk ruaj furnizim për nesër.”***<sup>79</sup>

Ebu Derda ka treguar: “Zëri i zemrës së Ibrahimit, a.s., dëgjohej një milje larg, nga frika prej Rabbit të vet.”

Muxhahid tregon: “Davudi a.s., për katërdhjetë ditë qau në sexhde, pa ngritur kokën, aq sa bari nisi të rritet nga lotët e tij, e kokën e kishte mbuluar. E dëgjoji një zë:

***- O Davud! A je i uritur, të ushqehesh? A je i etur, të pishë ujë? A je pa rroba, të vishesh?***

e Davudi vetëm tha “Ah”, e pema aty pranë u tha nga zjarri i frikës së tij. Pastaj Allahu ia pranoi pendimin dhe e fali, e Davudi, a.s., tha:

***- Rabbi im! Shkruaj gabimet e mia në shuplakën time!, dhe gjynahu iu shkrua në shuplakë, e sa herë që e hapte shuplakën për të marrë ushqim, ujë, ose tjetër, i shihte gabimet e shkruara, e fillonte të qajë. Kur i ofronin gotën, e mbushnin vetëm një të tretën, e kur Davudi a.s. e merrte, i shihte gabimet e shkruara, në shuplakë dhe ende pa e afruar gotën te goja, ajo veç mbushej me lotët e tij.”***

---

<sup>79</sup> Ibn Merdevejh në librin “**Tefsir**” dhe Bejhek në “**Zuhd**”.

Tregohet se Davudi, a.s., nuk e ngriti kokën kah qielli deri në vdekje, nga turpi prej Allahut Teala. Në duatë e tij, thoshte:

*“Allahu im! Kur i kujtoj gabimet e mia, toka më bëhet e ngushtë, e kur e kujtoj rahmetin Tënd, shpirti më kthehet. O Rabb Ti je i vetmi Absolut. Shkova te të gjithë mjekët të ma shërojnë gabimin tim, dhe të gjithë më udhëzuan tek Ti! Mjerë ata që kanë humbur shpresën në rahmetin Tënd!”*

Fudajli ka treguar:

*“Kam dëgjuar se Davudit a.s., një ditë iu kujtua gjynahi i vet dhe kërceu e filloi të bërtasë; e vendosi dorën mbi kokë dhe vrapoi, deri sa nuk shkoi në male. Rreth tij u mblodhën kafshët e egra, e ai tha:*

*- Ikni! Nuk dua ta shohë askënd! I dua vetëm ata që qajnë për gjynahet e veta, dhe të mos më afrohen nëse nuk janë duke qarë! Çfarë të bëjë Davudi gjynahqar me ata që nuk kan gjynah?*

*Bile, kur Davidi a.s., u qortua se po qanë shumë, ai tha:*

*- Më leni të qaj para se të vijë dita e të qarit, pa e ndarë mishin nga kocka dhe para se të më kapin zebanitë.*

Abdulaziz ibn Omer ka treguar: *“Kur Davudi a.s., e humbi zërin pas gabimit të tij, tha: “Allahu im! Zëri im e humbi forcën, pranë zërave të fuqishëm të sidikëve.”*

Thuhet se Davudi, a.s., qau gjatë, por kjo nuk i bëri dobi, e tha:

- *Rabbi im! A nuk do të kesh rahmet për lotët e mi?!,*  
e Allahu Teala i shpalli:

- ***O Davud! Ti e harrove gjynahun tënd e i kujtove lotët tu!***

Davudi a.s., tha:

- *Allahu im! Si mund ta harroj gjynahin tim, e kur e lexova Zeburin, uji që rridhte u ndal, era që frynte nuk frynte më, zogjët më mbuluan me krahët e tyre e më bënë hije, e kafshët e egra shoqëroheshin me mua. Allahu im! Çka është kjo ftohtësi mes meje e Teje?!*

Allahu Teala i tha:

- ***O Davud! Ajo që the është nënshtrim dhe afërsia jote, e kjo është ftohtësia e gjynahit tënd! O Davud! Ademi është një krijesë e imja. E krijova me dorën Time, në të fryva shpirtin, melaiKET i urdhërova t'i bëjnë sexhde, ia veshu rrobat e fisnikërisë Time dhe ia dhurova kurorën e nderit Tim, e ai mu ankua në vetmi; e i dhurova grua, Havën, dhe i vendosa në xhennetin Tim, e ai më kundërshtoi. Të zhveshur e të poshtëruar, e largova nga afërsia Ime. O Davud! Më dëgjo me kujdes, e Unë flas vetëm të vërtetën, ti na u nënshtrove Neve e Ne bëmë që të tjerët të nënshtrohen ty; nga Ne kërkove, Ne të dhuroam; pastaj na kundërshtove, e ne të dhamë afate; nëse na kthehesh i tillë çfarë ishe, Ne të pranojmë.”***



Jahja ibn Kesir tregon:

*“Davudi a.s., kur i vinte ta qajë veten, shtatë ditë i kalonte pa ngrënë e pa pirë, as nuk ju afrohej grave. Ia rregullonin minberin në një fushë, e ai do t'i thoshte djalit të tij Sulejmanit a.s., që të thërrasë si tellall; fushat, malet, kodrat, tempujt e zogjtë, duke ju thënë se kush do të dëgjojë vet-vajtimin e Davudit, le të vijë. Me ftesën e Sulejmanit a.s., mblidheshin të gjitha kafshët e egra dhe grabitqarët, nga fushat, malet, kodrat e shkretëtirat, dhe zogjtë nga foletë bashkë me njerëzit. Pas kësaj, Davudi a.s., ngjitej në minber, e rreth tij mblidheshin israelitët, dhe të gjitha kafshët, në grupe, renditeshin përreth, e pranë i qëndronte Sulejmani a.s.. Davudi a.s., fillimisht i shprehte falënderimet Allahut, dhe të gjithë të pranishmit fillonin të qajnë me zë. Më pas fillonte të tregojë për xhennetin e xhehenemin, e derisa e tregonte këtë, i lëshonte shpirti një pjesë të insekteve, kafshëve të egra dhe njerëzve. Më pas fliste për tmerret e ditës së Gjykimit dhe e qante veten, dhe nga secili lloj i gjallesave vdiste nga një grupim. Kur Sulejmani a.s., shihte sa shumë kishin vdekur, thoshte:*

*- O baba! Këta që po dëgjojnë ju copëtuan zemrat; vdiqën shumë izraelitë, dhe shumë kafshë të egra.*

*Atëherë Davudi, a.s., fillonte të bëjë dua, e dikush nga të devotshmet prej izraelitëve i tha:*

*- O Davud! U ngute në kërkim të dënimit nga Rabbi yt!*

*Atëherë Davudit a.s., i ra të fikët dhe u rrëzua. Sulejmani a.s. kur e pa gjendjen, solli një barelë dhe e vendosi në barelë. Më pas i urdhëroi tellallit të thërrasë të gjithë ata që kanë një të afërm aty të vinë me barelë e t'i marrin, sepse përmendja e xhehenemit nga Davudi a.s., shkaktoi vdekjen e tyre. Të gjithë sillnin barelën dhe merrnin të afërmit e tyre. Një grua erdhi me barelën duke menduar në të afërmin e saj, e thoshte:*

*- O ti të cilin e mbyti kujtimi në xhehenem! O ti të cilin e mbyti frika prej Allahut!*

*Kur Davudi a.s., vinte në vete, çohet, vendoste dorën mbi kokë, hynte në dhomën ku bënte ibadet, dhe mbyllte derën. Atëherë i drejtohet Allahut:*

*- O Rabbi i Davudit, a je i zemëruar me Davudin?!*

*Sulejmani a.s., erdhi te dera me një copë bukë elbi në dorë, mori leje, hyri dhe i tha:*

*- Baba, përforcohu me këtë bukë.*

*Davudi a.s., mori bukën, hëngri, dhe pastaj doli mes izraelitëve dhe jetoi mes tyre.*

Sipas tregimit të Jezid Rakkshit, Davudi a.s., një ditë doli në shkretëtirë me katërdhjetëmijë njerëz, u dha atyre disa këshilla dhe ju tërhoqi vëmendjen në frikë prej Allahut. Nën ndikimin e këshillave të tij, tridhjetë mijë njerëz vdiqën aty, dhe ai u kthye me vetëm dhjetë mijë njerëz.

Jezid Rakksh gjithashtu ka treguar:

*“Davudi a.s., kishte dy shërbëtore që, kur i binte të fikët nga frika prej Allahut, njëra i qëndronte te koka e tjetra te këmbët, për ta mbrojtur që të mos vet-lëndohej.”*

Ibn Omeri, r.a., ka treguar:

*“Jahja ibn Zekerija a.s., hyri në Bejtul-makdis<sup>80</sup> kur i kishte tetë vjet. Brenda pa idhujtarë të veshur me rroba prej leshi; shikoi udhëheqësit e tyre dhe pa se ishin pështjellë me zinxhirë, lidhur për qoshet e Bejtul-makdis. Kur e pa krejt këtë, u frikësua e u kthye te prindërit e vet. Rrugës takoi fëmijë që po luanin dhe e ftuan që të luajë me ta, por Jahja ju tha:*

*- Nuk jam krijuar për të luajtur!; dhe shkoi te prindërit e vet, e ju kërkoi ta veshin me rroba prej leshi. Kur e veshën, u kthye në Bejtul-makdis dhe aty kalonte ditët duke pastruar, e netët duke ndezur qirinjtë, derisa i mbushi pesëmbëdhjetë vjet. Pastaj u largua nga atje dhe filloi të endet nëpër male dhe lugina. Prindërit e tij dolën për ta kërkuar dhe në fund e gjetën disa milje larg Bejtul- makdisit. Kishte futur këmbët në ujë, dhe po betohej:*

*- Pashë madhëstninë dhe fuqinë Tënde, nuk do ta shijoj të ftohtit e këtij uji deri sa nuk e di çfarë është pozita ime te Ti!*

---

<sup>80</sup> Shtëpi e shenjtë

*Ishte në prag të vdekjes nga etja, e prindërit i ofruan të hajë pak bukë elbi që e kishin sjellë, dhe të pijë pak ujë, ai i dëgjoi, theu betimin dhe pagoi keqfaretin. Për shkak që dëgjoi prindërit, u lavdërua për mirësinë ndaj prindërve. Pastaj prindërit e kthyen në Bejtul-makdis. Kur Jahja fillonte të falë namaz, qante aq shumë sa që pemët qanin bashkë me të. Për shkak të qarjes së tij, edhe babai i tij, Zakarija, qante derisa i binte të fikët. Jahja qante aq shumë sa lotët ia dogjën mishin në faqe sa që mund t'i shiheshin mollëzat. Nëna e vet i tha:*

*- O Evlad! Më lejo që t'i mbuloj mollëzat e të mos shihen ashtu!*

*E lejoi, dhe ajo mori dy arna e i vendosi në faqet e tij. Kur çohet të falë namaz, qante, dhe lotët e tij ia bënë qull ato dy arna, e nëna e tij vinte e i shtrydhte. Kur pa se lotët e tij po rrjedhin nëpër duart e nënës së tij, tha:*

*- Allahu im! Këta janë lotët e mi, kjo është nëna ime, unë jam rob i Yti, e Ti je Mëshirues, Mëshirëbërës.*

*Një ditë babai i tij Zekeria a.s., i tha:*

*- O Evlad! E luta Allahun të më dhurojë ty e të më bëhesh gëzim i jetës. Jahja, a.s., i tha:*

*- O baba! Xhebraili a.s., më ka lajmëruar se mes xhennetit e xhehenemit ka një hendek që mund ta kalojë vetëm ai që qanë. Atëherë Zekeriaja i tha:*

*- Atëherë qaj, evlad!*

Isa, a.s., ka thënë:

*“O Havarijjet e mi, frika prej Allahut dhe dashuria për Firdevs kërkojnë durim në vështirësi dhe largim nga dynjaja. Po ju flas të vërtetën: të ushqyerit me bukë elbi dhe gjumi në vende të pista me qentë është pak kur flitet për kërkim të Firdeusit.”*

Thuhej se kur Ibrahimit a.s., i kujtohej gjynahi i vet, i binte të fikët, e të rrahurat e zemrës së tij dëgjoheshin një milje larg. Një ditë i erdhi Xhebraili a.s., dhe i tha:

- *Rabbi yt po të çon selam dhe të pyet: “A ke parë diku që miku të ketë frikë nga miku?”;*

e Ibrahimimi u përgjigj:

- *O Xhebrail, m’u kujtua gabimi im, dhe e harrova miqësinë.*

Këto ishin gjendjet e peygamberëve, ejani në vete dhe mendoni për këtë, sepse ata më së miri e njohin Allahun, dhe cilësitë e Tij. Salat dhe selam të gjithë peygamberëve dhe atyre të afërt Allahut. Na mjafton Allahu, sa mbrojtës i mirë është Ai.

## FRIKA E AS'HABËVE, TAIBINËVE DHE SELEF-I SALIHIN

Transmetohet se Ebu Bekr r.a., i tha një zogu: *“O zog! Do te doja te isha si ti. Sikur të mos isha krijuar njeri!”*

Ebu Dherr, r.a., ka thënë: *“Do të doja të isha pemë, e jo njeri”*, e njëjtë ka thënë edhe Talha.

Osmani r.a., ka thënë: *“Do të doja të zhdukesh plotësisht pas vdekjes!”*, e Ajsha, r.anha ka thënë: *“Do të doja të harrohem plotësisht!”*

Tregohet se Omeri r.a., kur dëgjonte një ajet alivanosej, e me ditë të tëra i bënin vizitë. Një ditë mori një fije kashte nga toka e tha: *“Do të doja të isha kjo kashtë, të harrohem. Do të doja që nëna ime të mos më kishte lindur”*.

Omeri r.a., gjithashtu ka thënë: *“Kush i frikësohet Allahut nuk kërkon hakmarrje. Kush i frikësohet Allahut nuk bën çfarë të dojë. Po të mos ishte kiameti, gjithçka do të ishte e kundërta e asaj që po shihni.”*

Omeri r.a., alivanosej sa herë lexonte ajetin:  
***“kur fletët të shpërndahen”***, (81:10).

Një ditë, duke kaluar pranë një shtëpie, Omeri r.a., dëgjoi se personi brenda po lexonte suren:

***“Pasha malin Tur (Sina)!...”*** (52:1). Kur lexoi ajetin:

***“Është e vërtetë se dënimi i Rabbit tënd patjetër do të ndodhë”*** (52:7), Omeri, r.a., zbriti nga gomari, u mbështet në mur dhe qëndroi ashtu për një kohë. Pastaj shkoi në shtëpi dhe nën ndikimin e këtij ajeti, qëndroi në shtëpi i sëmurë për një muaj. Njerëzit vinin për ta vizituar, por nuk mund ta kuptonin shkakun e sëmundjes.

Alia r.a., pasi përfundoi farzin e sabahit, lehtas lëvizi dorën, e tha: *“I kam parë as’habët e Resulallahut s.a.v.s., e nuk shoh askënd si ata sot. Ata natën e kalonin në namaz e lexim të Kur’anit, duke pushuar herë ballin e herë këmbët, ishin të zbehur e pluhurosur, e kur bëhej dritë i bënë dhikr Allahut e lëkundeshin si lisat në erë, e nga sytë ju binin lot, sa rrobat ju lageshin. Tash sikur jam mes njerëzve që gjithë natën e kanë kaluar në gaflet!”* Më pas u ngrit në këmbë, dhe kurrë pas kësaj nuk u pa duke qeshur, deri sa e vrau Ibn Mulxhem.

Imran ibn Husejn ka thënë: *“Do të doja të isha pluhur, që e përhapë era në një ditë të stuhishme.”*

Ebu Ubejde ibn Xherrah ka thënë: *“Të isha bile dash, e familja ime të më therin kurban, e të hanë mishin tim.”*

Ali Zejnelabidin ibn Husejn kur merrte abdes, zbehej, e familjarët e pyetën çfarë po i ndodh gjatë abdesit, e ju tha:

*- A e dini para Kujt do të qëndroj?!*

Musa ibn Mesud ka thënë: *“Kur uleshim rreth Suffjan Sevrisë, ishte sikur zjarri të na rrethojë. Kjo ishte për shkak të frikës së tij aq të madhe nga zjarri, që shihej.”*

Një ditë Nazr el-Kari lexoi ajetin:

***“Ky është Libri Ynë, që do t’ju tregojë të vërtetën. Ne i kemi urdhëruar (melaiket) që të shkruajnë të gjitha ç’keni bërë”*** (45:29), e Abdulvahid b. Zejdit i ra të fikët, e kur u zgjua tha:

*“Pasha madhështinë dhe fuqinë Tënde, kurrë më nuk do të bëj gjynahe! Më ndihmo që vetëm Ty të të nënshtrohem!”*

Musevir ibn Mahreme nuk ishte në gjendje të dëgjojë asgjë nga Kur’ani për shkak të frikës së madhe që ndjente. Nëse në praninë e tij dikush lexonte ndonjë ajet, ai bërtiste fort dhe endej pa vetëdije për një kohë. Bile, kur erdhi një person nga fisi Has’am dhe i lexoi ajetin:

***“Ditën kur do t’i tubojmë të devotshmit te i Gjithëmëshirshmi si mysafirë të ftuar.***

***Ndërsa gjynahqarëve u grahim në xhehenem të etshëm”*** (19:85-86), Mahreme tha:



*“Unë jam gjynahqar, nuk jam prej të devotshmëve! Ma përsërit këtë ajet!”* Kur personi e lexoi përsëri ajetin, Mahreme mori frymë thellë, u rrëzua dhe vdiq.

Kur para Jahja el-Bekkas u lexua ajeti:

***“Ah, sikur t’i shohësh ata kur të dalin para Rabbit të tyre!”*** (6:30), Bekkas bërtiti fort dhe u rrëzua, e katër muaj mbeti i shtrirë, dhe e vizitonin nga të gjitha anët e Basras.

Malik ibn Dinar tregon: *“Një herë isha duke bërë tavaf dhe e pashë një vajzë të re që mbante mbulesën e Qabesë, e thoshte:*

*- Rabbi im! Ka shumë kënaqësi e pshore që janë zhdukur, por përgjegjësitë e tyre mbeten. Rabbi im! A nuk ke Ti dënim tjetër pos Zjarrit?!*

*Fliste ashtu dhe qante, dhe mbeti në atë gjendje deri në agim. Kur e pashë këtë, e vendosa dorën në kokë, the thashë:*

*- O Malik! Nëna jote le të qajë për ty, Maliku është shkatërruar”.*

Sipas tregimit, kur haxhilerët po bënin dua në Arafat, Fudajli qau derisa perëndoi dielli, si një nënë që kishte humbur fëmijën. Pas perëndimit të diellit, duke mbajtur mjekrën në grusht e me shikim kah qielli, tha: *“Turp të kesh, edhe nëse je i falur!”* Pastaj u largua duke u përzier me haxhitë.

Kur e pyetën Abdullah Ibn Abbasin për gjendjen e atyre që kanë frikë, ai tha: *“Zemrat e tyre janë të plagosura nga frika, sytë e tyre të përлотur, e thonë:*

*- Si mund të jemi rehat, kur na pret vdekja?! Varri është para nesh, kiameti është vendi ku do të mblidhemi, xhehenemi është në rrugën tonë dhe ne duhet të përgjigjemi para Allahut, Rabbit tonë!?”*

Hasani Basriu kaloi pranë një grupi shokësh, dhe pa një të ri si po qeshej ëmbël, e i tha:

*- Djalosh! A e ke kaluar ti urën e Siratit? Kur djali i tha se nuk e ka kaluar, Hasani prapë e pyeti:*

*- A e di ku do të përfundosh, në xhennet apo xhehenem? Djaloshi u përgjigj se nuk e di, e Hasani i tha:*

*- Pra, çka është kjo e qeshur?! E tregohet se atë djalosh më kurrë nuk e panë duke qeshur.*

Hammad ibn Abdu Rabih kur ulej, mbështetej në shputat e këmbëve, që në çdo moment të mund të ngritët shpejtë. I thoshin të rehatohet, e ai thoshte:

*- Rehat ulen ata që janë të sigurt, e unë nuk jam i sigurt deri sa vazhdoj me gjynahe.*

Omer ibn Abdulaziz thotë: *“Gafleti në zemrën e robit është rahmet i Allahut Teala, sepse, po të mos ishte ai gaflet, rob i do të vdiste nga frika prej Allahut.”*

Malik ibn Dinar ka thënë: *“Kam dashtë që ta lë amanet, kur të vdes, të më lidhin me zinxhirë dhe ashtu të më dërgojnë te Rabbi im, bash sikur skllavin e ikur e të padëgjueshëm që e kthejnë te zotëria i vet.”*

Hatim Esamm ka thënë: *“Mos u mashtro me vende të bukura, se nuk ka vend më të bukur se xhenneti, e Ademit a.s., në xhennet i ndodhi ajo çfarë i ndodhi! Mos u mashtro nga ibadeti i shumtë, sepse edhe pas gjithë atij ibadeti, Iblisin e gjeti ajo çfarë e gjeti! Mos u mashtro nga dituri e shumtë, sepse Bel’ami e dinte mirë emrin më të lartësuar të Allahut, dhe shih çfarë e gjeti! Mos u mashtro duke parë robët e mirë të Allahut, sepse te Allahu Teala askush prej robëve nuk ka gradë më të lartë se Muhammed Mustafa, s.a.v.s., e prej takimit me të nuk përfituan as të afërmit e as armiqtë e tij.”*

Serijus Sakati ka thënë: *“E shikoj hundën me bisht të syrit disa herë në ditë, nga frika se më është nxirë fytyra.”*

Ebu Hafs ka thënë: *“Mendoj se Allahu Teala ka katërdhjetë vite që më shikon me zemërim. Këtë e vërtetojnë edhe veprat e mia.”*

Një ditë, Ibn Mubarek shkoi te shokët e vet, e ju tha:  
- *Mbrëmë mora guxim dhe nga Allahu kërkova xhennetin.*

Nëna e Muhammed ibn Ka'b Kurezi i tha atij:

- *Evladi im! Të njoh si të mirë sa ishe fëmijë, e të tillë të njoh edhe kur u rrite. E kur të shoh se po bën ibadet ditë e natë, më duket sikur ke bërë një gjynah; e ky i tha:*

- *Oj nënë! E si mund të jem i sigurt se Allahu Teala nuk do të zemërohet me mua dhe nuk do të më ndëshkojë, nëse bëj një gjynah?*

Fudajl ibn Ijazi ka thënë: *“Nuk i kam lakmi pejgamberët, as melaikeve të afërta, as robit të mirë. Sepse edhe ata do të dalin para Allahut Teala në ditën e Gjykimit, e kjo mjafton. Lakmoj vetëm ata që as nuk janë krijuar.”*

Tregohet se një i ri nga ensarët kishte frikë nga zjarri dhe vazhdimisht qante. Bile për shkak të kësaj frike u mbyll në shtëpi. Kur e dëgjoi këtë, Resulallahu, s.a.v.s., shkoi për ta vizituar dhe hyri te ai, e përqafoi, dhe i riu ra i vdekur në atë moment. Atëherë Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Bëjeni gati shokun tuaj. Frika nga xhehenemi ia ka shkatërruar mëlçinë.***<sup>81</sup>

Tregohet se ibn Mejsere, kur donte të flinte, thoshte: *“Sikur të mos më kishte lindur nëna!”* Atëherë nëna e vet i thoshte:

---

<sup>81</sup> Ibn Ebu Dun'ja në *“el-Haifun”* nga Huzejfe dhe Bejhaki në *“esh-Shuab”*, nga Sehl Ibn Sa'd.

- O Mejsere! Allahu Teala ishte i mirë me ty, e të udhëzoi në islam; e ai thoshte:

- Po, por Allahu Teala na ka treguar se do të shkojmë te Zjarri, por nuk e ka përmendur se a do të largohemi nga aty.

Dikush e pyeti Ferkad Sebehin:

- Na trego diçka më të çuditshmen që ke dëgjuar për israelitët! U përgjigj:

- Kam dëgjuar se në Bejtul-makdis kanë hyrë pesëqind vajza të reja, veshur me rroba leshi e pëlhurë të trashë; flisnin mes vete për shpërblimin dhe dënimin e Allahut, dhe të gjitha vdiqën në një ditë.

Atta Sullemi ishte një prej atyre që kishte frikë, dhe kurrë nuk kërkoi xhennetin nga Allahu; e luste për falje dhe mëshirë. Kur u sëmur, e pyetën se a ke ndonjë kërkesë, e ju tha: “Jo. Frika nga xhehenemi nuk më la asnjë dëshirë në zemër.” Gjithashtu tregohet se Atta Sullemi për katërdhjetë vjet nuk shikoi në qiell e as nuk u qeshi. E një ditë, kur e ngriti kokën kah qielli, u tremb shumë dhe ra në tokë, e në stomak iu lajmërua çiban, e netëve me dorë prekte trupin, mos i është paraqitur çiban edhe diku tjetër. Kur godiste kohë e keqe, ose rrufeja, ose zi buke, thoshte:

- Kjo po ndodh për shkak meje! Sikur Attai të vdes, njerëzit do të kishin rehati.

Atta Sullemi tregon:

*“Një ditë dolëm në një udhëtim me Utbetul Gulam, e me ne kishte edhe pleq edhe të rinj; e fjalnin namazin e sabahut me abdes të jacistë, këmbët e tyre ishin të fryra nga qëndrimi i gjatë në namaz të natës, sytë e lëshuar, lëkurën ngjitur për eshtra, damarët shtanguar si tel tambure; e kur zgjoheshin në mëngjes lëkura e tyre ishte si lëvore pjepri, sikur të ishin ngritur nga varret. Ju tregonin të tjerëve se si Allahu Teala i nderon ata që bëjnë ibadet dhe si do të dënojnë të padëgjueshmit. Duke ecë, njërit prej tyre ra të fikët. Shokët e tij u mblodhën rreth tij duke qarë. Dita ishte e ftohtë, por balli i tij ishte mbuluar me djersë, ia fshinë djersën nga balli, e kur i hapi sytë, e pyetën se çfarë i ndodhi, e ai tha:*

*- M’u kujtua se këtu kam bërë një gjynah. Dhe për këtë më ra të fikët.*

Salih Merri ka thënë: *“Ia lexova një zahidi ajetin:*

***Ditën, kur fytyrat e tyre do të rrotullohen në zjarr, ata do të thonë: “Ah, sikur t’i ishim bindur Allahut dhe të Dërguarit!” (33:66), e atij i ra të fiket.***

*Pasi u zgjua, tha:*

*- O Salih, lexo edhe pak! Unë lexova ajetin:*

***Sa herë, që do të përpiqen të dalin nga ankthi i zjarrit, do të rikthehen në të... (22:22), e ai ra në tokë i vdekur.”***

Tregohet se Zerare ibn Evfa po falte namazin e sabahut dhe kur lexoi ajetin:

**“e, kur të fryhet në Sur...”** (74-Mudethir: 8), u rrëzua dhe vdiq.

Jezid Rekashi hyri në prani të Omer ibn Abdulaziz, e Omeri i tha:

- *Më jep një këshillë!* Jezidi i tha:

- *O udhëheqës i besimdrejtëve! Dije se nuk je halife i parë që do të vdesë!* Omeri filloi të qajë dhe i kërkoi edhe ndonjë këshillë. Jezidi i tha:

- *O udhëheqës i besimdrejtëve! Nga Adami deri te ti, të gjithë baballarët kanë vdekur.* Omeri qau më shumë, dhe i kërkoi edhe ndonjë këshillë tjetër. Jezidi i tha:

- *O udhëheqës i besimdrejtëve! Mes teje dhe xhennetit e xhehenemit nuk ka vendqëndrim tjetër!* Atëherë Omerit i ra të fikët.

Mejmun ibn Mehran tregon: **“Kur zbriti ajeti: *“Pa dyshim, xhehenemi është vendi i premtuar për të gjithë ata”*** (15:43), *Selman Farisi bërtiti fort, vendosi dorën në kokë, dhe iku. Tri ditë nuk e panë.”*

Dabud et-Tai pa një grua që qante mbi varrin e të birit duke thënë:

- *O evlad! Sikur ta dija cilën prej faqeve tua më së pari filloi ta hanë krimbat.* Davudi u shastis, e ra për tokë.

Kur u sëmur Sufjan Sevri, e sollën një mjek jomusliman. Mjeku tha se i janë copëtuar mushkëritë nga frika, pastaj ia mati pulsën, e tha:

*- Nuk kam parë kurrë një njeri të tillë.*

Ahmed ibn Hanbel, ka thënë:

*“Kërkova nga Allahu Teala të më hapë një derë frike, e kur Allahu më hapi një aso dere, sa kisha frikë se do ta humbas mendjen, e thashë:*

*- O Rabb, vetëm aq sa mund të barti!*

*Atëherë zemra mu qetësua.*

Abdullah ibn Amr ibn As ka thënë:

*“Qani, e nëse nuk mundeni, atëherë shtyjeni veten në të qarë! Pasha Atë që në dorën e Tij është shpirti im, sikur dikush nga ju ta dinte të vërtetën, do të qanit deri sa zëri t’i shterej, e do të falte namaz deri sa kurrizi t’ thehej.”*

Thuaj se Abdullah ibn Amr ibn As ka aluduar në fjalët e Resulallahut, s.a.v.s.:

**“Sikur të dinit atë që di unë, pak do të qeshnit, e shumë do të qanit.”<sup>82</sup>**

---

<sup>82</sup> Është përmendur në *Librin për themelet e besimit*.



Anberi tregon: "Një ditë, njerëzit e muhabetit u mblodhën para derës së Fudajl Ijadit, e ai me lot i shihte nga dritarja. Mjekra e dridhej, e ju tha:

- Vazhdoni të lexoni Kur'an dhe të falni namaz; nuk është koha për biseda. Është kohë e vajit, përvuljes e duasë. Është koha për t'u lutur, si lutja e një njeriu që bie në det dhe do të mbytet. Në këtë kohë, ruaje gjuhën, lehtëso veten, shëroje zemrën, merr atë që të duhet, lëre atë që nuk të duhet.

Një ditë Fuzejl Ijadin u pa duke ecur dhe u pyet:

- Ku po shkon?; e ai tha:

- Nuk e di!, dhe po ecte i humbur nga frika.

Dherr ibn Omer i tha babait të tij, Omerit:

- Çfarë është kjo? Kelamistët flasin, e askush nuk qanë, e kur ti flet, të gjithë nisin të qajnë? Omeri i tha:

- O evlad, nuk është i njëjtë vaji i një nëne që ka humbur fëmijën e saj, sikur kur qanë vajtuesja e paguar.

Tregohet se disa njerëz kaluan pranë një zahidi dhe e panë duke qarë. E pyetën për arsyen, e ju tha:

- Është një plagë në zemrën time që më bën të qaj. Ata që kanë frikë e ndjejnë dhimbjen e kësaj plage. E pyetën:

- Çfarë është kjo plagë?, e zahidi ju tha:

- Është plagë e shkaktuar nga zëri që thërret "**Ejani dhe jepni llogari para Allahut**".

Ebu Is-hak el-Havas duke qarë në dua, tha:

*“O Allah, jam plakur, më është dobësuar trupi nga ibadetet, më çliro.”*

Salih el- Muri tregon:

*“Një herë Ibn Semmak erdhi nga Bagdadi tek ne në Basra si mysafir, e më tha:*

*- Tregomë diçka të çuditshme nga gjendjet e abidëve tuaj; dhe shkuam së bashku në një kolibe, kërkuam leje për të hyrë, e kur hymë pamë që një person ishte duke bërë litar nga fijet e palmës. Kur e pashë këtë, i lexova ajetet:*

***“Kur t’u vihen vargoj në qafë e të sillen me zinxhirë në ujë të valë e pastaj të digjen në zjarr.” (40:71-72),***

*e ai personi u dridh e ra për tokë, dhe ne dolëm. Shkuam te i dyti, i kërkuam leje për të hyrë, e edhe te ai lexova ajetin e njëjtë. Edhe ai u dridh e ra për tokë. Shkuam te i treti, e kur kërkuam leje për të hyrë, e na tha:*

*- Hyni, por mos na pengoni nga Rabbi ynë! Unë lexova ajetin:*

***“Kjo është për atë që i frikësohet pranisë Sime dhe i frikësohet dënimit Tim” (14-14).***

*Ai u dridh, e nga hundët i doli gjak. E lamë në atë gjendje, dhe u larguam. Vizituam gjashtë persona, dhe të gjithë i lamë ashtu, të alivanosur.*

*Më pas shkuam te i shtati, dhe kërkuam leje për të hyrë, e nga brenda kolibes një grua na dha leje për të hyrë. Kur hymë, e pamë një plak ulur mbi sexhade. I dhamë selam, por ai thuaj se nuk na dëgjoi. Unë thashë me zë më të lartë:*

*- Vërtetë që të gjitha krijesat nesër do të ngritën në këmbë!; e plaku pyeti:*

*- Para kujt do të ngritën në këmbë?! dhe mbeti i shtangur, gojëhapur e me shikim të ngurtësuar; dëgjohej vetëm frymëmarrje e lehtë, deri sa edhe ajo u shua. Gruaja e tij na tha:*

*- Largohuni! Tash nuk mund të përfitoni më prej tij; dhe ne u larguam. Pas kësaj u interesova për ata që i vizituam. Tre ishin këndellë, tre kishin vdekur, e ky plaku për tri ditë kishte mbetur në gjendjen që e lamë, duke mos i kryer as farzet. Vetëm pas tri ditësh, edhe ai u zgjua.*

Jezid ibn Esved ishte një nga evliatë, e konsideronte veten një prej *abdallëve* (robë të veçantë të Allahut), e u betua se kurrë nuk do të qeshë, as të flejë i shtrirë, as të hajë mish. Dhe vërtetë, kurrë nuk e panë të qeshur, as të shtrirë, as të hajë mish, deri sa vdiq.

Haxhaxh i tha Seid ibn Xhubejrit:

*- Më kanë thënë se kurrë nuk ke qeshur; e ai tha:*

*- E si mund të qeshi, xhehenemi veç është ndezë, prangat janë bërë gati dhe zebanitë po presin!*

Një person e pyeti Hasan Basriun:

- *O Ebu Seid! Si u zgjove në mëngjes?;* e Hasani tha:

- *U zgjova me mirësi.* Personi e pyeti:

- *Si është gjendja jote?* Hasan tha:

- *Po më pyet për gjendjen time. Çfarë mendon për ata që futen në anije e shkojnë në det të thellë, e atje anija shkatërrohet e secili prej tyre kapet për një dërrasë të anijes; në çfarë gjendje mund të jenë ata?*

- *Në gjendje shumë të vështirë!*, tha ai, e Hasani tha:

- *Eh, unë jam në gjendje edhe më të vështirë se ta.*

Një skllave e liruar hyri në dhomën e Omer ibn Abdulazit, e përshëndeti. Pastaj shkoi në dhomën e faljes dhe fali dy rekate. Pasi i fali, e zuri gjumi dhe fjeti. Në ëndërr qau, e pasi u zgjua tha:

- *O udhëheqës i besimdrejtëve! Vallahi, ëndërrova diçka shumë të çuditshme!* Omeri e pyeti se për çka ishte fjala, e gruaja vazhdoi:

- *Pashë xhehenemin. Valët e flakës u përhapën mbi njerëzit, e më pas, u soll ura e Siratit e u vendos mbi atë zjarr.*

- *Vazhdo;* tha Omeri, e gruaja vazhdoi:

- *Më pas e sollën Abdulmelik ibn Mervanin, hipi në urë dhe kur bëri disa hapa, ura u lëkund dhe ai ra në xhehenem.*

- *Vazhdo;* tha Omeri, e gruaja vazhdoi:

- *Më pas e sollën Velid ibn Abdulmelikun, edhe ai bëri disa hapa, ura u lëkund dhe ai ra në xhehenem.*

- *Vazhdo; tha Omeri, e gruaja vazhdoi:*

- *Më pas e sollën Sulejman ibn Abdulmelikun, edhe ai ra në xhehenem në të njëjtën mënyrë.*

- *Vazhdo; tha Omeri, e gruaja vazhdoi:*

- *Më pas, vallahi, të sollën ty, o udhëheqës i besimdrejtëve! Omeri bërtiti, i ra të fikët. Gruaja iu afrua, e me zë të lartë i tha në vesh:*

- *O udhëheqës i besimdrejtëve! Vallahi ty të pashë që shpëtove! Deri sa ajo fliste, Omeri bërtiste dhe godiste me këmbët në tokë nga frika.*

Tregohet se Uvejs Karani, dëgjonte një tregimtar dhe po qeshte me fjalët e tij. Kur tregimtari përmendi xhehenemin Uvejsi bërtiti dhe u largua. Njerëzit i shkonin pas dhe i thoshin: *“I çmendur! I çmendur!”*

Muadh ibn Xhebel r.a., ka thënë: *“Besimtari nuk do të gjejë qetësi deri sa ta kalojë urën e xhehenemit.”*

Kur Tavusit i bënëin gati shtratin për gjumë, ai shtrihej e rrotullohej, si drithi në tenxheren që vlon. Më pas çohej, i vishte rrobat e kthehej kah Kibla, duke falë namaz, deri në mëngjes. E thoshte: *“Kujtimi i xhehenemit ju prishë gjumin atyre që kanë frikë.”*

Hasan Basriu ka thënë: *“Një person do të dalë nga xhehenemi pas njëmijë vjetësh. Do të doja që ai person të isha unë.”* E tha nga frika të mos qëndrojë përgjithmonë në xhehenem, dhe nga fryma e fundit - të mos shkojë pa iman.

Tregohet se Hasan Basri nuk qeshi për katërdhjetë vite. E shihnin ulur si një i dënuar që pret ekzekutimin; kur fliste, fliste sikur e ka parë jetën e përtejme dhe po tregon për të; kur heshte, dukej sikur xhehenemi po kalon para syve të tij. Një herë e qortuan për pikëllimin e madh, trishtimin dhe frikën, e ai ju tha:

- *Si të jem i sigurt që Allahu Teala nuk do të zemërohet me mua dhe nuk do të thotë "Unë nuk të fal"; kur Ai i di të gjitha të metat e mia të fshehta; si të mos jem i frikësuar?!*

Ibn Semmak ka treguar: *“Një ditë po mbaja vaz në një mexhlis, e një i ri u ngrit e tha:*

- *O Ebu Abbas! Sot na ke dhënë një mësim të tillë që, nuk kemi më nevojë të dëgjojmë tjetër. E pyeta se për çka e ka fjalën, e ai tha:*

- *Fjalët tua: “Qëndrimi i përhershëm - në xhennet a xhehenem, i copëtoi zemrat e atyre që kishin frikë.” Pasi tha këtë, shkoi. Herën tjetër e kërkoja atë djalë mes të pranishmëve, por nuk e pashë. Pyeta për të, e më thanë se është i sëmurë. E vizitova, e i thashë:*

- *Çfarë ke, vëlla? Më tha:*

- *O Ebu Abbas! Kjo është pasojë e atyre fjalëve tua. Më pas kaloi në ahiret, e unë e pashë në ëndërr, dhe e pyeta:*

- *Vëlla, si veproi Allahu Teala me ty?, e më tha:*

- *Më fali, pati mëshirë me mua e më çoi në xhennet!*

- *Me çka e meritove këtë?, e pyeta, e më tha:*

- *Me ato fjalët e tua!”*

Kjo ishte frika e pejgamberëve, evliave, alimëve dhe robëve të mirë - *salih*, e ne duhet të kemi më shumë frikë se ata. E frika nuk duhet të vijë për shkak të gjynaheve të shumta, por nga pastërtia e zemrës dhe nga njohja e plotë. Pra, edhe me pak gjynahe e me shumë ibadet, prapë nuk mund të jemi të sigurt nga dënimi. Epshi na tërheq, gjynahet na tërheqin, dëshirat tona janë më të forta se ne, e gafleti jonë dhe ngurtësia e zemrave tona na pengojnë të mendojmë për gjendjen tonë. Fatkeqësisht, as arritja e largimit nga kjo botë nuk bëhet vërejtje për ne, as shumësia e gjynaheve nuk na shtynë në veprim, bile as njohja me gjendjet e atyre që kanë frikë nuk na frikëson, e as rreziku i frymës së fundit nuk na shqetëson.

E lusim Allahun Teala që me mirësinë e Tij të përmirësojë gjendjet tona, nëse duaja me gjuhë mund të sjell dobi.

E habitshme se si, kur duam pasurinë e kësaj bote, ne mbjellim, korrim, tregtojmë, udhëtojmë në det e tokë dhe përballemi me rreziqe, e nëse kërkojmë dituri - mësojmë, lodhemi me mësim përmendësh e përsëritje dhe nuk flemë; lodhemi duke kërkuar riskun, udhëtojmë nga një vend në tjetrin dhe nuk kemi bindjen që Allahu Teala është garantues për riskun, ani që themi: *“O Allah na jep riskun.”* Megjithatë, kur sytë i drejtojmë kah lumturia dhe qëndrimi i përhershëm, mendojmë se mjafton të themi vetëm me gjuhë: *“O Allah, na fal, na mëshiro.”*, dhe Atij i mbështetemi. Ndërsa Allahu Teala thotë:

**“Njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar,”** 53-Nexhm: 39,

dhe:

**“O ju njerëz, s'ka dyshim se premtimi i Allahut është i vërtetë, pra të mos u mashtrojë juve jeta e kësaj bote dhe të mos u mashtrojë juve ndaj Allahut ai i mashtruar (shejtani).** 35-Fatir: 5,

dhe:

**“O ti njeri, po ç'të mashtroi ty kundrejt Rabbit tënd që është bujar?”** 82-Infitar: 6.

E gjitha kjo, nëse nuk na zgjon nga mashtrimi dhe dëshirat e kota, është fatkeqësi për ne.



Nëse Allahu Teala nga rahmeti e Tij nuk na mundëson pendim të sinqertë - *teube nasuha* - dhe nuk na ndihmon të kompensojmë gabimet tona, gjendja jonë do të jetë në rrezik. Lusim Allahun të na falë, në thellësitë e zemrave të na nderë mallin për pendim dhe që veprimi jonë të mos jetë vetëm në lëvizje të gjuhës për të kërkuar falje, e të jemi si ata që flasin por veprat nuk i kanë si fjalët, dëgjojnë, por nuk pranojnë. Kur dëgjojmë vaz, qajmë, e kur vjen koha të veprojmë me atë që dëgjojmë, kundërshtojmë, e nuk ka shenjë më të madhe të pandershmërisë se kjo! E lusim Allahun që me mirësinë dhe fisnikërinë e Tij të na dhurojë ndihmë e të na udhëzojë në rrugë të drejtë!

Le të mjaftojë kjo për gjendjet e atyre që kanë frikë, sepse edhe pak nga kjo do të ndikojë në zemrat e atyre që duan ta pranojnë, dhe kjo do t'u mjaftojë, e nëse zemra është në gaflet, atëherë nuk i ndikon, sado që të flasim.

Të vërtetën e ka thënë një murg i mirë për të cilin tregon Isa ibn Malik: *"Pashë murgun në hyrje të Bejtul-makdis, shumë i pikëlluar, e lotët nuk i ndaleshin. Më frikësoi pamja e tij. Iu afrova e i thashë:*

*- Më jep një këshillë që ta mbaj mend mirë nga ti!, e ai më tha:*

*- Çfarë të të këshilloj? Nëse mund të bëhesh si një njeri që ka frikë të hyjë mes kafshëve të egra dhe të bjerë në kthetrat e tyre, atëherë bëhu i tillë.*

Kur tha: “*Bëhu si njeriu mes kafshëve grabitqare*”, këtë nuk e tha si simbolikë, por si realitet. Sepse nëse me syrin e zemrës - *basiret* - shikon brendinë tënde, do të shohësh se aty ka kafshë të ndryshme grabitqare si zemërim, urrejtje, epush, lakmi, vetëpëlqim, mendjemadhësi, dyfytirësi, e të ngjashme. Ato të sulmojnë vazhdimisht. Nëse je i pakujdesshëm vetëm për një moment, ato mund të të shqyejnë. Fatkeqësisht, ti këto nuk i sheh, por kur të hiqet perdja, kur të vendosin në varr, do t'i shohësh të gjithë ata grabitqarë. Do t'i shohësh në forma që ju përshtaten kuptimeve të tyre; me sytë e tu do të shohësh akrepa e gjarpërinj si të kanë rrethuar, e ato janë cilësitë e tua tani, që do të shfaqen në forma të ndryshme. Nëse dëshiron t'i vrasësh, e këtë mund ta bësh para vdekjes - bëje, e nëse nuk e bën, bëhu gati për kafshim të tyre në zemër, e as mos të flasim për lëkurë e mish. Vesselam!

## PËRMBAJTJA

|  |           |
|--|-----------|
| <b>PARATHËNIE .....</b>  | <b>3</b>  |
| <b>PËR SHPRESËN .....</b>  | <b>5</b>  |
| HAKIKATI I SHPRESËS .....  | 5         |
| FAZILETI I SHPRESËS DHE NXITJA NË TË .....                         | 14        |
| ILAÇI PËR SHPRESËN.....  | 21        |
| <b>PËR FRIKËN .....</b>  | <b>51</b> |
| HAKIKATI I FRIKËS.....   | 51        |
| GRADAT E FRIKËS .....  | 58        |
| FRIKA E NJERIUT .....  | 63        |
| FAZILETI I FRIKËS DHE NXITJA NË TË .....                           | 70        |
| MË MIRË TË DOMINOJË FRIKA APO SHPRESA; APO TË DYJA<br>NJËJTË?..... | 85        |
| ILAÇI QË LARGON FRIKËN.....  | 96        |
| KUPTIMI I PËRFUNDIMIT TË KEQ .....                                 | 122       |
| FRIKA E PEJGAMBERËVE DHE MELAIKEVE .....                           | 148       |
| FRIKA E AS'HABËVE, TAIBINËVE DHE SELEF-I SALIHIN .                 | 158       |

